

RAPORT

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT (DRENASIT) 2020-2027+

Gusht, 2019



Faza e raportit	Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor
Lloji i dokumentit planifikues të vlerësuar	Rishikimi i Planit Zhvillimor Komunal, i hartuar në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor Ligji Nr. 04/L-174 , i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 korrik 2013
Autorët	Ky raport për VSM është hartuar nga kompania “Environemntal & Bussiness Solution”, e cila është kontraktuar nga Komuna e Glogocit (Drenasit) në pajtim me fushëveprimin e përcaktuar në kontratë. Të gjeturat dhe rekomandimet e paraqitura në këtë raport janë rezultat i punës së ekspertëve të kompanisë dhe i zyrtarëve përgjegjës nga Komuna e Glogocit (Drenasit).



Përmbajtja

1. Hyrje

- 1.1. Vlerësimi strategjik mjedisor – përkufizimi dhe qëllimi
- 1.2. Procesi i VSM-së dhe bashkërendimi me PZHK-në
- 1.3. Përmbajtja e raportit të VSM-së

2. Korniza ligjore dhe strategjike

- 2.1. Korniza ligjore
- 2.2. Dokumentet strategjike

3. Studimi bazë i çështjeve mjedisore dhe socio-ekonomike

- 3.1. Baza socio-ekonomike
 - 3.1.1. Ndarja administrative
 - 3.1.2. Popullsia
 - 3.1.3. Ekonomia
 - 3.1.4. Pasuritë minerare dhe minierat
 - 3.1.5. Bujqësia
 - 3.1.6. Trashëgimia kulturore
 - 3.1.7. Turizmi
- 3.2. Gjendja e mjedisit
 - 3.2.1. Pedologjia dhe Gjeologjia
 - 3.2.2. Klima
 - 3.2.3. Burimet ujore dhe menaxhimi i tyre
 - 3.2.4. Cilësia e ajrit
 - 3.2.5. Zhurma
 - 3.2.6. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut
 - 3.2.7. Menaxhimi i mbeturinave
 - 3.2.8. Zonat e mbrojtura, biodiversitetit dhe peizazhi

4. Çështjet kyçe mjedisore dhe socio-ekonomike, problemet mjedisore dhe objektivat e VSM-s

5. Përmbledhje e përmbajtjes, sfidave zhvillimore dhe prioritetëve strategjike të PZHK-së

6. Analiza e përputhshmërisë së objektivave të PZHK-së kundrejt objektivave të VSM-së

7. Evolucion i gjendjes aktuale mjedisore pa një plan

8. Vlerësimi mjedisor i skenarëve zhvillimorë alternativ

9. Ndikimet e mundshëm mjedisore si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PZHK-së

10. Rekomandimet dhe masat zbutëse

11. Plani i Monitorimit

12. Përmbledhje ekzekutive e VSM

13. Referencat dhe burimet e informacionit



1. Hyrje

1.1. Vlerësimi strategjik mjedisor – përkufizimi dhe qëllimi

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të një politike të propozuara, iniciativave të një plani apo programi me qëllim të sigurimit se ato janë përfshirë plotësisht dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme në fazën më të hershme të përshtatshme të vendimmarrjes, në të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe sociale.¹

Qëllimi kryesorë i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe që ti kontribuoj promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM-ja synon përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektivat apo strategjitë e reja, si dhe duke rishikuar strategjitë e propozuara dhe sugjeruar ato që mund të jenë më të mira në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe minimizimit dhe parandalimit të ndikimeve dhe rreziqeve në mjedis. VSM-ja si proces duhet të fillojë në fazat fillestare të procesit të përgatitjes së planit dhe duhet të zhvillohet paralel me planin dhe të integrohet plotësisht në të.

VSM-ja e propozuar ka për qëllim të sigurojë integrimin e çështjeve mjedisore në vendimmarrjen strategjike për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndoshë në aspektin mjedisor. Në veçanti, procesi i VSM-së u ndihmon autoriteteve përgjegjëse si dhe vendimmarrësve që ta marrin parasysh në planet dhe programet e tyre këto elemente:

- Trendët kryesorë mjedisorë – mundësitë dhe kufizimet që mund të ndikojnë ose që mund të ndikohen nga plani ose programi.
- Objektivat dhe treguesit përkatës mjedisorë të planit ose programit.
- Efektet e mundshme dhe të rëndësishme mjedisore të opsioneve të propozuara si dhe zbatimi i planit ose programit.
- Masat për shmangien, zvogëlimin ose zbutjen e efekteve të dëmshme, dhe për rritjen e efekteve pozitive.
- Pikëpamjet dhe informatat nga autoritetet përkatëse, publiku dhe – sipas nevojës dhe kur është e rëndësishme – nga vendet fqinje të cilat mund të ndikohen (në rast të identifikimit të ndikimeve të mundshme përtej kufijve të një shteti).

Parimet themelore mbi të cilat është e bazuar VSM-ja janë :

- ✓ **Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm**, që nënkupton shqyrtimin dhe përfshirjen e aspekteve genësore të mjedisit në përgatitjen dhe aprovimin e planeve dhe programeve të caktuara dhe me konfirmimin e kushteve për ruajtjen e të mirave materiale, vlerave të kulturës dhe të natyrës, hapësirave, llojllojshmërisë biologjike, llojeve të egra bimë dhe shtazore dhe ekosistemeve autoktone, respektivisht të shfrytëzimit racional të resurseve natyrore, kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm.
- ✓ **Parimi i integritetit**, që kërkon zbatimin e Politikave të mbrojtjes së mjedisit të cila realizohet përmes sjelljes së planeve dhe programeve bazohet në përfshirjen e kushteve të mbrojtjes së

¹ Sadler and Verheem, 1996



mjedisit, gjegjësisht ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe llojllojshmërisë biologjike në planet dhe programet ndër sektoriale.

- ✓ **Parimi i kujdesit**, që nënkupton që çdo aktivitet duhet të zbatohet në atë mënyrë, që para miratimit, të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet negative të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis të sigurojë shfrytëzim racional të resurseve natyrore dhe zvogëlojë rrezikun për shëndetin e njeriut dhe të mirave materiale.
- ✓ **Parimi i hierarkisë dhe koordinimit**, që në përcakton se vlerësimi i ndikimit të planeve dhe programeve kryhet në nivel qendror për planet ose programet që nxirren në nivelin qendror dhe lokal dhe se në procedurën e VSM-së, të planeve ose programeve, ngritja e shkallës së transparencës në vendimmarrje sigurohet në koordinim të ndërsjellë të organeve dhe organizatave kompetente në procedurën e dhënies së pëlqimit për VSM, përmes konsultimeve, respektivisht njoftimit dhe dhënies së mendimit për ato plane ose programe.
- ✓ **Parimi i informimit publik**, i cili zbatohet më qëllim të informimit të publikut për planet ose programet e caktuara dhe për ndikimin e mundshëm të tyre në mjedis dhe më qëllim të sigurimit të transparencës së plotë gjatë procedurës së përgatitjes, nxjerrjes dhe miratimit të planeve ose programeve, para marrjes së vendimit, si dhe pas miratimit të planeve ose programeve, publiku patjetër duhet që të ketë qasje në informata të cilat kanë të bëjnë me ato plane ose programe dhe modifikimin e tyre.

Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji nr. 03/230), i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për zbatimin e VSM-së. Ky ligj është në përputhje me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Strategic Environmental Assessment Directive 2001/42/EC).

Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë e specifikon që procedura e VSM-së të përbëhet nga:

- ✓ Përgatitja e një raporti të VSM-së në lidhje me ndikimet e konsiderueshme të draftit të planit ose programit (PP);
- ✓ Konsultimi i organeve relevante, dhe publikut të gjerë, për draftin e Planit ose Programit dhe raportin shoqërues të VSM-së;
- ✓ Marrja në konsideratë e raportit për VSM-në dhe rezultateve të konsultimit në vendimmarrje;
- ✓ Komunikimi i rezultateve të VSM-së dhe përfshirja e rezultatit të saj në Planin ose Programin përkatës.

Sipas Ligjit Nr. 03/230, VSM-ja është e detyrueshme për Planet dhe Programet si në vijim:

- ✓ Planet dhe Programet që janë të përgatitura për **planifikim hapësinor**, planifikim të qytetit, shfrytëzim të tokës, bujqësi, pylltari, peshkatari, gjueti, energji, industri, miniera, komunikacion, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikacion, turizëm, dhe të përbejnë kornizën për projektet e ardhshme të zhvillimit të cilat i nënshtrohen VNM-së sipas Ligjit për VNM;



Pra sikurse është e specifikuar më lartë dhe në përpurthje me nenin 4 pika 2 të Ligjit të VSM, edhe Planet e hapësinore dhe ato për planifikim të qytetit kërkojnë përgatitjen e raportit të VSM. Prandaj edhe për PZHK-në e Komunës së Glogocit (Drenasit), raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm.

1.2. Procesi i VSM-së dhe bashkërendimi me PZHK

VSM-ja për planin zhvillimor komunal – që është subjekt i këtij raporti është i obligueshëm sipas Ligjit për VSM. Procesi i VSM-së është bashkërenduar me rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të komunës së Glogocit (Drenasit). Ky proces ka për objektive të sigurojë përfshirjen e informatave dhe komenteve në PZHK me qëllim të integritit të çështjeve mjedisore gjatë procesit të planifikimit.

Figura në vijim paraqet bashkërendimin dhe lidhjen në mes të procesit të hartimit të PZHK-së dhe VSM-së.




Figura 1: Integrimi i proceseve të PZHK-së dhe VSM-së²

² Burimi: Doracaku i thjeshtësuar i burimeve për mbështetjen e aplikimit të protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë (OECD), Janar 2012



Aktivitetet VSM-së filluan në qershor 2019, pasi që është hartuar drafti i dokumentit e PZHK-së për komunë e Glogocit (Drenasit). Së pari është analizuar konteksti ligjor dhe strategjik, përmes sistemit të informacionit në lidhje me dokumentet relevante të legjislacionit, si dhe politikat dhe veprimet e tjera strategjike me implikime për PZHK e Komunës së Glogocit (Drenasit). Gjithashtu, gjatë kësaj faze janë mbledhur dhe rishikuar të gjitha informacionet e rëndësishme që janë në dispozicion (raporte, studime sektoriale etj.). Janë mbajtur takime me zyrtarët përkatës të Komunës së Glogocit (Drenasit), ku është dakorduar për metodologjinë dhe dinamikën e punës për hartimin e raportit të VSM.

Në bazë të informative të mbledhura është përpiluar një studim bazë i mjedisit. Qëllimi i studimit bazë ishte të ndihmojë në identifikimin e problemeve mjedisore dhe mundësitë kryesore që duhet të sillen në vëmendjen e ekipit planifikues, dhe zgjedhja e një grupi relevant të objektivave të VSM-së. Një listë paraprake e objektivave të VSM-së, është prezantuar dhe është diskutuar. Objekt i diskutimit ishin edhe çështjeve kryesore mjedisore për zonën e studimit, si dhe të theksimit të një drejtimi për objektivat e VSM-së. Mendimet dhe sugjerimet paraprake janë mbledhur dhe përdorur për të rishikuar objektivat e VSM-së, dhe për të përditësuar hartimin e studimit bazë të mjedisit.

Më pas, është analizuar draft i dokumentet të PZHK-së së Komunës së Glogocit (Drenasit), për të vlerësuar përputhshmërinë e këtij dokumenti me objektivat mjedisore. Është bërë vlerësim edhe për ndikimet mjedisore sipas skenarëve të PZHK dhe aktiviteteve specifike të Planit. Bazuar në të gjeturat janë përgatitur komentet dhe janë dhënë rekomandimet paraprake. Këto të gjetura janë ndarë me ekipin përkatës të Komunës së Glogocit (Drenasit) dhe ekipin planifikues të PZHK-së.

1.3. Përmbajtja e Raportit të VSM-së

Ky raport është strukturuar si në vijim:

- ✓ **Kapitulli 1** është hyrja e dokumentit ku prezantohet qëllimi, procedurat dhe fazat e hartimit të raportit të VSM.
- ✓ **Kapitulli 2** ofron informacione mbi kornizën ligjore dhe strategjike.
- ✓ **Kapitulli 3** përshkruan të dhënat që janë në dispozicion dhe paraqet studimin bazë të mjedisit dhe evoluimin e tij të mundshëm pa zbatimin e Planit Zhvillimorë.
- ✓ **Kapitulli 4** përshkruan problemet dhe mundësitë kyçe mjedisore, dhe radhitë objektivat e VSM-së që janë përcaktuar për PZHK-në.
- ✓ **Kapitulli 5** ofron një përmbledhje të përmbajtjes së draftit të PZHK-së.
- ✓ **Kapitulli 6** përmban rezultatin e vlerësimit të pajtueshmërisë të qëllimeve të PZHK-së me objektivat e VSM.
- ✓ **Kapitujt 7, 8 dhe 9** përmbajnë një vlerësim paraprak të ndikimeve mjedisore të draftit të kornizës së zhvillimit hapësinor, dhe përkatësisht draftet e strategjive dhe veprimeve për zbatim.
- ✓ **Kapitulli 10** ofron një përmbledhje të rekomandimeve dhe masave zbutëse.
- ✓ **Kapitulli 11** ofron një propozim për planin monitorues.
- ✓ **Kapitulli 12** përmban përmbledhjen jo-teknike të raportit të VSM-së, dhe



✓ **Kapitulli i fundit** ofron listën e referencave dhe burimeve të informacionit.

Tabela 1 ofron një përmbledhje të kërkesave të Ligjit të Kosovës për VSM-në dhe prezanton seksionet relevante të Raportit Mjedisor të cilat plotësojnë këto kërkesa.

Tabela 1. Përmbajtja e kërkuar e raportit mjedisor në bazë të Ligjit Nr. 03/L-230 dhe kapitulli (kapitujt) në të cilin është mbuluar në këtë raport

Informacionet që duhet të jepen në raportet e VSM-së (Shtojca 2, Ligji Nr. 03/L-230)	Të mbuluara në këtë raport
1. përmbledhje të përmbajtjes, qëllimeve kryesore të planit ose programit dhe raportet me planet dhe programet tjera relevante	Kapitulli 5 dhe Kapitulli 2
2. aspektet relevante të gjendjes aktuale mjedisore dhe evoluimi i mundshëm pa zbatimin e planit	Kapitulli 3 dhe Kapitulli 7
3. karakteristikat mjedisore të zonave që mund të ndikohen seriozisht	Kapitulli 3
4. problemet ekzistuese mjedisore që janë relevante për planin dhe programin, përfshirë në veçanti, ato të cilat lidhen me zonat e rëndësisë së veçantë mjedisore	Kapitulli 3 dhe Kapitulli 4
5. objektivat e mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në nivel kombëtarë, ndërkombëtar ose të komunitetit evropian të cilat janë relevante për planin dhe mënyra se si ato objektiva dhe konsideratat tjera mjedisore mund të merren parasysh gjatë përpilimit të tyre.	Kapitulli 2 dhe Kapitulli 4
6. ndikimet e mundshme në mjedis, në fushat si biodiversiteti, popullsia, shëndeti njerëzor, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitektuale dhe arkeologjike, peizazhin dhe ndërveprimin në mes të faktorëve të cekur më lart	Kapitulli 6, Kapitulli 7, Kapitulli 8 dhe Kapitulli 9
7. masat e parapara për të parandaluar, zvogëluar dhe neutralizuar sa më shumë që është e mundur ndikimet në mjedis si rrjedhojë e zbatimit të planit	Kapitulli 9 dhe Kapitulli 10
8. përmbledhjen e arsyeve për zgjedhjen e alternativave të parashtruara, dhe përshkrimi se si është bërë vlerësimi, përfshirë vështirësitë - si mungesat teknike dhe të njohurive – të hasura gjatë mbledhjes së informacioneve të kërkuara	Kapitulli 8, Kapitulli 8 dhe Kapitulli 10
9. përshkrimin e masave të parapara në lidhje me monitorimin	Kapitulli 11
10. përmbledhjen jo-teknike të informacioneve të paraqitura kategoritë e sipër përmendura	Kapitulli 12



2. Korniza ligjore dhe strategjike

2.1. Korniza ligjore

Tabela 2 ofron një përmbledhje të legjislacionit të Kosovës që përcakton objektivat dhe politikat e mbrojtjes së mjedisit që janë potencialisht të rëndësishme për PZHK-në dhe VSM-në.

Tabela 2: Ligjet relevante mjedisore, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre³

Ligji	Qëllimi dhe fushëveprimi
Ligji nr. 03/l-025 për mbrojtjen e mjedisit	Me këtë ligj harmonizohen zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullsinë e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.
Ligji nr.04/l-147 për ujërat e Kosovës	Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësitë institucionale në lidhje me ujërat dhe burimet ujore.
Ligji nr. 03/l-233 mbi mbrojtjen e natyrës	Me këtë ligj përcaktohet sistemi i mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës (e tërë laramanisë biologjike dhe peisazhore) dhe vlerave të saj.
Ligji nr. 02/l-26 për tokën bujqësore	Përcakton shfrytëzimin, mbrojtjen, rregullimin dhe qiradhënien e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
Ligji nr. 02/l-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike	Ky ligj konsideron të gjitha llojet e matjeve e të vrojtimit të elementeve dhe dukurive meteorologjike, hidrologjike, biometeorologjike, hidrobiologjike, përpunimi dhe shpallja e rezultateve të mbledhura të këtyre matjeve dhe vrojtimit, shpallja e informatave të rregullta dhe të kohë pas kohshme për motin, gjendja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, përcjellja dhe hulumtimi i ndryshimeve dhe dukurive në atmosferën e hidrosferës me rëndësi për ekonominë e Kosovës dhe studimi e vlerësimi i ndikimeve të tyre në mjedis.
Ligji nr. 02 / l-102 për mbrojtjen nga zhurma	Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare të ndikimeve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës. Ky ligj do të ofrojë bazë për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma.
Ligji nr. 03/l-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes i cili vjen si pasojë e veprimtarive industriale, në veçanti duke parandaluar dhe reduktuar mbeturinat, emisionet në ajër, ujë dhe tokë.

³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://qzk.rks-qov.net/>)



Ligji nr. 03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit
Ligji nr. 03/l-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis	Qëllimi i këtij ligji është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë ti kontribuojë ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit, mbrojtjes së shëndetit të njeriut si dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.
Ligji nr.04 / l-060 për mbeturina	Ky ligj ka për qëllim: 1. evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave; 2. ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat; 3. zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve njerëzore; 4. parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; 5. deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore
Ligji nr. 02/l-197 për kimikate	Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i administrimit të qëndrueshëm të kimikateve, duke i përfshirë masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut prej ndikimit të dëmshëm nga kimikatat.
Ligji nr. 02/l-78 për shëndetësi publike	E definon shëndetësia publike si disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale.
Ligji nr.03/l-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës	Ky ligj i definon Pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
Ligji nr. 02/l-53 për gjuetinë	Qëllimi i ligjit është ruajtja e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtja adekuate e kafshëve të egra, sigurimi i mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të resurseve, nevoja për siguri dhe standardin e etikës së gjahtarëve.
Ligji nr. 04/ l-176 për turizmin.	Ky ligji ka për qëllim që të vendos parimet dhe rregullat për zhvillimin dhe promovimin e turizmit si dhe vendosjen dhe zhvillimin e standardeve të shërbimeve turistike.
Ligji nr. 04/-l-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	Ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.



2.2. Dokumentet strategjike

Tabela 3 ofron një përmbledhje të veprimeve strategjike (politikave, planeve ose programeve) që janë potencialisht të rëndësishme për të ndikuar në PZHK. Konsistenca e PZHK me këto veprime (e ashtuquajtura "Analiza e jashtme e pajtueshmërisë") është përshkruar në tabelën 4.

Tabela 3: Veprimet relevante strategjike, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre

Veprimi strategjik	Qëllimi dhe fushëveprimi
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021	Ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës, dhe koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale, të identifikuar nga studime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.
Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+	Promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojtjes së resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Përpilimi i Planit Hapësinor të Kosovës ndihmon shtrirjen hapësinore të zhvillimeve, të nivelit kombëtar, komunal e urban.
Drafti i Hartës Zonale të Kosovës 2020-2028+	Qëllimi kryesor i Hartës Zonale të Kosovës është koordinimi i zhvillimeve hapësinore në të gjithë territorin e vendit përmes veprimeve, masave dhe aktiviteteve si dhe implementimi i politikave, qëllimeve dhe objektivave të sektorëve të zhvillimorë. të Qeverisë së Kosovës. Harta përcaktohen zonat për të cilat do të vendosen kushtet zhvillimore të obligueshme për të gjitha subjektet pjesëmarrëse në implementim. Komuna e Glogocit (Drenasit) bënë pjesë në Zonën Rajonale të Prishtinës.
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020	Është dokument bazë për mbrojtjen e natyrës, i cili i përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe laramanisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.
Strategjia e Kosovës për Mjedisin 2013-2022	E zhvilluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit. Ajo paraqet bazën për hartimin e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis, orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e mjedisit në nivel nacional.
Dokumenti për Politika dhe Strategjinë e zhvillimit të sektorit të Pylltarisë 2010 – 2020	Ky dokument përshkruan strategjitë për krijimin e sistemeve efektive për menaxhimin shumëqëllimorë të resurseve pyjore, si dhe zhvillimin e një industrie pyjore e cila është në harmoni me resurset ekzistuese pyjore.
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2018-2022	Këto dokumente kanë për objektivë të përgjithshme të rriten mundësitë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në tërë Kosovën përmes Implementimit të legjislacionit për ajrin, uljen e emisioneve në ajër nga burimet e veçanta, uljen e emisioneve nga burimet mobile dhe uljen e emisioneve nga aktivitetet publike.



Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022	Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i një kornize për të zvogëluar sasinë e mbeturinave dhe për ngritjen një sistemi të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave dhe zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat.
Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2033	Ka qëllim të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të Republikës së Kosovës, të përcaktojë procedura dhe parime udhëheqëse për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin, të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi dhe të përcaktojë strukturat institucionale për administrimin resurseve ujore.
Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019- 2021	Përcakton politikat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë dhe për përshtatje me ndryshimet klimatike. Po ashtu, ajo paraqet një mundësi që të gjenden dhe përcaktohen masat për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike, të cilat do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm.
Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013-2022	Është dokumenti themelor që përcakton politikat e energjisë dhe synimet zhvillimore të këtij sektori në përputhje me standardet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, ruajtjes së mjedisit dhe mirëqenies sociale, duke rritur profitin nga shfrytëzimi i resurseve energjetike vendore.
Plani i Veprimit për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë 2013-2020	Përcakton caqet për përdorimin e burimeve të ripërtitshme të energjisë (BRE) deri në vitin 2020. Në kuadër të këtij plani Kosova ka caktuar cakun prej 25 % të BRE deri në vitin 2020.
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025	Ka për qëllim të krijoj mundësi reale për shfrytëzimin sa më racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve minerare. Ky dokument synon të jetë udhërrëfyes për institucionet relevante, për menaxhim të përgjegjshëm të pasurive minerale me qëllim të valorizimit të resurseve ekzistuese dhe identifikimin e resurseve të reja minerale.
Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020	Kjo strategji ka si objektivë të përgjithshme ka realizimin e projekteve të konsolidimit të tokës dhe të sigurojë shfrytëzim racional të tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mbështetje për zhvillimin e bujqësisë.
Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i Veprimit	Ka për qëllim përmirësimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit, përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, krijimin e ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit, përmirësimin e sigurisë në komunikacion dhe mbrojtjen e mjedisit.
Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027	Synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë, avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.



Plani Hapësinor i “Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë”	Komuna e Glogocit (Drenasit) bën pjesë me 41% të totalit të sipërfaqes të Zonës me Interes të Veçantë „SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë”, i cili në total është 39km ² . Kjo zonë karakterizohet me veçori gjeomorfologjike, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore-historike.
Plani Zhvillimor Komunal - Glogoc (Drenas) 2008-2020+	Përfshinë pakon e fushëveprimeve dhe prioriteteve strategjike, që përmban projektet për vendbanime, peizazh, trafik dhe infrastrukturë teknike dhe afatet kohore të implementimit të tyre. Projektet e planit përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ofrimin e infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillim ekonomik, shfrytëzimi racional i territorit, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore si dhe përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe teknike.
Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Glogocit (Drenasit) 2015-2020	Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta (PKMMN) i Glogocit (Drenasit) është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimin të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare. Plani synon shtrirjen e shërbimit për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjithë territorin e komunës.
Plani Hapësinorë - Zona me Interes të Veçantë “Fusha e Mihjes së Re”	Qëllimi i dokumentit është planifikimi i aktiviteteve të ardhshme brenda dhe jashtë zonës. Një pjesë e kësaj zonë shtrihet edhe në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit), përkatësisht në fshatin Vasilevë.
Draft Plani Komunal i Veprimt për Eficiencë të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Glogocit (Drenasit).	Objektivi i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë si dhe krijimi i sistemit për menaxhimin e energjisë në komunën e Glogocit (Drenasit).
Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Glogocit (Drenasit) / 2015-2019	Paraqet synimet strategjike zhvillimore socio ekonomike me impakt afat-mesëm në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Glogocit (Drenasit). Synimi i 3-të të këtij dokumenti është i fokusuar në ndërtimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës urbane dhe rurale, me kujdes të veçantë në ruajtjen e ambientit dhe tokave bujqësore.
Statuti i Komunës së Glogocit (Drenasit)	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.



Tabela 4. Lidhjet ndërmjet PZHK-së, dhe veprimeve tjera relevante strategjike

Veprimi strategjik	Komente mbi ndërveprimet dhe konfliktet e mundshme
Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021	Koordinimin e politikave zhvillimore në nivelin lokal me objektivat strategjike të parapara në Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.
Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+	Komuna e Glogocit (Drenasit) në Planin Hapësinor të Kosovës, bën pjesë në "Hapësirën e kaltër" apo Portin e Kosovës, së bashku me komunat Prishtinë, Obiliq, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Shtime. Kjo është një Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrençe me njëra tjetrën e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Të lidhura në rrjet, qytetet në këtë zonë krijojnë kushte të volitshme për veprimtari ekonomike, industriale, komerciale dhe shërbyese.
Drafti i Hartës Zonale të Kosovës 2020-2028+	Komuna e Glogocit (Drenasit) bën pjesë në Zonën Rajonale të Prishtinës. Komuna si një ndër institucionet implementuese të Hartës zonale duhet të harmonizojë veprimet, masat dhe aktivitetet e saj të parapara në PZHK me objektivat e sektorëve të zhvillimorë të përcaktuara për zonën rajonale të Prishtinës.
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020	Është dokument që ka qellim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së zonave që janë më të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit. Zona të tilla janë identifikuar përmes përdorimit të njohurive më të mira në dispozicion, të cilat janë mbledhur në takime dhe punëtori me ekologët dhe biologët. Zona të tilla mund të ketë edhe në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit) dhe duhet të merren në konsideratë në procesin e hartimit të PZHK-së.
Strategjia e Kosovës për Mjedisin 2013-2022	Përmban sinergji me shumë objektiva dhe veprime të propozuara në këto dokumente, sidomos në aspektin e: - mbrojtjes së zonave më të ndjeshme dhe të vlefshme për ruajtjen e biodiversitetit; zonave të rrezikuara mjedisore, promovimin e vetëdijesimit dhe edukimit në fushën e mjedisit; nxitjen e përmirësimit të njohurive në dispozicion në lidhje me karakteristikat mjedisore të komunës.
Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2018-2022	Këto dokumente kanë për objektive të përgjithshme të rriten mundësitë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në tërë Kosovën përmes uljes së emisioneve në ajër nga burimet e ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre veprimeve duhet të ndërmerren edhe në nivelin e komunës.
Dokumenti për Politika dhe Strategjinë e zhvillimit të sektorit të pylltarisë 2010 - 2020	Prerja e paligjshme e pyjeve, dhe menaxhimi i pyjeve dhe mbrojtja në përgjithësi, paraqesin çështje me interes për territorin e Komunës. Në kuadër të PZHK këto kërkesa mund të adresohen përmes përmirësimit të menaxhimit të pyjeve, parandalimin e prerjeve ilegale, reduktimin e rrezikut nga zjarri dhe pyllëzimin e tokave të degraduara dhe atyre të zhveshura.



Strategjia për ndryshimet klimatike 2019- 2028 dhe Plani i veprimit për ndryshime klimatike 2019- 2021	Reduktimi i gazrave serrë nga burimet e ndryshme, si dhe zbutja dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike kërkojnë zbatimin e masave të caktuara në të gjithë sektorët zhvillimorë., disa nga të cilat duhet të ndërmerren edhe në nivelin lokal.
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025	Planifikimi, menaxhim i përgjegjshëm dhe shfrytëzimi i qëndrueshme i resurseve minerare në nivel lokal të bëhet në harmoni me objektivat e kësaj strategjie.
Plani i Veprimit për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë 2013-2020	Arritja e qaveve për burimet e ripërtrishme të energjisë duhet të merren parasysh gjatë procesit të planifikimeve të reja posaçërisht në sektorin e ndërtimit dhe në sektorin e energjisë. Është me rëndësi që masat për arritjen e qaveve të ndërmerren edhe në nivelin lokal.
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022	Menaxhimi efikas i mbeturinave dhe zvogëlimi i rrezikut nga mbeturinat duhet të promovohet përmes koncepteve të reduktimit, ripërdorimit, riciklimit dhe formave tjera të trajtimit të mbeturinave. Komuna ka kompetenca të mjaftueshme për administrimin e mbeturinave dhe përmirësimin e gjendjes në territorin e komunës.
Strategjia për Konsolidimin e tokës 2010-2020	Masat për konsolidimin e tokave dhe shfrytëzimi racional i tokave bujqësore duhet të merren në konsideratë posaçërisht në sektorin e bujqësisë. Komuna ka rol thelbësor në përcaktimin dhe zbatimin e këtyre masave përmes planeve.
Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027	Zbatimi i kërkesave dhe parimeve për mbrojtjen e trashëgimish kulturore në nivel lokal sipas legjislacionit vendor. Këto kërkesa duhet të merren për bazë edhe në procesin e hartimit të PZHK.
Plani Hapësinorë - Zona me Interes të Veçantë "Fusha e Mihjes së Re"	PZHK e Komunës së Glogocit (Drenasit) duhet të marrë për bazë aktivitetet e ardhshme të planifikuara në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit), përkatësisht në fshatin Vasilevë nga ky dokument nacional.
Plani Hapësinor i "Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë"	PZHK e Komunës së Glogocit (Drenasit) duhet të marrë për bazë objektivat strategjike të parapara në kuadër të këtij Plani e sidomos për 41% të sipërfaqes së Zonës me Interes të Veçantë „SHP. UÇK. Kleçkë-Divjakë”, që shtrihet në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit).
Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Glogocit (Drenasit) / 2015-2019	Në kuadër të synimit të 3-të: Ndërtimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës urbane dhe rurale, me kujdes të veçantë në ruajtjen e ambientit dhe tokave bujqësore është vendosur një objektivi: Përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë në prodhimin e energjisë elektrike me aktivitet të planifikuar si: Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik dhe Efienca e energjisë elektrike dhe Hulumtimi i mundësive për përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
Plani për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Glogocit (Drenasit) 2011-2021	Masat dhe veprimet për zvogëlimin e deponive ilegale si dhe objektivat për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në nivelin komunal dhe shtrirjen shërbimit në të gjithë territorin e komunës.
Draft Plani Komunal i Veprimit për Efienca të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Glogocit (Drenasit).	Masat dhe veprimet për zvogëlimin e konsumit të energjisë në objektet publike, transport dhe ndriçim publik, rritja e nivelit të komoditetit, zvogëlimi i kostos së shpenzimeve të energjisë.



3.Studimi bazë i çështjeve mjedisore dhe socio-ekonomike

Të dhënat për këtë kapitull janë bazuar në të dhënat e ofruara nga komuna dhe të dhënat e prezantuara në dokumentet lokale dhe nacionale për sektorin e mjedisit dhe për çështje socio-ekonomike. Një listë më të plotë të këtyre burimeve e gjeni në kuadër të kapitullit referencat dhe burimet e informacionit dhe në kapitullin për kornizën strategjike dhe ligjore.

2.3. Baza socio-ekonomike

2.3.1. Pozita gjeografike dhe ndarja administrative

Territori i komunës së Glogocit (Drenasit) (Glogocit), shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Territori i saj, shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Territori i Komunës së Glogocit (Drenasit) është një urë lidhëse në mes të këtyre dy rajoneve.

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka një sipërfaqe prej 275,63 km² me një lartësi mbidetare prej: 575 m, pika më e ulët, dhe 1072 m, pika më e lartë. Pjerrësia e terrenit është 10 – 35 %. Gjerësia gjeografike ku shtrihet komuna është 420° 32", gjatësia gjeografike është 420° 64".

Territori i komunës së Glogocit (Drenasit) nuk është uniform; në përgjithësi është i përbërë nga zona të rrafshëta, kodrinore dhe malore. Në pjesën qendrore shtrihet luginë e Drenicës, në lindje të së cilës shtrihen Çiçavica, Goleshi dhe Blinaja, ndërsa në perëndim Caraleva, Drenica dhe Kosmaçi. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes "Ibër".

E veçanta tjetër e kësaj treve është miniera dhe shkretorja e "Feronikelit", si dhe disa gurore. Nëpër këtë komunë kalojnë lumi Drenica dhe Vërbicë, uji i të cilave shfrytëzohet për nevojat e ujitjes së tokave bujqësore.

Kjo komunë, në pikëpamje të ndërlidhjes tokësore lidhet më pjesët tjera të Kosovës më anë të hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë – Bushat (Komoran)-Pejë, dhe rrugët ndër komunale Shalë- Lipjan dhe Bushat-Glogoc (Drenas)-Skenderaj.




Figura 2: Pozita gjeografike e komunës së Glogocit (Drenasit) në Kosovë



Vendbanimi kryesor në komunën e Glogocit (Drenasit) është qyteti i Glogocit (Drenasit) me 7.210 banorë, gjersa, ka edhe 42 vendbanime të tjera rurale të banuara me 42.938 banorë. Komuna e Glogocit (Drenasit) është e ndarë në 35 zona kadastrale. Komuna ka 14.859 banesa dhe 11.787 ekonomi familjare. Të banuara janë 78.1%, gjersa të pabanuara 21.9%⁴. Pjesa dërmuese e vendbanimeve kanë strukturë homogjene etnike.




Figura 3: Harta e vendbanimeve në bazë të madhësisë

⁴ Komuna e Drenasit - Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2015 - 2019



Komuna e Glogocit (Drenasit) funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), Statutit të saj dhe akteve të tjera nënligjore.

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm. Kuvendi i Komunës së Glogocit (Drenasit) është organi më i lartë në komunë, dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale. Kuvendi i Komunës ka 31 anëtarë.

Komuna ka një institucion parashkollor, 30 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme dhe 52 institucione, përfshirë administratën komunale, stacionin policor, gjykatën, qendrën shëndetësore, shtatë qendra të shëndetësisë familjare, pesë klinika, PTK (Posta dhe Telekom i Kosovës), çerdhet e fëmijëve, qendrën e shërbimeve sociale, QRA-në (Qendra e Regjistrimit të Automjeteve), kompaninë e furnizimit me energji elektrike (KEDS-in) dhe Kryqin e Kuq.

2.3.2. Popullsia

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme.

Në bazë të rezultateve të vlerësimit të popullsisë të realizuara nga ASK për vitin 2018, numri i banorëve në komunën e Glogocit (Drenasit) është 60,970 banorë.

Tabela 5 : Popullsia sipas të dhënave nga regjistrimet dhe vlerësimet ⁵

Nr.	Vitet	Nr. i Popullsisë
1	Regjistrimi 1948	16,177
2	Regjistrimi 1953	17,683
3	Regjistrimi 1961	21,125
4	Regjistrimi 1971	28,188
5	Regjistrim 1981	39,141
6	Vlerësimi 1991	53,618
7	Regjistrimi 2011 ⁶	58,579
8	Vlerësimi 2018 ⁷	60,970

⁵ Plani Zhvillimor Komunal

⁶ Rezultatet preliminare të Regjistrimit të vitit 2011

⁷ Vlerësim, Popullsia e Kosovës, ASK 2019



Nga te dhënat e popullsisë rezulton qe numri i popullsisë në Komunën e Glogocit (Drenasit) nga viti 1948 deri në vitin 2011 ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 42,354 banorë. Në bazë të kësaj rritje, brenda periudhës kohore 63 vjeçare, del se mesatarisht ne qytet popullsia ka shënuar rritje prej rreth 672 banorë në vit.

Përderisa ka rritje paralele në qytet si dhe vendbanimet tjera kur shikohen si vlera ne %, por duke i analizuar numrat e banoreve si njësi – numri i banorëve në vendbanimet tjera te komunës se Glogocit (Drenasit) është dukshëm më i madh se rritja e numrit të banorëve në qytet të Glogocit (Drenasit). Kështu në qytetin Glogoc (Drenas) nga viti 1948 deri në vitin 2011 numri banoreve ka shënuar një rritje të konsiderueshme me 8,228 banorë duke u rrit me më shumë se 10 fish sa ishte ne vitin 1948, pra vendbanim me vetëm 558 banorë. Ndërsa, rritja e popullsisë është evidentuar të jetë edhe më e madhe në vendbanimet tjera te komunës se Glogocit (Drenasit). Nga 15,619 banorë që jetonin ne vendbanimet përreth qytetit të Glogocit (Drenasit) në vitin 1941, ky numër është rritur në 52,388 banorë.

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Glogocit (Drenasit) është rreth 212 banorë në 1 km², që është mbi mesataren në nivel vendi prej 165 banorë në 1 km². Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Glogocit (Drenasit) ku mesatarisht jetojnë rreth 1651 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Shtrubullojë (395 b/km²), Komoran (389.5 b/km²), Çikatovë e Re (363.1 b/km²), Nekoc (301.3 b/km²), Gllabar (300.4 b/km²), etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Vasilevë (65.7 b/km²), Gradicë (68.7 b/km²), Vuçak (80.6 b/km²), Godanc (96.5 b/km²), etj.

Fenomeni i urbanizimit te qyteteve që vërehet në shumicën e qyteteve në Kosovë, sidomos në periudhën e pasluftës, pra migrimi i brendshëm fshat-qytet - nuk duket të jetë aq i theksuar ne Komunën e Glogocit (Drenasit). Për më tepër, madhësia mesatare e familjes në qytet dhe në tërë komunën vërehet qe është zvogëluar paralelisht. Ndërsa, sipas regjistrimit te fundit te vitit 2011, madhësia mesatare e familjes në qytet del te jete më e vogël se në vendbanimet tjera ne komune. Në qytet mesatarisht familjet i kanë nga 5.9 anëtarë, përderisa mesatarja e anëtareve të familjes në nivel te komunës është 6.7 anëtarë.

Struktura e popullsisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Komuna ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja.

Sipas të dhënave grup-mosha 20 – 24 vjeç dominon me numër të popullsisë në krahasim me grup-moshat tjera. Struktura e përgjithshme e popullsisë sipas gjinisë është 51 % meshkuj dhe 49% femra. Mosha e re 0 - 14 vjeç merr pjesë me 29.5 % në popullsinë e Glogocit (Drenasit), ndërsa grup-moshat 15 - 64 që është popullsi aktive (e aftë për punë) merr pjese me 64.8%, kurse mosha 65 vjeç e më tepër kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 5.6 % të popullsisë së përgjithshme. Në përgjithësi grup-moshat e popullsisë 15 – 64 vjeç dominojnë në popullatën e përgjithshme.



2.3.3. Ekonomia

Komuna e Glogocit (Drenasit) është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, falë resurseve minerare si dhe falë tokës pjellore e cila ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore.

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka të regjistruara 4,028 biznese aktive, me rreth 90% prej tyre të regjistruar si mikro-ndërmarrje. Analizuar në aspekt të sektorëve ekonomik, shihet se numri më i madh i ndërmarrjeve, rreth 38% të tyre janë të regjistruara në sektorin e “Tregtisë dhe shumicë dhe pakicë”, pasuar nga sektori i “Ndërtimtarisë” (15%) dhe “Transporti dhe magazinimi” (13%). Kjo strukturë e ndërmarrjeve vërehet se nuk ka ndryshuar shumë ndër vite, dhe është e përafërt me strukturën e regjistrimit të ndërmarrjeve në nivel të Kosovës.

Industria është forca kryesore shtytëse e zhvillimit ekonomik në komunë (në veçanti që prej “Feronikeli” filloi të operojë në vitin 1984). Pjesëmarrja e “Feronikelit” në ekonominë e gjithmbarshme të Drenasit është 66.7%, e pasuar nga bujqësia, tregtia, ndërtimtaria, etj.

Operatori Industrial “Feronikeli” punëson mbi 1,000 punëtorë dhe me të drejtë konsiderohet si një ndër prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë.

Operatorë tjerë të rëndësishëm janë: gurëthyesit në “Çikatovë e Vjetër”, “Korroticë e Lartë” dhe “Baicë”. Në vitin 2004, në Drenas është hapur Qendra e Re Tregtare. Kjo qendër tregtare numëron 134 lokale komerciale dhe punëson përafërsisht 200 punëtorë. Që nga vitin 2012, në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit), në fshatin Korroticë e Poshtme me mbështetje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka filluar projekti i Parkut të Biznesit me sipërfaqe prej 24 hektarësh. Aktualisht në këtë Park janë të vendosura 43 biznese, që operojnë në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve. Parku i Biznesit është një kontribuues shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Glogocit (Drenasit). Megjithatë, bujqësia mbete një sektor shumë i rëndësishëm. Nga 27,100 ha të përgjithshme të territorit të komunës, 16,205 ha janë tokë bujqësore.⁸

Tabela 6 : Bizneset e regjistruara

Nr.	Veprimtaria	Bizneset e Regjistruara	%
1	Bujqësia	22	0.280%
2	Industria	71	0.902%
3	Ndërtimtaria	243	3.088%
4	Tregtia	7084	90.013%
5	Transporti	257	3.266%
6	Hotelet	60	0.762%
7	Financat	3	0.038%
8	Shërbimet	48	0.610%
9	Tjera	82	1.042%
10	Totali	7870	100%

⁸ *Plani Zhvillimor i Komunës së Glogocit (Drenasit) - 2009*



Përkundër këtij zhvillimi ekonomik, Komuna e Glogocit (Drenasit), ende nuk ka arritur t'i tejkalojë problemet e papunësisë dhe varfërisë. sipas Anketës së Fuqisë Punëtore të realizuar në vitin 2017⁹ është 30.5% dhe llogaritet të jetë më e larta në nivelin nacional. Duke u bazuar në të dhënat e Mirëqenies Sociale nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2017 në komunën e Glogocit (Drenasit), janë gjithsej 1,223 ekonomi familjare të përfshira në programin për asistencë sociale, apo gjithsej 5,459 persona. Kjo, shifër paraqet rreth 9% të gjithë popullsisë së vlerësuar në komunë (59,75210).

2.3.4. Pasuritë minerare dhe minierat

Komuna e Glogocit (Drenasit) është e pasur edhe me resurse minerale, ku përveç xehes së Feronikelit e cila është duke u eksploatuar dhe përpunuar në minierën e Çikatovës së vjetër dhe Gllavicës në Lipjan, si dhe përpunimin e tyre në shkretoren e Feronikelit, në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit) janë të identifikuar edhe rezerva të konsiderueshme të Kromit, Linjtit, Hekurit, Donitit, Guri gëlqeror, Uji mineral etj. të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e kapaciteteve të eksploatimit dhe përpunimit të tyre, të cilat njëkohësisht sjellin një mundësi për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve minerale dhe industria minerare janë ndër ndotësit me të mëdhenj të mjedisit në Komunën e Glogocit (Drenasit).

2.3.5. Bujqësia

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Sipas të dhënave statistikore kjo komunë ka në shfrytëzim 12,929 h tokë bujqësore e cila është e kategorizuar si tokë e punueshme, serra, livadhe, pemishte, vreshta, djerrina, kullota, pyje, si dhe kategori të tjera. Nga kjo sipërfaqe bujqësore 5600 hektarë janë nën sistemin e ujitjes Ibër Lepenc dhe për afër 4800 hektarë ka përfunduar masa komosative¹¹.

Ndër kulturat bujqësore me dominuesë në Komunën e Glogocit (Drenasit) janë kulturat tradicionale gruri dhe misri, produkte këto me të cilat arrihen rendimente të larta. Viteve të fundit, fermerët e kësaj Komune, kanë zhvilluar një bujqësi intenzive edhe me kultivimin e kulturave tjera bujqësore dhe profitabile si: patatja, lakra, luledielli etj., si dhe kultivimin e perimkulturave të ndryshme në ambiente të hapura dhe të mbyllura/ sera.

Numri i madh i pronave që kanë sipërfaqe të vogël mbetet njëra ndër sfidat kryesore për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Glogocit (Drenasit).

Sikurse edhe në shumicën e komuna të Kosovës as në Komunën e Glogocit (Drenasit) nuk ka ndonjë kontroll apo monitorim mbi përdorimin e pesticideve dhe substancave tjera kimike që kanë ndikim në mjedis e në mënyrë të veçante në ujëra.

⁹ Anketa e Fuqisë Punëtore 2017, ASK

¹⁰ Regjistrimi i Popullsisë 2011, ASK

¹¹ Komuna e Glogocit (Drenasit) - Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2015 - 2019



2.3.6. Trashëgimia Kulturore

Mbrojtja e monumenteve historike dhe kulturore është një nga elementet e rëndësishme të një shoqërie. Identifikimi, dokumentimi, shqyrtimi, arkivimi dhe kujdesin për mbrojtjen e monumenteve historike në Kosovë është përgjegjësi e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës (IMMK) mirëpo edhe komuna mundë të ndihmojë në realizimin me të mirë të kësaj përgjegjësie.

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka disa monumente të vjetra, ndërtesa religjioze si xhami e kisha, shtëpitë të ndërtuara në mënyrë tradicionale si dhe objekte të tjera të vjetra si ura të cilat duhet të ruhen dhe konservohen për shkak të vlerat të tyre kulturore.

Tabela 7 : Trashëgimia kulturore, sipas kategorive kryesore, numrit dhe shtrirjes hapësinore, 2018¹²

Kategoritë	Numri	Sipërfaqja (ha)
Trashëgimia arkitektuale	11	0.40.24
Trashëgimia arkeologjike	7	32.33.44
Peizazhet kulturore	0	0
Zonat e veçanta të mbrojtura	0	0
Gjithsej	18	32.56.44

Nga të gjitha kategoritë e trashëgimisë kulturore në Komunën e Glogocit (Drenasit) trashëgimia arkeologjike përfshin 7 asketë ndërsa ajo arkitektuale përfshin 11 objekte. Duke u bazuar në informata nga Komuna e Glogocit (Drenasit), prej 11 objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshin lista e përkohshme, 1 prej tyre është në gjendje të mirë, 1 në proces të ndërtimit, 3 në gjendje mesatare, 5 të dëmtuar dhe 1 fare nuk ekziston.

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që komuna e Glogocit (Drenasit) është një vend i vjetër. Këtë më së miri dëshmon prania e gjurmëve në fshatin Vuçak ku hasen rrënojat e mureve që përcjellin konfiguracionin e kodrës dhe formojnë Gradinën e Madhe (Gjymtët i Madh) dhe Gradinën e vogël (Gjymtët i Vogël). Duke u mbështetur në materialin arkeologjik që është gjetur këtu, janë dëshmuar gjurmë që nga parahistoria e deri tek mesjeta. Kalaja ishte tipike për kohën e antikitetit të vonë dhe shërbente si sistem mbrojtës për popullatën vendase.¹³

Glogoci edhe pse komunë jo shumë e madhe megjithatë përfshin asketë të trashëgimisë kulturore-historike, materiale dhe shpirtërore të cilat veçohen për nga vlera, cilësitë dhe karakteristikat. Trashëgimia që posedon Glogoci e sidomos ndërtesat e banimit shfaqin vërtetësinë e identitetit të shoqërisë dhe konsiderohet që mund të kontribuojnë në zhvillimet të ardhshme. Këto asketë mund

¹² Burimi: Aprovimi i Listës së përkohshme të trashëgimisë Kulturore MKRS

¹³ Komuna e Drenasit/Databaza MKRS



të jenë pika të pushimit që ofrojnë ushqim tradicional dhe të plotësojnë agjendat turistike regjionale apo më gjerë.

Në mesin e këtyre asketeve mund të veçohen: *Kulla e Bibish Morinës* - pronë e z.Ibish Morinës, gjendet në fshatin Çikatovë në komunën e Glogocit (Drenasit) dhe është ndërtuar nga fundi i shek. XIX. Shtëpia e banimit – Smajl Haxhiu, P+1 është ndërtuar në fillim në shek. XIX. *Kompleksi i Banimit i Familjes Dervisholli* gjendet në fshatin Gradicë të komunës së Glogocit (Drenasit), i ndërtuar në shek. XVIII-XIX. *Mulliri i Gani Sylës*, në Kishnarekë gjendet në mes të fshatit Kishnarekë dhe i përket shekullit XIX. *Mulliri i Gani Sylës* – ana Veri – Lindore Shek. XIX Kishna Rekë, Glogoc. *Stacioni i Trenit* në fshatin Dobroshec – gjendet në rrugën hekurudhore Prishtinë – Fushë-Kosovë – Pejë në fshatin Dobroshec.

Gjatë zbatimit të planeve hapësinore dhe rregulluese shpesh ndodhë që objektet e trashëgimisë kulturore të dëmtohen ose të shkatërrohen tërësisht, prandaj PZHK duhet të marrë parasysh këtë aspekt në kuadër të procesit të planifikimit.

2.3.7. Turizmi

Komuna e Glogocit (Drenasit) karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor, natyror, kulturore dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Glogocit (Drenasit) e karakterizuar me masive malore, Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi i japin vlerë konkurruese komunës së Glogocit (Drenasit) në Kosovë për zhvillimin e turizmit.

Pozita qendrore e komunës së Glogocit (Drenasit) si dhe lokacionet interesante turistike sikurse janë Kalaja e Verbocit, Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e “Gurit të Plakës”. Guri i Gradinës, Kalaja e Vuçakut, Pishat e Gllobarit etj. janë vetëm disa nga resurse të vlefshme dhe mjaft atraktive për zhvillimin e turizmit.

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka potencial shumë të mirë edhe për zhvillimin e turizmit të shpellave për faktin se në territorin e kësaj komunë shtrihen disa shpella interesante sikurse janë: Shpella e Peshterit në Nekovc, Shpella e Kizharekës, Shpella e Kokilit në Verboc, Shpella e Baicës dhe Shpella e Gllanasellës.

Gjithashtu, edhe hoteleria është mjaft e zhvilluar, ku në komunën e Glogocit (Drenasit) janë rreth 60 biznese hoteliere, që prezantojnë një infrastrukturën aktuale për pritjen dhe sistemimin e turistëve.

Rëndësi dhe vlera tjera turistike në komunën e Glogocit (Drenasit) janë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike si Kalaja e Verbocit dhe Kalaja e Vucakut etj.

Gjithashtu vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë si shumë lapidare të tërëneve për çlirimin e Kosovës, komplekse memoriale dhe monumente tjera të ndryshme që pasqyrojnë ofertën turistike në këtë komunë. Glogoci është njohur edhe për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore që mundë të tërheqin turistë të ndryshëm. I tillë është Festivalit të grupeve kulturo-artistike mbare shqiptare që është pa dyshim një prej manifestimeve më të vjetra si dhe Festivali i Grupeve Kulturo-artistike të shkollave fillore.



Edhe pse turizmi ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik dhe atë kulturor të një zone, zhvillimi i tij i pakontrolluar ka ndikim negativ në mjedis e në veçanti në ekosistemet natyrore si rezultat i hedhjes së pakontrolluar e mbeturinave, dëmtimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit. Me qëllim të zvogëlimin të këtij ndikimi krahas aspektit ekonomik, turizmi duhet ti kushtojë vëmendje edhe mbrojtjes së mjedisit, andaj si një formë e avancuar e turizmit sot njihet ekoturizmi apo turizmi i qëndrueshëm.

2.4. Gjendja e mjedisit

2.4.1. Pedologjia dhe gjeologjia

Përbërja pedologjike e mbulesës së shkriut tokësor është rezultat i bashkëveprimit të ndërsjellë të substratit gjeologjik, kushteve klimatike, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe botës organike. Faktorët kryesorë pedogjenetik të cilët ndikojnë në formimin e tokave janë: shkëmbinjtë bazë ose substrati gjeologjik, bota bimore dhe shtazore, klima, relievi etj.¹⁴ Ndryshimet horizontale dhe në lartësi të substratit pedogjen, kushteve klimatike dhe bimësisë, kanë kushtëzuar krijimin e tipeve dhe varieteteve të ndryshme të tokave në territorin e komunës së Glogocit (Drenasit). Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko-kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj.

Tokat në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit) sipas përbërjes pedologjike janë të përfaqësuara nga: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale etj.

Tokë e murrme në shtresat kompakt dhe tokë e mesme e kuqërremtë – këto toka krijohen mbi substrate acidike, të varfra me baza, mbi shkëmbinjtë kompaktë dhe sedimente të shkapërderdhura.¹⁵ Karakterizohen me diferencim të dobët të profilit, ndërsa përmbajnë pak argjilë, prandaj edhe janë të lehta për punim. Shtrihen kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Glogocit (Drenasit). **Toka e mesme e kuqërremtë** gjendet në shumë pjesë të territorit të Komunës pellgut si atë perëndimore, qendrore dhe lindore. **Tokat e kuqe** kanë një përhapje të vogël në komunën e Glogocit (Drenasit) dhe shtrihen në Gradicë. **Toka smonicë** shtrihen kryesisht në pjesën qendrore të Komunës së Glogocit (Drenasit). **Tokat rendzina** në komunën e Glogocit (Drenasit) gjenden kryesisht në Sankovc, Zabel i Epërm, Komoran, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ulët, Terstenik, Verbovc, Shtuticë dhe Gradicë, Krasmirov. **Toka rankeri** – këto toka llogariten si toka malore, po mund të ndodhë që të paraqiten edhe në terrenet e rrafshëta. Shfrytëzohen për livadhe dhe kullota e më pak për kultivimin e drithërave. Shtrihen kryesisht në Kishnarekë, Komoran dhe Zabel i Ulët. **Toka pseudogleje** – janë të formuara si rezultat i lagës së tepërt të horizontit sipërfaqësor nga ujërat stagnuese. Përhapjen më të madhe në Glogocit e kanë në Llapushnik, Dobroshevc, Grabovc, Godanc e Çikatovë. **Tokat e livadheve** shtrihen në Fushticë të Poshtme, Komoran, Zabel i Ulët dhe Korroticë e

¹⁴ Bulliqi, Sh. (2004): *Resurset natyrore. Universiteti i Prishtinës, fakulteti i shkencave matematike – natyrore, Departamenti i Gjeografisë, Prishtinë.*

¹⁵ H. Gashi, Sh. Spaho, M. Dushi: *Pedologjia, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2002*



Ulët. Tokat e këtilla janë kryesisht livadhe. **Tokat deluviale** shtrihen në Negroc, Llapushnik, Krajkovë, Sankovc, Fushticë e Epërme, dhe Dobroshevc. **Tokat aluviale** kryesisht përgjatë dy anëve të lumenjve Drenica dhe Verbovc dhe më së shumti shfrytëzohen për kultivimin e kulturave bujqësore si gruri dhe misri, por dhe perimet.




Figura 5: Harta pedologjike e territorit të Komunës së Glogocit (Drenasit)



Ndërtimi gjeologjik i komunës së Glogocit (Drenasit) i takon Fushëgropës së Kosovës, e cila është krijuar gjatë rrudhosjes së oligomiocenit. Territori i komunës së Glogocit (Drenasit) karakterizohet me një ndërtim të ndërlikuar gjeologjik që shfaqet me prezencën e shkëmbinjve me përbërje e moshë gjeologjike të ndryshme.

Territori i komunës është i ndërtuar prej sendimenteve Neogjenë, ndërsa anët e rrafshnaltës, në territorin e maleve të ulëta janë të rrethuara prej pjesëve të forta të shkëmbinjve të Paleozoikut, të vjetërsisë Jurasike dhe të shkumësit. Pjesa e ulët e rrafshnaltës është e përbërë prej tokave të punës, e rrallë prej livadheve dhe kullosave. Pjesët malore kanë kryesisht sendimente me përbërje acidike.

Formacionet e paleozoikut shtrihen në pjesën jugperëndimore, gjegjësisht në Malin përfaqësohen nga rreshpet kristalore të paleozoikut, ndërsa në pjesët e tjera të pellgut përfaqësohen nga mermeri, graniti, gabro etj. **Formacionet e triasikut** shtrihen në veri të malit Golesh dhe përfaqësohen nga shiste argjilore, ranorë të metamorfozuar, ranorë kuarcorë dhe konglomerate. Në pjesën e malin të Çyçavicës, përfaqësohen nga argjila, filitet, kuarciti. Në Çikatovë dhe Vasilevë përfaqësohen nga gëlqerorë të mermerizuar, gëlqerorë brekqorë, gëlqerorë bituminozë etj. **Formacionet e jurasikut** kanë një shtrirje në formë brezi në drejtimin veri-jug dhe gjenden kryesisht në malin Drenica.

Formacionet e kretakut në pellgun e Drenicës përfshijnë kretakun e sipërm turonian që përfaqësohet nga masivi i gëlqerorëve ranorë dhe gëlqerorëve rudistë dhe shtrihen kryesisht në pjesën veriore të Çikatovës, Verbocit etj. Këta gëlqerorë kanë ngjyrë të murrme të shndritur, të verdhë, të murrme me kristalizim të lartë. Po ashtu, kemi kretakun e sipërm senonian që shtrihet në zonën e Kosmaçit.

Sedimentet pliocenike të neogjenit shtrihen përgjatë luginës së Drenicës ku rëra dhe argjila ka pjesëmarrje më të madhe. **Sedimentet e kuaternarit** shtrihen kryesisht përgjatë lumit Drenica dhe lumit Verboc. Paraqiten në formë të depozitimeve të tarracave lumore deluvione dhe aluvione. Këto depozitime janë rezultat i shpëlarjes sipërfaqësore të materialit shkëmbor të alteruar.

Shkëmbinjtë ultrabazikë përfaqësohen nga serpentinitet dhe paraqiten në malin Golesh dhe në pjesë të ndryshme të pellgut si, në malin Drenica, Malin Kosmaç, Gllanasellë, Gradicë etj. **Shkëmbinjtë bazikë** janë gabrot (më të rrallë), dhe paraqiten në pjesën jugore dhe lindore të pellgut Drenica.¹⁶

¹⁶ Burimi: Harta Gjeologjike - *Atlasi Hidroekonomik i Kosovës* (1986) dhe *Gjeologjinë e Kosovës*, prof. Dr. V. Pruthit.
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT




Figura 6: Harta gjeologjike e territorit të Komunës së Glogocit



2.4.2. Klima

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka kryesisht klimë të mesme kontinentale me ndikim të klimës së ndryshueshme mesdhetare, ngaqë gjendet ndërmjet dy baseneve më të mëdha të Kosovës dhe ndahet prej tyre me male, lartësia e të cilave arrin mbi 1000m. Në anën lindore të Drenicës gjendet fusha e Kosovës ku mbizotëron klima kontinentale, ndërsa në anën perëndimore gjendet fushëgropa e Dukagjinit, ku mbizotëron klima e mesme kontinentale me ndikim të klimës mesdhetare. Kështu, në këtë territor dimrat janë të shkurtër dhe relativisht të ftohtë. Reshjet në formë bore janë dukuri normale gjatë dimrit. Gjatë kohës kur fryn era veriore, në këtë rajon sjell kryesisht kohë të kthjellët të shoqëruar me acar, ndërsa kur fryn era jugore sjell mot të butë dhe shkrin borën. Vera në këtë rajon është e nxehtë dhe relativisht e thatë. Pranvera dhe vjeshta kryesisht dallohen si sezone kalimtare. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, kurse shuma e temperaturave vjetore është 3.869 °C. Muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm. Lartësia mbidetare është prej 500-650m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të komunës së Glogocit (Drenasit) gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650m, lartësi kjo që është njëra ndër më të përshtatshmet për zhvillimin e prodhimitarisë bujqësore.




Figura 7: Klimadiagrami i Komunës së Glogocit (Drenasit) bazuar në të dhënat klimatologjike të Komoranit¹⁷

Nga ky klimadiagram shihet se reshjet më të pakta janë gjatë muajve të verës, sidomos në muajin gusht, ku po ashtu janë temperaturat më të larta. Reshje më të larta ka në muajin nëntor dhe janar. Ndërsa temperaturat më të ulëta janë në muajin dhjetor dhe janar. Komuna e Glogocit (Drenasit) ka potenciale për shfrytëzimin e disa prej resurseve klimatike e sidomos të erës, meqë në territorin e saj shtrihen disa hapësira të larta malore si Malet e Drenicës, Kosmaqi, Çiçavica, Goleshi etj. Që karakterizohen me potencial të erës. Zonat e tilla në të ardhmen mund të shfrytëzohen për prodhim të energjisë nga era.

¹⁷ Labus D. (1976).

2.4.3. Burimet ujore dhe menaxhimi i tyre

Komuna e Glogocit (Drenasit) ka rezerva të pamjaftueshme ujore, ngaqë i takon pjesës qendrore të Kosovës, si rajon që njihet për reshje me të pakta. Drenica paraqet lumin kryesor të Komunës së Glogocit (Drenasit) dhe mbledh të gjitha rrjedhat tjera ujore¹⁸. Ai buron në malin e Carralevës (Komuna e Shtimes). Llapushniku dhe Vërbovci konsiderohen degët kryesore të Lumit Drenica. Është me rëndësi të përmenden disa nga burime e rëndësishëm të ujit që derdhen në Lumin Drenica, siç janë: Kroi i Mbretit, Burimi i ujit mineral në Paklek, etj. Sasia e ujit që rrjedh në Pellgun e Lumit Drenica gjatë vitit është $294.88 \text{ m}^3 \times 10^6$. Nga kjo sasi, $74.87 \text{ m}^3 \times 10^6$ (25.4 %) vinë nga reshjet dhe $220.01 \text{ m}^3 \times 10^6$ (74.6 %) nga burimet¹⁹.




Figura 8: Hidrografia e Komunës së Glogocit

¹⁸ Drenica Lumi Im, Ekodi, Janar 2010

¹⁹ Drenica Lumi Im, Ekodi, Janar 2010



Sipas të dhënave të stacioneve hidrometrike, niveli më i ulët i ujit në lumin Drenica ka qenë në vitin 1963 (24 cm), ndërsa niveli më i lartë në vitin 1969 (90 cm), ndërkohë që mesatarja vjetore e nivelit të ujit të lumit është 56.6 cm. Gjatë vitit niveli më i ulët mesatar i ujit është në muajin shtator (34.3 cm), ndërsa më i larti në shkurt (85.1 cm) dhe mars (81 cm).

Përbërja gjeologjike e terrenit ka kushtëzuar që pjesa dërmuese e këtyre ujërave të jenë sipërfaqësore, por pa përjashtuar edhe praninë e ujërave nëntokësore dhe të burimeve termominerale.

Shkëmbinjtë ujëmbajtës kanë bërë që të krijohet një liqen i vogël me 17.59 ha në Vasilevë, i cili shfrytëzohet më së shumti nga vizitorë të ndryshëm për peshkim gjatë fundjavave. Ka plane²⁰ për shfrytëzimin e tij për turizëm.

Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit termal në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sek. dhe mineralizim 3.52. Kohëve të fundit (dimri 2018-19) për shkak të punimeve joadekuate në kanalizim, burimi është dëmtuar dhe më nuk është i përshtatshëm për pije dhe nuk ka karakteristikat që i ka pasur.

Hidrografia e varfër e këtij rajoni ka bërë që uji për pije të shfrytëzohet nga Liqeni i Ujmanit. Disa fshatra furnizohen edhe nga burimi i ujit në Krojkovë, i cili ka një kapacitet prej 10-12 l/s. Shumë fshatra të tjera furnizohen me ujë të pijshëm përmes puseve. Uji i tyre nuk kontrollohet dhe nuk bëhen analizat e duhura për të ditur nëse mund të përdoret për pije ose jo.

Nga Liqeni i Ujmanit vjen edhe uji për ujitjen e tokave bujqësore përmes sistemit të kanalit Iber-Lepencit. Kanali i Iber-Lepencit vjen nga fshati Hamidi (12.2 km) në Vasilevë, ku ndahet në dy degë: në anën veriore (7.7 km) dhe atë jugore (9.8 km). Ky kanal, me kapacitet të plotë, mund të ujisë 5620 ha.²¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve akumuluese të ujerave në territorin e saj, Komuna e Glogocit ka marrë vendim për shpalljen e interesit publik për lokacionin ku ndodhen ngastrat kadastrale në fshatin Verboc për ndërtimin e pendës për liqenin akumulues të Verbovcit, i cili planifikohet të shfrytëzohet për pije dhe ujitje²².

Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave sikurse edhe në gjithë territorin e Kosovës bëhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës/IHMK, ndërsa monitorimin e cilësisë ujit të pijshëm e bën Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik IKSHIP.

²⁰Identifikimi i produktit turistik në rajonin e Prishtinës, MTI 2017

²¹Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" Sh.A.

²²Vendimi i Kuvendit Komunal të Glogocit (Drenasit) Nr.12-941-43981 i datës 30.07.2018

**Tabela 9:** Burimet që shfrytëzohen për furnizim me ujë në Glogoc (Drenas)²³

Nr.	Burimi	Lloji i Burimit	Viti i Ndërtimit	Sasia l /sek
1	Krajkova	Burim	1970	6
2	Krajkova		2004	5
3	Verboc	Burim	2004	3
4	Sankoc	Burim	2001	1.3
5	Kishnareka	Burim	2004	9.5
6	Arllat (lagjja Bytyq)	Burim	1981	3.5
7	Llapushniku (lagjja Berisha)	Burim	2004	2
8	Korroticë e Epërme	Burim	2007	3.5
9	Shtutica	Burim	2009	3

Gjithashtu, ekzistojnë burime të tjera të ujit që nuk janë të shfrytëzuara, mirëpo që paraqesin një mundësi për përmirësimin e furnizimit të ujit në Drenas. Këto burime janë: Baica – 6 l/s, Nekoc - 4 l/s, Llapushnik - 2 l/s, Arllat – 2 l/s, Verboc - 3 l/s, si dhe dy (2) burime të njohura të ujit mineral njëri në “Paklek të Vjetër” (2 l/s) dhe tjetri në Verboc (0.3 l/s).

Cilësia e ujit të pijes që ofrohet nga KRU në Glogoc është prezantuar në tabelën 10. Nga kjo tabelë mundë të konstatohet se ka mospërputhje të vogël me standardet e ujit të pijes për vitet 2016 dhe 2017 sa i përket parametrave kimik sikurse janë Bakteret klori residual, turbullira dhe Nitratet. Ndërsa një mospërputhje e vogël gjatë vitit 2017 është konstatuar edhe për parametrat mikrobiologjik.

Tabela 10: Kualiteti i ujit të pijshëm në Glogoc²⁴

Viti	Konsumit mesatar ditor (m ³ /ditë)	Shkalla e përputhshmërisë (%)		Shkaku i mospërputhjes
		Mikrobiologjike	Kimike	
2016	6043	100	96.02	Klori rezidual dhe turbullira
2017	6043	98.63	96.41	Bakteret klori residual, turbullira dhe Nitratet NO2

²³ Plani Investues për Ujësjellës dhe Kanalizim në Glogoc (Drenas) – Komuna e Glogocit (Drenasit), 2010

²⁴ Raportet vjetor për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë, për vitet 2016 dhe 2017, IKSH



Trajtimi i ujit bëhet nga Impianti për Trajtimin e ujit Bivolak i cili është ndërtuar në vitin 1980 në mënyrë që të furnizojë Glogocin me ujë, duke e trajtuar ujin nga sistemi Ibër-Lepenc. Kapaciteti i këtij është 5.2 ml/ditë.²⁵

Proceset e trajtimit janë: Procesi i trajtimit fizik (Sedimentimi Fizik dhe Filtrimi), Procesi i trajtimit kimik (Aluminium-Sulfati, Poliektroliti dhe Klorifikimi final i ujit të trajtuar) dhe Klor i gazifikuar (Sistem i dozës me normë të fiksuar).

Në komunën e Glogocit (Drenasit) ekzistojnë nëntë (9) sisteme për furnizim me ujë: Sistemi i KUR për furnizim me ujë mbulon nëntë (9) vendbanimet që pasojnë: Glogoc (I, II dhe III), Paklek i Ri dhe zonat rurale, fshatrat Çikatove e Vjetër, Paklek i Vjetër, Shtrubullovë, Gllbar, Tërstenik, Gllanasellë dhe një pjesë të Dobroshecit).

8 sistemet tjera të vogla rurale që nuk menaxhohen nga KUR janë: Llapushnik, Shtuticë, Verbovc, Terdevc, Kishnareka, Arllat, Sankoc dhe Korroticë e Lartë. Në disa vendbanimet tjera nuk ka sistem publik të furnizimit me ujë.

Në komunën e Glogocit (Drenasit) ndodhet një stacion matës për matjen e Nivelit (h) dhe Prurjes (Q) së ujit që është pjesë e rrjetit hidrometrik të Kosovës. Sipas të dhënave nga ky stacion sasia minimale e prurjes është 0.02 m³/s, mesatarja 1.52 m³/s dhe ajo maksimale është 32.80 m³/s.

Nuk ka pikë monitoruese për monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në territorin e komunës së Glogocit (Drenasit), megjithëkëtë monitorimi i cilësisë së ujit në lumin Drenica bëhet në një pikë monitoruese në Pjetërshicë në pjesën e rrjedhës së epërme dhe në një pikë tjetër në rrjedhën e poshtme para bashkimit me Sitnicën në Vragoli.

Të dhënat flasin se gjatë stinës së pranverës në stacionin e parë monitorues ka një cilësi më të mirë përderisa në stacionin e dytë në Vragoli gjendja e tij pëson ndryshime të theksuara sidomos për parametra fiziko kimik. Po ashtu në këtë pikë monitoruese janë regjistruar tejkalime të Vlerave Limite të Lejuara edhe për disa metale të rënda si Kromi (Cr3-), Mangani (Mn 2+) dhe Hekuri (Fe 2+)²⁶.

Burimet kryesore të ndotjes të ujërave sipërfaqësore vlerësohen të jenë mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, ujërat industrial, përdorimi i pesticideve dhe hedhjes së mbeturinave të ngurta²⁷. Numri i popullsisë së kyçur në sistemin publik të kanalizimit në komunën e Drenasit është diku rreth 21,534 ose 37% të popullsisë dhe numri i vlerësuar i ekonomive familjare të kyçura është 3,246.²⁸ Ekzistojnë katër (4) pika të shkarkimit nga rrjeta e ujërave të zeza e menaxhuar nga KUR. Pika e parë e shkarkimit afër “Rruga e Baicës” dhe pika e dytë e shkarkimit afër “Ura e Drenasit” shkarkojnë ujërat e tyre në Lumin Verboci (gjithashtu i njohur si Vërbicë). Pika e tretë e shkarkimit në Paklek dhe pika e katërt e shkarkimit në lokacionin “te Xhamia e Glogocit (Drenasit)” i shkarkojnë ujërat e tyre në Lumin Drenica.

²⁵ Studimi i Fisibilitetit për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë; HYDROPLAN GmbH; 2009

²⁶ Raporti për gjendjen e ujerave 2015, AMMK

²⁷ Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK

²⁸ Master Plani për Kanalizim & Ujëra të Zeza për Pellgun e Lumit Morava Perëndimore /Raporti i Inventarit të Aseteve për Glogoc, 2011.



Fabrika e Feronikelit në kuadër të proceseve të saj operative për qëllim të: Ftohjes së furrave elektrike, Granulimin e skories, Skruberi-ftohësi në konvertorë (trajtimi i emisioneve) dhe avulli në ngrohore. Fabrika ka një sistem të brendshëm për trajtimin e ujërave të përdorura. Sipas të dhënave të raportuara nga kjo kompani në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.30/2014- për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujerave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor mundë konstatohet se ka tejkalimi të vlerave të lejuara për përçueshmëria elektrike dhe materiet e tretshme në ujë. Derisa metalet e rënda që monitorohen nga ky operatorë si: hekuri, kobalti, nikeli dhe kromi, nuk tejkalojnë vlerat e lejuara në bazë të UA Nr.30/2014²⁹.

Tabela 11: Burimet e shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore

Burimi i ndotjes	Numri	Ndotësit që shkarkohen në ujëra
Ekonomive familjare të kyçura në rrjetin e kanalizimit	21,534 banorë 3,246 ekonomi familjare	Nitratet Fosfatet Substancat organike
Institucioneve publike të kyçura në rrjetin e kanalizimit	55	Nitratet Fosfatet Substancat organike
Bizneset e kyçura në rrjetin e kanalizimit	Rreth 300	Nitratet Fosfatet Substancat organike
Ujërat industriale nga fabrika e Feronikelit	Një pikë shkarkuese në lumin Drenica	Metalet e rënda

Sipas ligjit të ujërave komuna është kompetente për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore brenda zonave urbane.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve nga lumenjtë dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore.

Në bazë të Vendimit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës Nr. 02/46 dt. 02.11.2011 u ndalohet të gjithë operatorëve që bëjnë eksploatin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve në të gjithë territorin e Kosovës. Në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit) nuk ka ndonjë operator të licencuar që bënë eksploatin e inerteve nga lumenjtë.

Për menaxhimin më efikas të ujërave komuna e Glogocit (Drenasit) duhet të koordinohet me aktivitetet, vendimet, masat dhe qëllimet e vendosura nga niveli qendror e sidomos nga Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e ujërave.

²⁹ Gjendja e Mjedisit ne zonën e Operimit të NewCo Feronikeli, AMMK 2015



2.4.4. Cilësia e ajrit

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale.

Për cilësinë e ajrit në Komunë e Glogocit (Drenasit) nuk të thuhet se ende është në nivel jo të kënaqshëm. Lidhur me cilësinë e ajrit mundë ti referohemi të dhënave nga stacioni i monitorimit të cilësisë së ajrit i tipit urban i vendosur në zonën urbane të qytetit që menaxhohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Të dhënat flasin se ka tejkalime të parametrave të lejuar sidomos gjatë stinës së dimrit.

Tabela 12: Karakteristikat e stacionit monitoruese për cilësinë e ajrit në Glogoc

Emërtimi i Stacionit monitorues	Shenja (Kodi) i stacionit	Lokacioni	Parametrat e monitoruar	Tipi i zonës së monitorimit (sfondi)	Data e funksionalizimit
Glogoc (Glogoc)	KS0103	Kuvendi Komunal ³⁰	PM10, PM2.5, SO ₂ , NO _x , CO, O	Sfondi urban	05.04.2011

Tabela 13: Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) µg/m ³	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m ³	30	Nuk parashihet
SO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimale 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m ³	10	Nuk parashihet
PM ₁₀	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	50	35

³⁰ Gjatë vitit 2019, stacioni për monitorimin e cilësisë së ajrit në Glogoc (Drenas) është dislokuar nga oborri i Kuvendit Komunal, në oborrin e Ambulancës së qytetit.



	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	120	Nuk parashihet

Qytetarët e Glogocit (Drenasit), mundë të informohen për cilësinë e ajrit në këtë komunë edhe platformës online airquality që mundëson që të dhënat për cilësinë e ajrit të shikohen në kohë reale përmes ueb aplikacionit dhe përmes aplikacioneve në telefonat smart.

Ky sistem është lansuar në fillim të viti 2018 dhe menaxhohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Përmes sistemit online mundësohet informimi i saktë dhe në kohë reale i publikut për cilësinë e ajrit. Softueri për raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit është kompatibil me Indeksën e Kualitetit të Ajrit në Evropë dhe prezanton të dhënat e monitorimit të 5 indikatorëve kryesor në 8 stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Në sistemin e të dhënave për cilësi të ajrit në kohë reale mundësohet qasje duke klikuar direkt në linkun e sistemit të të dhënave në ueb faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, ueb apo edhe përmes linkut: <http://www.kosovo-airquality.com/secure/index2.html>

Sipas të dhënave të AMMK të prezantuara në Raportin Vjetor për Gjendjen e ajrit për vitin 2018, gjatë këtij vitit në Glogoc janë regjistruar 82 tejkallime për parametrin PM10.

Tabela 14: Cilësia e ajrit në Glogoc Janar-Dhjetor 2018

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mes. 2018
PM 10 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	64.6	34.6	31.8	43.3	25.5	21.3	22	29.1	33.8	48.1	63.1	69.4	40.55
PM ditët me tejkallime	14	4	3	11	0	0	0	0	3	12	17	18	82
PM 2.5 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	54.6	26.3	17.5	14.5	12.2	10.3	11.3	14	15.7	25.5	39.7	51.4	24.41
NO2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	24.2	14.8	12.5	10.5	8.8	6.7	5	8.4	10.2	13.4	14.2	23.6	12.69
SO2 $\mu\text{g}/\text{m}^3$	119.4	115.2	94.3	12.4	4.8	2.3	2.6	5.7	5.6	9.4	15.6	35.20	119.4
CO mg/m^3	*	*	*	0.5	0.49	0.7	0.9	0.89	0.76	5.6	1.1	1.6	1.39
O $\mu\text{g}/\text{m}^3$	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*

Shënim: (*) Nuk ka pasur matje për Ozonin gjatë tërë vitit ndërsa për CO nuk ka pasur matje gjatë muajve Janar, Shkurt dhe Mars.




Figura 9: Vlerat mesatare mujore të PM10&PM2.5 në Stacionin e Glogocit (Drenasit)

Sa i përket monitorimit të metave të rënda sipas një projekti të financuar nga UNDP për monitorimin e PM10 dhe përcaktimi e metave të rënda në zonën Glogocit (Drenasit) janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara vetëm për metalin e Nikelit (Ni). Në kuadër të këtij projekti është vlerësuar përqendrimi i metaleve të rënda në PM10, për metalet Arseni (As), Kadmiumi (Cd), Kromi (Chr), Bakri (Cu), Mercuri (Hg), Nikeli (Ni), Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Hekuri (Fe). Sipas rezultateve nga analizimi i filtrave janë regjistruar tejkalime të vlerave të lejuara ($20 \mu\text{g}/\text{m}^3$) vetëm për metalin e Nikelit (Ni), në 12 raste, kryesisht gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2015 në të katër lokacionet e mostrimeve (Çikatovë e vjetër, Çikatovë e Re, Gllobar dhe Lagja e Feronikelit)³¹.

Sa i përket emisioneve në ajër nga burimet e ndryshme të ndotjes, Komuna e Glogocit (Drenasit) nuk ka bërë ndonjë inventar të burimeve të ndotjes së ajrit dhe për këtë nuk mundë të flitet me saktësi për burimet kryesore të ndotjes.

Si ndotës të ajrit në Komunën e Glogocit (Drenasit) mundë të konsiderohen: aktivitetet nga operatori industrial New Feronikeli, transporti, përdorimi i thëngjillit dhe drurit për ngrohje nga ekonomitë familjare, komerciale dhe institucionale, aktivitetet e gurëthyesve etj.

Kompleksi Industrial i NewCoFeronikeli përbëhet nga Shkritorja dhe dy Miniera sipërfaqësore, ajo në Çikatovë dhe Gllavicë. Eksploatimi i xehes është sipërfaqësore, por kohë pas kohe bëhet edhe furnizimi me xehe nga importi. Me punën që bënë gjatë procesit të prodhimit të Fe-Ni metalik ky kompleks ndikon në lirimin e pluhurit si dhe gazrave (CO , CO_2 , SO_2 , NO_x) të cilat kanë ndikim në

³¹ UNDP/IHMK, "Monitorimi i PM10 në ajër dhe përcaktimi i metaleve të rënda në PM10 në zonën e Drenasit, Tetor 2015 – Mars 2016".



mjedis dhe në shëndetin e njeriut. NewCoFeronikeli e kryen monitorimin e emisioneve përmes kontraktimit të një kompanie të jashtme ("Tehnolab" nga Shkupi/Maqedoni).

Sipas të dhënave të emisioneve në ajër të raportuara nga operatori NewCo Feronikeli dhe të publikuara në Raportet për cilësinë e ajrit dhe Raportet për gjendjen e mjedisit nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës mundë të thuhet që gjatë viteve 2013-2014 ka pasur tejkalime të parametrave të lejuara për emisione për parametrin PM10, SO₂ dhe NO_x, ndërsa gjatë vitit 2015 këta parametra kanë qene në kufijtë e normave të lejuara³².

Ne bazë të të dhënave të ofruara nga Komuna e Glogocit (Drenasit) si burime tjera të ndotjes në këtë komunë konsiderohet edhe ekonomitë familjare, institucionet publike dhe bizneset e vogla, që përdorin lëndë djegëse (thëngjill, dru, pëllet etj), për ngrohje, si dhe veturat.

Në tabelën 15 janë prezantuar burimet kryesore të ndotjes në komunën e Glogocit (Drenasit).

Tabela 15: Burimet e ndotjes së ajrit në Komunën e Glogocit (Drenasit)

Lloji i burimit të ndotësit	Numri i njësive	Aktiviteti i ndotjes	Ndotësit që shkarkohen në ajër
Objektet e ekonomive familjare (shtëpi dhe banesa)	4,028	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NO _x Monoksidi i Karbonit CO
Objektet publike (administrata, shëndetësore, arsimore, kulturore, kulturore, sportive dhe sociale)	55	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet, naftë etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NO _x Monoksidi i Karbonit CO
Objektet e bizneseve të vogla (furat e bukës, kafe-restaurante, hotele, dyqane, shërbime tjera)	Rreth 280 objekte (50 shërbime, 60 hotele, 70 industri, 100 tjera)	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pëllet etj) për ngrohje	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NO _x Monoksidi i Karbonit CO
Numri i automjeteve	9843 ³³	Përdorimi i produkteve të naftës për djege Vjetërsia e automjeteve	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NO _x Monoksidi i Karbonit CO

Në komunën e Glogocit në kuadër të pjesëmarrjes së burimeve energjetike që përdoren për ngrohje dominojnë thëngjilli dhe druri kundrejt paletat dhe naftës. Kjo pjesëmarrje e burimeve energjetike

³² Gjendja e Mjedisit në zonën e Operimit të NewCo Feronikeli, AMMK

³³ Burimi: Qendra e regjistrimit të automjeteve në Glogoc (Drenas)



që përdoren për ngrohej është pothuajse e njëjtë si tek objektet publike po ashtu edhe tek objektet e ekonomive familjare (shtëpi dhe banesa).³⁴

Megjithëkëtë për të pasur një pasqyrë më të detajuar për burimet kryesore të ndotjes dhe ndikimin e tyre, komuna duhet të hartojë inventarin e ndotësve në ajër dhe të bëjë modelimin e shpërndarjes së ndotësve. Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi mundë të propozohen edhe masa konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit, sikurse janë aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore në zonën urbane të qytetit, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje, ndërtimi i objekteve industriale larg zonave të banuara urbane si dhe respektimi i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Në kuadër të masave tjera për mbrojtjen e ajrit nga ndotja mundë të përfshihen edhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullte e rrugëve.

Një mundësi potenciale që ka Komuna e Glogocit (Drenasit) për të zvogëluar ndotjen përmes reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse në zonën urbane është edhe ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore me instalimin e impianteve për bashkëprodhim duke shfrytëzuar një pjesë të energjisë që lirohet nga kullat e ftohjes të kompleksit industrial të shkrites së Feronikelit.

2.4.5. Zhurma

Fabrika e Feronikelit, trafiku rrugor dhe ai hekurudhor janë burimet kryesore të zhurmës në Komunën e Glogocit (Drenasit). Në mënyrë të veçantë këto burime të zhurmës intensifikohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme sikurse janë aktivitetet e ndërtimit, transporti i mallrave, gurëthyesit, përdorimi i pajisjeve industriale e tjera. Për asnjë nga këto burime të zhurmës nuk ka barriera që do të reduktonin nivelin e zhurmës dhe ndikimin e saj tek banorët e zonave ku shtrihen këto burime.

Aktualisht nuk ka ndonjë matje të organizuar të nivelit të zhurmës në komunë, sikurse që nuk ka ndonjë ankesë konkrete për nivelin e zhurmës. Megjithëkëtë komuna duhet të ketë për bazë që zhurma është një nga ndotësit e mjedisit dhe matja e nivelit të saj është e nevojshme për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të popullatës ndaj këtij ndotësi. Njëherit kjo është edhe kërkesë ligjore që del nga Ligji për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Sipas këtyre kërkesave komuna obligohet të hartojë Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës, përmes së cilave do të identifikohen lokacionet që i ekspozohen zhurmës, prezantimi i tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

³⁴ *Draft Plani Komunal i Veprimit për Efijencë të Energjisë*



2.4.6. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut

Komuna e Glogocit (Drenasit) karakterizohet me një llojllojshmëri të tokave duke u bazuar në gjenezën e krijimit të tyre dhe karakteristikave pedologjike, fizike dhe kimike. Sipërfaqja tokësore e Komunës së Glogocit (Drenasit) është e përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Llojet e tokave që më së shpeshti i hasim në këtë komunë janë: tokat e murrme në shtresa kompakte, tokat e mesme të kuqërremtë, tokat e kuqe, tokat smonicë, tokat rendezinë, tokat ranker, tokat pseudogleje, tokat e livadheve, tokat diluviale dhe tokat aluviale.

Sa i përket mbulushmërisë së sipërfaqeve të tokave pjesën më të madhe e përbëjnë pyjet, tokat e punueshme dhe zonat tjera të sipërfaqeve bujqësore (Tabela 16 dhe figura 10).

Tabela 16: Kategoritë e mbulushmërisë së sipërfaqes së tokës në Komunën e Glogocit (Drenasit)

Kodi CLC18	Mbulesa tokësore	Sip. Ha	% Sip.
312	Pyjet Halore	63	0.23%
132	Zonë e Grumbullimit të Mbeturinave	44	0.16%
512	Trupat Ujorë	26	0.09%
133	Punishtet e Ndërtimit	54	0.20%
122	Rrjeti Rrugor dhe Hekurudhor	71	0.26%
112	Strukturë jo e vazhdueshme urbane	1244	4.50%
121	Njësit Industriale ose Komerciale	252	0.91%
131	Zonë e Nxjerrjes së Mineraleve	104	0.38%
211	Tokë e Punueshme pa sistem të ujitjes	5709	20.67%
231	Kullotat	841	3.04%
242	Struktura komplekse për kultivim	6026	21.81%
243	Tokë e nxënë kryesisht nga kultura bujqësore, me sipërfaqe të konsiderueshme të vegjetacionit natyror	2332	8.44%
311	Pyjet gjetherënëse	9164	33.17%
321	Tokë livadhore natyrore (livadhe natyrore)	646	2.34%
324	Zona kalimtare pyje - shkurre	759	2.75%
333	Fusha të dobëta me vegjetacion	289	1.05%
	Gjithsej	27624 Ha	100%




Figura 10: Harta e mbulushmërisë së sipërfaqes së tokës në Komunën e Glogocit (Drenasit)³⁵

³⁵ AMMK, CLC 2018



Ndikimet e vazhdueshme nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave. Toka është komponent kryesorë e biosferës në të cilën rritet dhe zhvillohet bota bimë dhe shtazore e me këtë kuptohet edhe prodhimtaria bujqësore.

Çdo shfrytëzim i tokës për çfarëdo qëllimi bartë me veti mundësinë e rrezikut dhe çdo sjellje jo racionale gjatë shfrytëzimit të saj kanë pasoja direkt dhe indirekte të degradimit. Deri te ndotja e tokës vije nëpërmjet ndotjes së ujit, ajrit, përmes përdorimit të plehrave minerale dhe pesticideve, nga deponitë ilegale të mbeturinave etj.

Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe industritë kimike, përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale, ndotja e tokës me materiale radioaktive, ndotja e tokës me metale toksike si dhe ndotja e tokës me mikro organizma patogjen. Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave.

Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Aktualisht as operatorët ekonomik me potencial ndotës të mjedisit nuk e bëjnë monitorimin e rregullt të cilësisë së tokës (dheut). Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm. Megjithatë ky problem është adresuar përmes projekteve specifike. Një nga këto projekte ka qenë projekti i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për studimin e tokës bujqësore në Kosovë (ALPS-Agriculture Land Pollution Survey). Qëllimi kryesorë i projektit ka qenë të bëjë vlerësimin e ndotjes së tokës bujqësore.

Në kuadër të projektit janë analizuar mostrat toke për 17 metale të rënda, mostra toke për treguesit e pjellorisë (pH, CEC, OM, MO, N, P₂O₅, K₂O), mostra toke për përmbajtjen e ndotësve organik dhe mostra bime për metale të rënda. Vlerësimi i ndotjes së tokës ka qenë i orientuar në zonat potenciale të ndotjes si: zonat industriale, uji i ndotur dhe mbetjet, përmbajtjet, aktivitetet bujqësore etj. Në tabelën 17 janë paraqitur llojet e mostrave të analizuar të dheut në komunën e Glogocit.

Tabela 17: Llojet e mostrave të dheut të analizuar³⁶

Komuna	Tokë bujqësore /ha	Mostra /ha	Mostra të analizuar për metale të rënda	Mostra të analizuar për parametra të fertilitetit të tokës	Mostra e bimëve të analizuar për metalet e rënda	Mostra të analizuar për ndotësit organik në tokë
Glogoc	12,550.00	50	249	249	15	7

³⁶ Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, MMPH/GIZ 2015



Rezultatet kyçe të projektit janë këto:

- Përqendrimet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cr, Ni, Cd, Pb, Hg, Zn, Cu, si dhe Ni) janë brenda standardeve të ndotjes së tokës.
- Nivelet e larta të metaleve të rënda (p.sh. të Cr, Ni, Pb dhe Cd), kanë rezultuar sipas studimit në terren që nuk kanë qenë zona bujqësore ose toka që përdoren për qëllime jo bujqësore/urbane.
- Nuk është identifikuar ndotja e të lashtave (perime, drithëra dhe fruta), nga metalet e rënda (në veçanti Cr, Ni, Pb, Zn,) prej mostrave të tokës për qëllime bujqësore.

Në komunën e Glogocit (Drenasit) ekzistojnë disa deponi ilegale të mbeturinave komunale dhe deponi të mbeturinave industriale që janë si burime të ndotjes së tokave.

Faktorët tjerë që dëmtojnë cilësinë e tokave në Glogocit (Drenasit) janë: ndërtimet e paplanifikuara, deponitë industriale, deponitë e mbeturinave, erozioni, eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

Deponia Industriale e Feronikelit ndodhet në Çikatovë dhe ka një sipërfaqe prej 24ha, ndërsa zona e ndikimit të saj është 71.37ha. Ky trend i ndotjes dhe degradimit të tokës akoma është në rritje, përkundër shumë masave të ndërmarra nga institucionet lokale dhe qendrore.

Përgjatë rrugëve kryesore tokat e shumta janë duke u zënë nga objektet afariste pa një strukturë të mirëfillte të planifikimit. Mungesa e planeve, mungesa e kontrollit të zbatimit në hapësirat ku ka pasur plane (Qendra e Glogocit (Drenasit)), konsiderohet të jetë në favor të ndotjes së tokës. Ndotja nga metalet e rënda dhe shumë komponime organike është praktikisht e pakthyeshme (Komisioni Evropian, 2012). Dheu ka aftësi të kufizuar për të përpunuar kemikalet, për shembull nëpërmjet filtrimit apo transformimit³⁷.

Eksploatimi i zhavorrit është shumë i shfaqur në Komunën e Glogocit (Drenasit) dhe atë shpesh guroret ndodhen në afërsi ngjitur me lumin Drenica, siç është rasti në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Poklektit dhe Çikatovë të Vjetër.

Ndotja shkaktohet edhe nga **deponitë** ilegale, ndonëse numri i tyre është zvogëluar dukshëm viteve të fundit. Nga 80 deponi që janë eliminuar, mbesin edhe rreth 50 sosh ekzistuese³⁸ në territor të komunës.

Nuk ka informacione të plota për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga erozioni. Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor 2010-2020. Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës. Pra, për parandalimin e erozionit kërkohet një seri masash teknike, programore dhe ligjore sikurse janë: Kufizimi i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe zhvillimi i kontrolleve adekuate për secilën zonë, përcaktimi ligjor i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe informimi i rregullt dhe dhënia e udhëzimeve për të gjitha entitetet e prekura.

³⁷Studimi mbi Ndotjen e Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, Identifikimi i burimeve të ndotjes dhe propozimet për masat e përmirësimit, Janar 2015

³⁸Raporti i performances komunale, Drenas 2017



2.4.7. Menaxhimi i mbeturinave

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është ende larg standardeve evropiane. E njëjta vlen edhe për komune të Glogocit (Drenasit). Megjithatë gjatë viteve të fundit është shënuar progres në procesin e menaxhimit të mbeturinave. Komuna ka hartuar dhe miratuar Planin e menaxhimit të mbeturinave (2015-2020), dhe Rregullore për menaxhimin e mbeturinave (Nr. 501-1768 të datës 27 dhjetor 2012).

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Glogocit (Drenasit) aktualisht shtrihen në të gjitha vendbanimet e komunës, mirëpo nuk përfshinë të gjitha ekonomitë familjare.

Nga numri i përgjithshëm i ekonomive familjare të komunës së Glogocit (Drenasit) (8681 ekonomi familjare), rreth 6024 ekonomi familjare ose 69% e tyre janë të përfshirë me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Tabela 18: Mbulimi i territorit komunës me shërbime të grumbullimit të mbeturinave

Lloji i ekonomive dhe institucioneve	Nr.	%
1. Ekonomi familjare në komunë	8681	100
2. Ekonomi familjare të përfshira në sistemin e mbeturinave	6024	69
3. Institucione publike në komunë	62	100
4. Institucione publike të përfshira në sistemin e mbeturinave	29	46.7
5. Ekonomi komerciale dhe industriale në komunë	2335	100
6. Ekonomi komerciale dhe industriale të përfshira në sistemin e mbeturinave	470	20

Në qytet mbledhja e mbeturinave bëhet për çdo ditë, në fshatra 1 herë në javë. Grumbullimi bëhet përmes 102 kontejnerëve me vëllim prej 1,1m³, 6 kontejnerë të madhësisë 7 m³, e në fshatra grumbullimi bëhet përmes 6095 shportave prej 120 l dhe 72 shportave të madhësisë prej 240 litrave.. Në ditë grumbullohen dhe zbrazen 30 tonë mbeturina. Sasia e deponimit të mbeturinave për kokë banori në vit është 105.7kg. Arkëtimi për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është rreth 87%. Komuna e Glogocit (Drenasit) ka një qendër të transferit për grumbullimin e mbeturinave e cila ndodhet pranë minierës së Feronikelit në Glogoc. Pas grumbullimit në këtë qendër mbeturinat dërgohen në Deponin Sanitare në Mirash.

Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin ende një ndër problemet kryesore në sektorin e mbeturinave në këtë komunë. Janë evidentuar 137 deponi ilegale, prej tyre mbi 80 janë të rehabilituar.

Sa i përket riciklimit Komuna e Glogocit (Drenasit) ende nuk ka arritur të realizojë ndonjë program të organizuar në tërë territorin e Komunës. Ekzistojnë disa iniciativa të vogla të mbështetura nga donatorët dhe të implementuara nga organizatat joqeveritare. Në kuadër të këtyre iniciativave ka filluar edhe procesi i ndarjes së mbeturinave në burim, në 16 pika të grumbullimit të mbeturinave në qytet.



Ka disa iniciativa të vogla edhe për kompostimin e mbeturinave organike komunale kryesisht përmes shpërndarjes së komposterëve familjarë.

Problemet kryesore për sektorin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta janë identifikuar dhe janë adresuar për zgjidhje përmes Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Glogocit (Drenasit) 2015-2022, andaj PZHK duhet ti marrë parasysh këto planifikime të Komunës për këtë sektor.

Komuna përmes një vendimi Nr.383-29533 të datës 05.06.2014, ka adresuar edhe problemin e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit. Përmes këtij vendimi komuna ka caktuar zonën e quajtur Rudishte në zonën kadastrale të Komoranit si lokacion për deponimin e këtyre mbeturinave.

2.4.8. Zonat e mbrojtura, biodiversiteti dhe pyjet

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës³⁹. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës në mesin e të cilave janë edhe asetet e Trashëgimisë Natyrore të komunës së Glogocit (Drenasit).

Tabela 19: Lista e zonave të mbrojtura në Glogoc

Kodi	Emërtimi i Zonës/ objektit	Sipërfaqja/ ha	Kategoria sipas IUCN	Viti i marrjes në mbrojtje	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
MN_017	Shpella e Baicës	0.11	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gllanasellës	0.5	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_024	Trungjet e rrënjës (Quercus robur) në Nekovc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_025	Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Negroc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_026	Trungjet e shpërdhit në Negroc	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_027	Shpella e Kishnarekës	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik

³⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2716>



MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_030	Burimi i ujit mineral, në Poklek	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_031	Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_032	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Tërstenik	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_033	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoshan	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik

Në territorin e Komunës së Glogocit (Drenasit) shtrihet edhe Liqenet e Vasilevës, që karakterizohen me një biodiversitet të pasur bimor, shtazor dhe peisazhor. Për shkak të këtyre vlerave që disponon kjo zonë, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, ka hartuar një arsyeshmëri dhe ka propozuar shpalljen e kësaj zone si Peisazh i Mbrojtur i Natyrës. Zona e propozuar për mbrojtje e Peizazhit të Mbrojtur “Liqenet e Vasilevës” përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 320.9 ha. Edhe pse këto janë liqene artificiale të krijuara me depozitimi i materialit (dheut) nga mihjet sipërfaqësore në Bardh dhe Mirash nga Korporata Elektroenergjetike e Kosovës në vitet e ‘60 të shekullit të kaluar, ato paraqesin zonë të rëndësishme të natyrës dhe me potencial për zhvillimin e turizmit⁴⁰.



Figura 11: Peisazh nga Liqenet e Vasilevës

⁴⁰ AMMK-IKMN/Propozim profesional për shpalljen e Liqeneve të Vasilevës Peizazh i Mbrojtur, 2014
DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT



Figura 12: Harta e zonës së propozuar për mbrojtje Liqet e Vasilevës

Një zonë tjetër natyrore me rëndësi për Komunën e Glogocit (Drenasit) janë Bjeshkët e Çyçavicës. Kjo zonë përmes një memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga komunat ku shtrihen këto bjeshkë (Glogocit, Obiliq, Skenderaj, Mitrovicë dhe Vushtrri) është shpallur si zonë e interesit të përgjithshëm me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore të kësaj zone.

Flora dhe vegetacioni i territorit të Komunës së Glogocit (Drenasit) - Territori i komunës së Glogocit (Drenasit) zë një vend të rëndësishëm në Kosovë nga aspekti floristik dhe vegetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Glogocit (Drenasit) i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshinë viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër. Ky region, prezantohet me dy province fitogjeografike të cilat janë:

1. Provinca Mezike, e cila përfshinë shpatet e Malit të Çyçavicës në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territor paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (Querco – Carpinetum Rud.) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (Fagetum montanum Rud.), dhe

Në bazë të kësaj që u përmend më lart, mund të konstatohet se në territorin e Glogocit (Drenasit) janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezantuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike.



Në territorin e Glogocit (Drenasit) janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore:

- Ass. Carpinetum orientalis scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shkozë së zezë),
- Ass. Quercetum farnetto – cerris scardicum, Krasniqi (Bashkësia e shpardhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m,
- Ass. Quercetum montanum, Çer. et Jov. (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (Quercus petraea),
- Ass. Fagetum montanum Rud. (Bashkësia e ahut).

Në zonën përreth Guri i Gradinës në të gjitha ekspozicionet është prezentë fitocenoza Fagetum Montanum me rreth 47 lloje që kanë një shtrirje mjaft të gjerë përreth monumentit. Në bazë të kësaj pasqyre floristike dhe vegetative të territorit të Glogocit (Drenasit) mund të konstatohet se: territori i Glogocit (Drenasit) ka florë dhe vegetacion relativisht të mirë mirëpo në degradim e sipër si pasojë e veprimit negative të faktorit antropogjen (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe se në shumë lokalitete të territorit të Glogocit (Drenasit) duhet të bëhen intervenime pozitivë drejt normalizimit të gjendjes natyrore duke bërë pyllëzimin me llojet adekuate.

Fauna në territorin e Glogocit (Drenasit)- Si rezultat i aktiviteteve antropogjene e sidomos ato gjatë shndërrimit të hapësirës natyrore në territor agrikulor, industrial apo territor për banim disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto zona janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë: dreri, dhia e egër, pulelegra etj. Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e Glogocit (Drenasit) janë: ariu (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), dhelpra (Vulpes vulpes), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (Sus scrofa), vjedulla (Meles meles), ketri (Sciurus vulgaris), sqarthe (Martes foina), vidra, lepuri (Oryctolagus cuniculus), disa lloje të brejtësve të vegjël, gjeraqina, skifteri i përhimtë, petriti (Falco tinnunculus), kukuvajka, huti (Bubo bubo), harabeli, thëllënza (Alectoris graeca), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (Dendrocopos major), qyqja (Cuculus canorus), lauresha, borësi, rosat e egra (Anser anser), patat e egra (Anas platyrhynchos), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhime, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (johelmues), picrraku (Salamandra atra), tritoni (Triturus vulgaris), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krap (Cyprinus caprio), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurrizorëve etj. Në zonën përreth Guri i Gradinës, sipas të dhënave që posedon AKMM në këtë hapësirë hasen këto lloje shtazore: 8 lloje gjitarësh, ndërsa dy lloje të tjera të gjitarëve janë zhdukur, 9 lloje shpendësh, 4 lloje zvarranikësh, 2 lloje ujë-tokësor. Komuna e Glogocit (Drenasit) është e pasur me resurse pyjore dhe përfshin një sipërfaqe prej 11,355.00 ha. Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ri-pyllëzim, rekreacion dhe turizëm. Zonat me të rëndësishme pyjore shtrihen në malet e Berishës, Kosmaç dhe në Çyçavicë. Në territorin e Glogocit (Drenasit) janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile. Komuna është e kufizuar me dhënie e lejeve për ndërtim në këto zona. Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm për florën dhe faunën në komunë, për klimën dhe ekonominë lokale. Druri këtu përdoret për ndërtim, artizanate tradicionale, përpunime industriale dhe ngrohje. Konsiderohet se pjesët e prera të pyjeve në vitet e fundit duhet ri-pyllëzuar.



3. Çështjet kyçe mjedisore dhe socio-ekonomike, problemet mjedisore dhe objektivat e VSM-së

Nga përshkrimi i gjendjes mjedisore dhe asaj socio ekonomike mundë të nxirren këto konkluzione:

- Glogoci ka pozitë të përshtatshme gjeografike që i mundëson lidhje dhe mundësi zhvillimi.
- Komuna e Glogocit (Drenasit) ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja por edhe në migrimin e jashtëm.
- Industria e metaleve dhe bujqësia përbëjnë sektorin kryesor të zhvillimit ekonomik krahas biznesit dhe tregtisë që përcillet edhe me infrastrukturë përkatëse.
- Komuna e Glogocit (Drenasit) ka vlera të trashëgimisë kulturore dhe mundësi të mira për zhvillimin e turizmit rural, kulturor dhe atij natyrorë.
- Territori i komunës së Glogocit (Drenasit) konsiderohet se ka një rrjet jo edhe aq të zhvilluar hidrografik. Gjendja e lumenjve dhe e ujërave sipërfaqësore nuk është e mirë, veçanërisht është i shprehur ndotja nga ujërat urbane, ujërave industriale dhe hedhja e mbeturinave në lumenj.
- Cilësia e ajrit është e ndikuar dukshëm nga Fabrika e Feronikelit, por edhe nga aktivitetet e transportit dhe përdorimit të thëngjillit si lëndë djegëse. Komuna nuk ka inventar të ndotësve të ajrit dhe nuk ka bërë ndonjë hulumtim për shtrirjen hapësinore të ndotësve.
- Numri i madh i deponive ilegale të mbeturinave, ndërtimet e paplanifikuara, dhe ndërrimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës bujqësore janë problemet kryesore që ndërlidhen me menaxhimin e tokës dhe shfrytëzimin e saj,
- Sistemi i menaxhimit të mbeturinave nuk është i zhvilluar ende në gjithë territorin e komunës për faktin se 69% të ekonomive familjare janë pjesë e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave, sikurse ende ka numër të madh të deponive ilegale.
- Territori i Komunës së Glogocit (Drenasit) ka faunë, florë dhe vegetacion relativisht të mirë mirëpo këto resurse natyrore së bashku me pyjet janë duke u degraduar si pasojë e veprimtari negative të faktorit antropogjen, e sidomos nga prerjet ilegale dhe gjuetia ilegale. Në territorin e komunës aktualisht janë 13 zona të mbrojtura pjesa më e madhe e tyre monumente të natyrës. Komuna nuk ka ndonjë plan konkret për menaxhimin e këtyre monumenteve sikurse nuk ka as plan për mbrojtjen e biodiversitetit.
- Ndërtimet e paplanifikuara, deponitë industriale, deponitë ilegale të mbeturinave dhe erozioni është i shprehur në disa zona si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të zhavorrit dhe shpyllëzimit janë disa nga format kryesore të ndotjes dhe degradimit të tokës.

Problemet kryesore mjedisore janë përmbledhur në tabelën 20.

**Tabela 20:** Problemet kryesore mjedisore në komunën e Glogocit (Drenasit)

Nr.	Përshkrimi
1.	Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore
2.	Menaxhim jo i duhur i ujërave të zeza dhe mungesa e trajtimit të tyre
3.	Degradimi i pyjeve dhe prerjet ilegale në rritje
4.	Cilësia jo e mirë e ajrit në zonat urbane dhe mungese e inventarit të ndotësve të ajrit
5.	Cilësi dhe sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe ujit të pijes
6.	Menaxhim jo efikas i mbeturinave, përfshirje jo e plote e ekonomive familjare në sistemin të grumbullimit të mbeturinave dhe numri i madh i deponive ilegale.
7.	Humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore nga zgjerimi i vendbanimeve dhe zonave industriale si dhe toka të degraduara që zvogëlojnë vlerën e peizazhit rural
8.	Mbrojtje jo e mjaftueshme e biodiversitetit dhe e peizazhit natyror, mungese e organeve menaxhuese për zona të mbrojtura dhe e planeve lokale për mbrojtjen e biodiversitetit.
9.	Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal.
10.	Ndërtimi i çrregullt dhe mungesë e planifikimit në zonat rurale
11.	Qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit është ende e kufizuar për shumë fshatra
12.	Mbrojtja e pamjaftueshme e trashëgimisë kulturore
13.	Mungese e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të ekoturizmit.
14.	Kapacitete të pamjaftueshme të objekteve të banimit
15.	Mungesë e vetëdijes mjedisore dhe pjesëmarrje e ulët në vendimmarrjen mjedisore

Krahas problemeve mjedisore janë identifikuar edhe mundësi kyçe mjedisore dhe socio ekonomike që mundë të shfrytëzohen për zhvillim. Mundësitë kyçe mjedisore dhe socio ekonomike janë prezantuar në tabelën 21.

**Tabela 21:** Mundësitë kyçe mjedisore dhe socio-ekonomike

Nr.	Përshkrimi
1.	Ekziston një sipërfaqe e madhe e tokës bujqësore me cilësi të mirë që mundë të shfrytëzohet si resurs për zhvillim e sidomos për zhvillimin e bujqësisë organike.
2.	Sistemi i kanalizimit Ibër Lepenc është potencial i mirë që mundë të shfrytëzohet për ujitje.
3.	Ka popullsi të re dhe fuqi punëtore e gatshme për tregun e punës.
4.	Ka shumë vende të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që janë resurse potenciale për zhvillimin e turizmit kulturor dhe turizmit natyror.
5.	Ka peizazhe rurale dhe natyrore që mundë të shfrytëzohen për turizëm, rekreacion dhe zhvillim.
6.	Pyjet ende mbulojnë një pjesë të madhe të territorit, duke ofruar mundësi banimi për speciet si dhe lidhje më fusha të rëndësishme të biodiversitetit.
7.	Komuna e Glogocit (Drenasit) ka pozitë të mirë gjeografike dhe rrjet të mirë transporti.
8.	Ka bazë të mirë ligjore për zbatimin e parandalimit të ndikimit në mjedis nga zhvillimet e reja si dhe për zbatimin e parimit ndotësi pagan.
9.	Në territorin e komunës janë të identifikuar disa lokacione që kanë potencial për prodhimin e energjisë së erës.
10.	Infrastrukturë e mirë në dispozicion për zhvillimin e bizneseve
11.	Institucione përkatëse komunale për mjedis dhe mbeturina për zbatimin e politikave lokale.
12.	Mundësi të mira për zbatimin e efikasitetit të energjisë dhe ngritjen e sistemit të ngrohjes me bashkëprodhim.

Duke marrë për bazë, gjendjen, problemet mjedisore, mundësitë kyçe si dhe objektivat nacionale në sektorin e mjedisit janë përcaktuar edhe objektivat mjedisore për komunën e Glogocit (Drenasit). Lista e objektivave mjedisore është prezantuar në tabelën 22.

**Tabela 22 : Objektivat e VSM-së për komunën e Glogocit (Drenasit)**

Nr.	Përshkrimi
1.	Zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit;
2.	Rimëkëmbje dhe mbrojtje e pyjeve nga degradimi;
3.	Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës;
4.	Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe rritja e kapaciteteve të ujit të pijshëm përmes rritjes së kapaciteteve akumuluese dhe qasjes në rrjetin e ujësjellësit;
5.	Rritja e qasjes në shërbimin e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale;
6.	Zvogëlimi i humbjes së dheut cilësor dhe parandalimi i erozioni;
7.	Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi dhe përmirësimi i tokës së degraduar;
8.	Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte (deponitë ilegale të mbeturinave urbane, ujërave të zeza, plehrat kimike, etj);
9.	Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja (integrimi i VSM-së dhe VNM-së, në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve në nivelin lokal);
10.	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave)
11.	Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu (zjarret, vërshimet, tërmetet, aksidenteve industriale, rreziqet e trafikut)
12.	Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
13.	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave dhe sigurimi i objekteve të mjaftueshme të banimit.
14.	Përmirësimi i shërbimeve urbane (mirëmbajtja e parqeve urbane dhe sipërfaqeve të gjelbra, kujdesi shëndetësor, objektet arsimore, objektet sportive dhe kulturore)
15.	Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore



4. Përmbledhje e përmbajtjes, sfidave zhvillimore dhe prioritetëve strategjike të PZHK-së

Plani zhvillimor komunal (PZHK) për komunën e Glogocit (Drenasit) u përgatit në pajtim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

Sipas kornizës aktuale ligjore, komunat (si njësi themelore territoriale të pushtetit lokal) janë përgjegjëse që të ndërmarrin aktivitete për planifikimin urban dhe rural brenda territorit të tyre, d.m.th. të përgatisin plane zhvillimore (komunale dhe urbane) si dhe plane rregulluese urbane⁴¹.

Në bazë të kornizës së procesit për hartimin e PZHK-së ekzistojnë 4 faza, si në vijim:

- I. Profili i komunës;
- II. Vizioni, qëllimet dhe objektivat strategjike;
- III. Konceptet e zhvillimit hapësinor; dhe
- IV. Strategjitë e zbatimit.

Dokumenti i PZHK-së, për komunën e Glogocit (Drenasit) përbëhet nga 6 kapituj kryesorë:

- ✓ **Hyrja** ofron informata për procesin e hartimit të PZHK-së, bazën ligjore, kornizën strategjike, udhëzimet, vendimet dhe dokumentet paraprake që ndërlidhen hartimin e PZHK-së.
- ✓ Kapitulli i **Profilit** ofron informata për historinë e zhvillimit, gjendjen ekzistuese në komunë duke përfshirë informatat e përgjithshme, demografinë, ekonominë, sektorët tjerë zhvillimorë, infrastrukturën, vendbanimet, banimin, gjendjen e mjedisit, kushtet klimatike, tashëgiminë kulturore si dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës për zbatimin e PZHK-së, duke përfshirë buxhetin, të hyrat, shpenzimet dhe investimet kapitale si dhe përparësitë, dobësitë, sidat dhe nevojat për të ardhmen.
- ✓ Kapitulli **Korniza e zhvillimit hapësinorë**, përmban të dhënat për vizionin, qëllimin, objektivat, prioritetet strategjike, skenarët e propozuar hapësinorë, konceptet e zhvillimit hapësinorë sipas sektorëve dhe fushave tematike, vlerësimin e ndikimeve socio-ekonomike dhe mjedisore nga korniza e propozuar zhvillimore dhe politikat.
- ✓ Kapitulli i **Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Plani i Veprimit**, përmban analizën e çështjeve, nevojave dhe planeve, pastaj prioritetet e zhvillimit strategjik dhe planin e veprimit për zbatimin e aktiviteteve që dalin nga prioritetet e zhvillimit strategjik.
- ✓ Kapitulli i pestë është i fokusuar në **Monitorimin dhe Zbatimin e PZHK-së** dhe përfshinë dispozitat për zbatim, kornizën për zbatim, kushtet, masat dhe monitorimin e zbatimit të PZHK-së.

Analiza e Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve (SWOT analiza) për PZHK si dhe sfidat dhe nevojat për të ardhmen janë prezantuar në tabelën 23.

⁴¹ Neni 10 i Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14.

**Tabela 23:** Analiza e sfidave zhvillimore dhe nevojave për të ardhmen sipas PZHK-së së Komunës së Glogocit (Drenasit)⁴²

Demografia	
Sfidat kyçe - Menaxhimi i migrimit të banoreve jashtë komunës - Vazhdimi i trendit të rritjes së popullsisë	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen - Krijimi i kushteve të favorshme për sistemimin adekuat të familjeve të reja - Integrimi i të rinjve në zhvillimet në komunë
Ekonomia	
Sfidat kyçe: - Krijimi i kushteve për zbutjen e papunësisë dhe zhdukjen e varfërisë - Rritja e numrit të NVM prodhuese - Stimulimi i prodhimit bujqësor dhe të blegtorisë - Krijimi i kushteve për zhvillimin e agro-industrisë - Krijimi i kushteve për shfrytëzimin e resurseve minerale	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen - Mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore - Zhvillimi dhe konsolidimi i NVM - Shfrytëzimi i mundësive nga resurset minerale - Mbështetja e fermerëve në ngritjen e serave dhe kapaciteteve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore - Diversifikimi i prodhimtarisë dhe sigurimi i tregjeve, lidhja me industritë përpunuese
Infrastruktura teknike	
Sfidat kyçe <u>Ujësjellës</u> - Mbulimi i 100% të vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit. - Ofrimi i shërbimit të ujësjellësit 24 orë gjatë ditës, pa reduktime. - Trajtimi i ujërave të zeza dhe kanalizimit atmosferik në tërë territorin e komunës. <u>Ujitja</u> - Hulumtimi mundësive për shfrytëzimin e ujit të shiut për ujitje. - Përmirësimi i menaxhimit të ujësjellësit, duke përfshirë futjen e menaxhimit të rrjetave nën ombrellën e kompanisë.	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen <u>Ujësjellës</u> - Kyçja e vendbanimeve Abri e Epërme, Fushtica e Epërme, Fushtica e Poshtme, Gradica, Negroci, Nekovci dhe Terdec në sistem të ujësjellësit dhe furnizimi me 24 orë ujë të pijshëm. - Ndarja nga fabrika e Çikatovës së Vjetër që është e dizajnuar dhe ndërtuar për të furnizuar me ujë industrial dhe ndërtimi i një burimi tjetër për furnizim me ujë të pijshëm. - Furnizimi i tërë komunës me 24 orë të pijshëm në përputhje me standardet për ujë të pijes. - Përtëritja e sistemit të vjetër dhe zëvendësimi me gypa të ri në mënyrë që të evitohen humbjet e ujit të pijshëm. <u>Ujitja</u> - Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ujit të reshurave atmosferike për ujitje. - Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe atyre atmosferik.

⁴² Draft dokumenti: Revidimi i Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Glogocit (Drenasit)



Energjia • Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike. • Shtrirja e rrjetit elektrik mbitokësor, i cili edhe ashtu është i vjetruar në masë të madhe. • Shtrirja e ndriçimit publik në tërë territorin. • Shfrytëzimi i burimeve të energjisë të ripërtitshme për prodhim të energjisë elektrike dhe ko-gjenerimit për ngrohje. Telekomunikacioni • Ngritja e cilësisë së telekomunikacionit • Promovimi i qyteteve të mençura ('smart city'). Mbeturinat • Përfshirja e të gjitha ekonomive familjare në sistemin të Menaxhimit të mbeturinave. • Eliminimi i deponive ilegale. • Përmirësimi i ofrimit të shërbimit dhe inkasimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Ngrohja • Mungesa e sistemit ngrohjes qendrore • Hulumtimi i mundësive për ndërtimin e sistemit të ngrohjes të bazuar në energjinë që lirohet nga Feronikeli apo nga burimet e ripërtitshme.	Energjia • Përtëritja e rrjetit të vjetruara energjisë së dhe shtrirja e atij nëntokësor. • Vendosija e ndriçimit publik në vende ku mungojnë. • Vendosija e paneleve solare për shfrytëzim të energjisë së ripërtitshme. Telekomunikacioni • Digjitalizimi i informative dhe mundësia e përdorimit të tyre nga ana e qytetarëve me anë të teknologjisë. Mbeturinat • Përmirësimi i kushteve të punës në stacion, • Të verifikohet përbërja e mbeturinave, • Transferimi i mbeturinave të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, • Të eliminohen ujërat e grumbulluara, • Të bëhet dezinfektimi i hapësirave etj. Ngrohja • Përdorimi i gypave ekzistues të Feronikelit për funksionalizimin e ngrohjes qendrore në Glogoc dhe jo vetëm por edhe në tërë territorin e saj.
Transporti	
Sfidat kyçe • Përfshirja e të gjitha vendbanimeve me transport publik dhe zgjatja e kohës së operimit. • Përmirësimi i lëvizshmërisë motorike dhe mundësimi i lëvizshmërisë jo-motorike (shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta, nënkallimet). • Përmirësimi i cilësisë së punimeve në infrastrukturë të transportit dhe përcjellja e punimeve me infrastrukturë ndihmëse teknike. • Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor dhe zvogëlimi i ndikimeve	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen • Ngritja e sigurisë së këmbësorëve përmes ofrimit të shtigjeve për ecje. • Ofrimi i shtigjeve për çiklistë. • Zgjerimi i rreth-rrrotullimit në hyrje të Glogocit (Drenasit). • Shtimi i sinjalizimit horizontal, vertikal dhe semaforët në kryqëzimet e rrugëve, sidomos tek kryqëzimet me hekurudhë. • Parashikimi i brezit të gjelbër tek rrugët dhe parkingjet për mbrojtjen e këmbësorëve nga zhurma dhe nga trafiku.



negative që shkaktohen nga transportimi i ngarkesave të Ferronikelit (bartja e oksigjenit të lëngshëm, dëmtimi i rrugëve, tollovia, zhurma).	Ofrimi i linjave të mjaftueshme të transportit urban pas orës 19:00 dhe gjatë pushimit veror të nxënësve.
Shëndetësia dhe Mirëqenia sociale	
Sfidat Shëndetësia - Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore - Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e shëndetësisë Mirëqenia Sociale - Sigurimi mirëqenies për të gjitha grupet e marginalizuara. - Ofrimi i banimit dhe ulja pabarazisë ekonomike. Arsimi - Ofrimi i arsimit adekuat për nxënës me nevoja të veçanta dhe ngritja e nivelit të arsimit në të gjitha shkollat. - Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e arsimit. - Shtimi i aktivitetit fizik tek fëmijët. Administrata Publike - Përmirësimi, perfeksionimi i shërbimeve në Glogoc dhe rritja e numrit të stafit. - Mungesa e shërbimeve të zjarrfikësve në fshatrat më larg qendrës. Kultura - Fuqizimi i kulturës përmes ofrimit të objekteve të kulturës.	Kërkesat dhe nevojat për të ardhmen Shëndetësia - Rindërtimi i QKMF në të ardhmen. - Definimi i parkingjeve në objektet shëndetësore. - Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Mirëqenia sociale - Ndërtimi i shtëpisë së pleqve dhe strehimores - Ofrimi i qëndrimeve ditore për pleq në kuadër të QMF në bashkësitë lokale. - Ndërtimi i Qendrës për punë dhe mirëqenie sociale në të cilën do të mund të funksiononte edhe Handikos (për persona me nevoja të veçanta); - Banimi social i integruar. Arsimi - Ndërtimi i shkollave të reja në disa lokacione për arsye të mbingarkimit të objekteve ekzistuese. - Sigurimi i inventarit dhe pajisjeve të teknologjisë informative (kabinete dhe laboratorë përkatëse). - Ofrimi i qasjes së duhur për nxënës me nevoja të veçanta. Administrata publike - Sigurimi i hapësirave/kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale. - Funksionalizmi i 2 objekteve të administratës publike për shërbim civil. - Mbulimi i tërë territorit me shërbim të zjarrfikësve. Kultura - Ndërtimi i bibliotekave dhe qendrës shumë-funksionale (kinemanë, sallën koncertale, teatrin, muzeun, ofrimin e shërbimit të trajnimeve). - Ndërtimi i qendrës sportive shumë-funksionale (pishinë, palestër etj.)



Rinia, Sporti dhe Rekreacioni - Fuqizimi i Sportit dhe Rekreacionit përmes ofrimit të objekteve dhe hapësirave adekuate - Përkrahja e rinisë përmes ofrimit të hapësirave adekuate për zhvillim dhe avancim Hapësira publike dhe hapësira të gjelbra - Krijimi hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra të qëndrueshme (duke përfshirë shtigjet për këmbësorë, vrapim, çiklist) dhe i hapësirave të rekreacionit në viset rurale - Ofrimi i qasjes për PAK tek të gjitha objektet e rekreacionit Objektet e religjionit dhe varrezat - Shfrytëzimi efikas i tokës publike në varreza	- Përmirësimi i qasjes PAK tek të gjitha objektet e kulturës Objektet e rinisë, sportit dhe rekreacionit - Ndërtimi i Pishinës - Shtigjet për vrapim-gara - Shtigjet për çiklistë - Objekti sportiv shumë-funksional. Hapësira publike dhe hapësira të gjelbra - Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese e sidomos në vendet e ekspozuara ndotjes (nëse është e mundur në ndonjë hapësirë në qytet) - Të shqyrtohet mundësia që lokacioni tek pishat në Gllbar të shndërrohet park komunal (duke rregulluar shtigjet brenda pishave, ndriçimin, ulëset, etj.) Objektet e religjionit dhe varrezat - Në fshatra ku varrezat janë të ndara duhet të parashihet bashkimi i tyre me qëllim të mbrojtjes së tokës publike dhe distanca prej vendbanimeve nuk duhet të jetë më e madhe se 15km (sipas Normave Teknike) - Të parashihen objekte përcjellëse të kultit ku mund të ofrohen shërbime të varrimit
Mjedisi	
Sfidat - Zvogëlimi i ndikimeve mjedisore nga industria e rëndë (Feronikeli-ajri, uji dhe toka) - Zvogëlimi i ndikimeve mjedisore nga ndotja e ujërave dhe sigurimi i një mjedisi më të pastër - Zvogëlimi i ndikimit nga vërshimet dhe ofrimi i një mjedisi më të sigurt - Ruajtja e tokës nga degradimi përmes kontrollimi i ndërtimeve pa leje, deponive ilegale dhe eksploatimit legal dhe ilegal (gurëthyesve)	Kërkesat dhe nevojat për të ardhmen Në të ardhmen duhet të konsiderohen këto veprime: - Aprovimi i Planit të veprimit lokal në mjedis dhe implementimi i veprimeve që rrjedhin nga ky plan - Hartimi i Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis për projekte kapitale si dhe Vlerësimit Strategjik të Mjedisit - Matja e vazhdueshme e përqendrimit SO₂, CO, NO₂, O₃ dhe përqendrimit të pluhurit - Trajtimi i ujërave të zeza përmes ndërtimit të impiantit - Ndërtimi i akumulimit të ujit – Lumi Drenica - Kontrollimi i humbjes së tokës përmes hartimit të planeve - Kontrollimi dhe mbyllja e deponive ilegale, ndalimi i eksploatimit të drurit dhe zhavorit (përmytjet), - Kontrollimi i sasisë së përdorimit i plehrave dhe i pesticideve për qëllime bujqësore



	• Krijimi i tampon zonave me gjelbërim rreth hapësirave të ekspozuara në zhurmë • Shtimi i hapësirave gjelbra afër gurthyesve, hapësirave me ndotje të lartë të ajrit
	Kërkesat për të ardhmen dhe Masat Preventive Për Mbrotjtjen nga fatkeqësitë natyrore Duke pasur parasysh faktin që nga fatkeqësitë natyrore që godasin Komunën e Glogocit (Drenasit) më të shpeshta janë vërshimet, zjarret dhe skorja nga Feronikeli duhet konsideruar çështjet si në vijim: • Integrimi i politikave në plane zhvillimore dhe hartimi i strategjive për zvogëlim të rrezikut nga FNFT • Studim fizibiliteti për shtratin e lumit Nekoc-Dobroshevc • Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim të fatkeqësive natyrore • Përmirësimi i bashkëpunimit mes nivelit qendror dhe lokal për menaxhim më të mirë të situatave nga fatkeqësitë natyrore.
Trashëgimia kulturore dhe turizmi	
Sfidat • Promovimi e vlerave të TK në funksion të turizmit vendor dhe zhvillimit ekonomik si dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e aseteve të Trashëgimisë Kulturore • Ofrimi i infrastrukturës përcjellëse (ulëse, shtigje, ndriçim etj) për lokalitetet me potencial turistik (mali i Kosmaçit, kodra e pishave të Kamenicës dhe ne Komoran, liqeni i Vasilevës) dhe i qasjes adekuate në monumente të natyrës (qasja deri tek shpellat)	Kërkesat për të ardhmen • Të pengohen dukuritë negative që rrezikojnë trashëgiminë kulturore, implementime ligjet në fuqi dhe të aplikohen standardet evropiane, • Komuna e Glogocit (Drenasit) bashkë me QRTK duhet të dizajnojnë politika për mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe integrimin e saj në strategji për zhvillim turizmit, • të përcaktohet kufiri dhe perimetri tek lokalitetet arkeologjike, të hartohen planet menaxhuese për asete të rëndësishme, • vetëdijesimi i qytetarëve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, • të definohet roli i trashëgimisë në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik dhe të pasurohet lista e monumenteve për mbrojtje të përkohshme (përfshirja e objektit shtëpi-shkollë 1930-1939). • të ndërtohet dialogu ndër institucional e posaçërisht në mes të institucioneve lokale dhe atyre qendrore, menaxhim efikas i resurseve,



	- përcaktimi i perimetrit mbrojtës rreth shpellave dhe vlera tjera që deri më tani nuk e kanë të përcaktuar, - krijimi i bazës të dhënave që do të lehtësonte menaxhimin e potencialit ekzistues të florës, faunës dhe resurseve tjera të zonës.
Vendbanimet	
Sfidat	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen
- Kontrolli i mangët i ndërtimeve në fshatra - Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve dhe dendësimit adekuat - Rregullimi i VJF - Menaxhimi i migrimit rural-urban	- Trajtimi i zonave në komasacion. - Te definohet hapësirat e zhvillimit në zona urbane dhe fshatra. - Legalizimi në baze të ligjit të ri. - Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime. - Trajtimi i depopullimit.
Banimi	
Sfidat kyçe	Nevojat dhe kërkesat për të ardhmen
- Kontrolli i mangët i ndërtimeve të shtëpive në fshatra - Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve dhe dendësimit adekuat	- Hartimi i strategjisë së banimit (jo vetëm atij social) - Rritja e dendësisë së banimit në zonën urbane për të akomoduar kërkesat për banim - Rregullimi dhe trajtimi sipas ligjit të legalizimit i shtëpive të banimit që janë ndërtuar pa leje në tokë të parcelizuar të klasit të I-IV pa infrastrukturë të ujësjellësit dhe kanalizimit, për shkak të kushteve sanitare. - Shfrytëzimi i një pjese të fondit të banimit të braktisur për akomodim të rasteve sociale me një qira të përballueshme deri në zgjidhje më afatgjate - Shfrytëzimi i banimit të braktisur (dhe atyre në shfrytëzim) për akomodim të turizmit malor. - Ofrimi i ngrohjes qendrore për banim përmes ko-gjenerimit me Feronikelin apo KEK-un - Rritja e efijencës së energjisë në ndërtesat ekzistuese të banimit si dhe stimulimi i aplikimit të masave eficientë në ndërtesat e reja përmes ofrimit të lehtësirave gjatë pajisjes me leje ndërtimore apo pagesës së tatimit

Lista e prioritete strategjike të Planit Zhvillimorë Komunal për komunën e Glogocit (Drenasit), sipas sektorëve zhvillimorë është prezantuar në tabelën 24.

Tabela 24: Objektivat (Prioritetet) strategjike të PZHK-së, sipas sektorëve zhvillimorë⁴³

Sektori zhvillimor	Qëllimi (Prioriteti strategjik)	Objektivi strategjik
1. Zhvillimi ekonomik	Qëllimi 1.1: Nxitja e zhvillimit të bujqësisë	Objektiva 1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore Objektiva 2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë. Objektiva 3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite. Objektiva 4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite.
	Qëllimi 1.2: Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)	Objektiva 1. Rritja e bizneseve prodhuese për 8% në çdo vit.
	Qëllimi 1.3: Ngritja e kualitetit të veprimtarive shërbyese	Objektiva 1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelierisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese.
	Qëllimi 1.4: Nxitja e zhvillimit të turizmit rural	Objektiva 1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit. Objektiva 2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite).
2. Infrastruktura teknike Energjetika Ujësjellësi, Kanalizimi dhe Ujitja Mbeturinat Transporti	Qëllimi 2.1: Rritja e kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtritshme.	Objektiva 1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KË) nga përcuesit ajror në atë kabllorë, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme. Objektiva 2. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme deri në 5%, në 8 vitet e ardhshme. Objektiva 3. Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore.
	Qëllimi 2.2: Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit (fekal dhe atmosferik) si dhe ujitjes	Objektiva 1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme. Objektiva 2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Korroticë e Epërme dhe Vërbovc). Objektiva 3. Trajtimi i ujërave të zeza për 70% të territorit në 5 vitet e ardhshme.

⁴³ Draft dokumenti: Rishikimi i Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Glogocit (Drenasit)



		Objektiva 4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfiguracioni i terrenit e lejon. Objektiva 5. Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional.
	Qëllimi 2.3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës	Objektiva 1. Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme.
	Qëllimi 2.4: Sigurimi i transportit të integruar për komunën e Glogocit (Drenasit)	Objektiva 1. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit. Objektiva 2. Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit. Objektiva 3. Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikelit brenda 3 viteve.
3. Infrastruktura publike dhe sociale Arsimi Shëndetësia Kultura, Sporti, Hapësirat Publike dhe Hapësirat e Gjelbra	Qëllimi 3.1: Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë	Objektiva 1. i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025).
	Qëllimi 3.2: Ofrimi i shërbimeve cilësore të shëndetësisë me zhvillim të vazhdueshëm profesional	Objektiva 1. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022. Objektiva 2. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale.
	Qëllimi 3.3: Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra	Objektiva 1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale në 5 nën qendrat e komunës (deri në 2025). Objektiva 2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë. Objektiva 3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri në vitin 2030.
4. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezik	Qëllimi 4.1: Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë	Objektiva 1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021). Objektiva 2. Monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025.



	Qëllimi 4.2. Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv	Objektiva 1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022. Objektiva 2. Mbyllja dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021.
	Qëllimi 4.3.. Sigurimi i një mjedisi më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë	Objektiva 1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2025.
	Qëllimi 4.4: Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Objektiva 1. Konzervimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024. Objektiva 2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023.
5. Vendbanimet dhe Banimi	Qëllimi 5.1: Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës	Objektiva 1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit. Objektiva 2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje
	Qëllimi 5.2: Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime	Objektiva 1. Ofrimi i shërbimeve 6 dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022. Objektiva 2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve. Objektiva 3. Rregullimi i çështjeve pronësore.
	Qëllimi 5.3: Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues të banimit	Objektiva 1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar. Objektiva.2. Evidentimi dhe futja në shfrytëzim e 80% të kapaciteteve të pashfrytëzuara të banimit deri në 2025. Objektiva 3. Rritja e efijencës energjetike 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030.
	Qëllimi 5.4: Plotësimi i nevojave për banim	Objektiva 1. Sigurimi i banimit adekuat për 10% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022. Objektiva 2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri në vitin 2022.



5. Analiza e përputhshmërisë së objektivave/synimeve të PZHK-së kundrejt objektivave të VSM-së

Qëllimet kryesore të vlerësimit/analizës së përputhshmërisë së synimeve të PZHK, me objektivat e mjedisore të VSM-së, janë:

- ✓ Testimi nëse të gjitha objektivat e VSM-së po trajtohen sipas planit, d.m.th. nëse për secilin objektiv të VSM-së ka së paku një objektiv potencialisht në përputhje me objektivin e planit;
- ✓ Theksimi i mospërputhjeve dhe konflikteve potenciale, dhe rekomandimi i mënyrave për të zbatuar planin në mënyrë që të shmangen konfliktet e tilla;
- ✓ Theksimi i ndërveprimeve potenciale, dhe sugjerimi i mënyrave për t'i avancuar dhe shfrytëzuar ato në plan.

Synimet kanë një karakter të përgjithshëm, ashtu që ndikimet e tyre do të varen pothuaj tërësisht nga ajo se si ato në të vërtetë zbatohen gjatë fazave pasuese të planifikimit. Rrjedhimisht, në këtë fazë, komentet kryesisht synojnë theksimin e ndërveprimeve potenciale dhe konflikteve ndërmjet pikësynimeve dhe objektivave të VSM-së, dhe në rekomandimin e mënyrave për të përkufizuar (dhe më vonë zbatuar) synimet për përmirësimin e ndikimeve të tyre të përgjithshme në mjedis.

Testi është kryer përmes një matrice (“matrica e përputhshmërisë”), e cila vendosë synimet e planit në një bosht dhe objektivat e VSM-së në boshtin tjetër. Rubrikat janë plotësuar duke u përgjigjur në pyetjen: “A janë këto synime – siç përshkruhen në dokumentin e planifikimit – potencialisht në përputhje/potencialisht në konflikt me këtë objektiv të VSM-së.

Analiza e përputhshmërisë prioriteteve strategjike të PZHK-së, kundrejt objektivave të VSM-së sipas kësaj matrice është prezantuar në tabelën 25.



Tabela 25: Analiza e përputhshmërisë së prioriteteve strategjike të PZHK-së, kundrejt objektivave të VSM-së

Objektivat Mjedisore		Prioritetet Strategjike të PZHK-së, sipas sektorëve zhvillimorë																		
		Zhvillimi ekonomik				Infrastruktura teknike				Infrastruktura administrative dhe sociale			Mjedisi dhe sipërfaqet ne rrezik				Vendbanimi dhe banimi			
		1.1.	1.2	1.3	1.4	2.1	2.2	2.3	2.4	3.1.	3.2	3.3.	4.1.	4.2	4.3	4.4	5.1	5.2	5.3	5.4
01	Zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit;	-	-	0	+-	+-	0	+	+	+	0	-	+	++	0	++	+	0	0	-
02	Rimëkëmbje dhe mbrojtje e pyjeve nga degradimi;	-	-	0	+	0	0	0	+	+	0	-	+	++	0	+	+	0	0	-
03	Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës;	+-	--	+	0	++	0	+	+	+	0	-	++	++	0	+	+	0	+	-
04	Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe rritja e kapaciteteve të ujit të pijshëm përmes rritjes së kapaciteteve akumuluese dhe qasjes në rrjetin e ujësjellësit;	-	-	+	0	0	++	+	0	+	+	0	++	++	+	+	0	+	+	-
05	Rritja e qasjes në shërbimin e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale;	+-	0	+	0	0	++	0	0	0	+	0	0	+	+	+	+	+	+	+



Komuna e Glogocit (Drenasit), 2019
Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PZHK

06	Zvogëlimi i humbjes së dheut cilësor dhe parandalimi i erozioni;	++	+	0	0	0	0	+	-	0	0	-	+	+	+	+	+	0	0	-
07	Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi dhe përmirësimi i tokës së degraduar;	++	+-	0	0	0	0	+		0	0	-	0	++	+	+	++	0	0	-
08	Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte (deponitë ilegale të mbeturinave urbane, deponite industriale, ujërat e zeza, plehurat kimike, etj);	++	-	+	-	0	+	++	0	0	0	-	++	++	+	+	+	0	0	-
09	Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja (integrimi i VSM-së dhe VNM-së, në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve në nivelin lokal);	-	-	0	0	0	+	+	+	0	0	+	+	++	+	+	++	0	+	+
010	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave)	0	-	++	+	0	0	++	0	+	0	+	+	+	0	+	0	+	+	+
011	Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu (zjarret, vërshimet, tërmetet, aksidentet)	0	0	++	0	0	0	+	+	+	+	0	+	+	++	+	+	+	+	+



Komuna e Glogocit (Drenasit), 2019
Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PZHK

	industriale, rreziqet e trafikut)																			
012	Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	-	--	+	+	0	+	+	+	+	0	+	+	+	0	++	+	+	0	-
013	Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave dhe sigurimi i objekteve të mjaftueshme të banimit.	0	0	+	0	++	+	+	0	+	0	+	0	+	0	+	+	+	++	++
014	Përmirësimi i shërbimeve urbane (mirëmbajtja e parqeve urbane dhe sipërfaqeve të gjelbra, kujdesi shëndetësor, objektet arsimore, objektet sportive dhe kulturore)	0	0	++	+	0	++	++	+	+	+	+	0	+	+	++	+	++	++	+
015	Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore	0	0	+	+	+	+	+	+	++	+	++	+	++	+	++	+	+	+	0
Legjenda:																				
++	Ndikim potencial pozitiv (sinergji domethënëse)																			
+	Ndikim potencial pozitiv (sinergji e vogël, kryesisht indirekt)																			
--	Ndikim potencial negativ (mospërputhje domethënëse)																			
-	Ndikim potencial negativ (mospërputhje e vogël, kryesisht indirekte)																			
+-	Ndikim i padefinuar																			
0	Pa ndikim																			



Komente në lidhje me të gjeturat kryesore nga përputhshmëritë dhe konfliktet ndërmjet prioritetëve strategjike PZHK dhe objektivave të VSM-së janë si vijon:

Përputhshmëria më e madhe ose sinergji domethënëse në mes objektivave të VSM-së dhe prioritetëve Strategjike të PZHK-së, vërehet sidomos tek:

- ✓ O1 (Zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit) me Objektivat strategjike të PZHK-së 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv) dhe 4.4 (Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore) për faktin se krijimi i një mjedisit të pastër dhe atraktiv dhe mbrojtja e integruar e resurseve natyrore do të ndihmojë në arritjen e objektivit mjedisor për zgjerim të zonave të mbrojtura, mbrojtje të biodiversitetit dhe peizazhit.
- ✓ O2 (Rimëkëmbje dhe mbrojtje e pyjeve nga degradimi) me 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv), për faktin se krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv do të ndihmojë në arritjen e objektivit mjedisor për rimëkëmbjen dhe mbrojtjen e pyjeve.
- ✓ O3 (Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i ndotjes së ajrit, zhurmës, pluhurit dhe gazrave të serrës) me prioritetin e PZHK-së 2.1 (Rritja e kapaciteteve për furnizim të qëndrueshëm me energji duke përdorur edhe burimet e ripërtrishme), me 4.1 (Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë) dhe me 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv) për faktin se me rritjen e kapaciteteve të energjisë nga burimet e do të zvogëlohet përdorimin e burimeve fosile për prodhim të energjisë, që do të ndikojë direkt edhe në uljen e emisioneve ndotëse në ajër dhe zvogëlimin e emetimeve të gazrave serrë, pastaj përmes zvogëlimit të ndikimit në mjedis nga industria e rëndë do të zvogëlohet zhurma edhe sasia e emisioneve ndotëse në ajër nga kjo industri dhe gjithashtu përmes krijimit të një mjedisi të pastër do të kontribuohet edhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zhurmës, pluhurit dhe gazrave serrë.
- ✓ O4 (Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe rritja e kapaciteteve të ujit të pijshëm përmes rritjes së kapaciteteve akumuluese dhe qasjes në rrjetin e ujësjellësit) me prioritetin e PZHK-së 2.2 (Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes) për faktin se ??? dhe me 4.1 (Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë) dhe 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv)
- ✓ O5 (Rritja e qasjes në shërbimin e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale) me prioritetin e PZHK-së 2.2 (Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes) për faktin se me zhvillimin e infrastrukturës për kanalizim dhe për trajtimin e ujërave do të zvogëlohet sasia e ujërave të ndotura dhe do të përmirësohet shërbimi i sanitacionit për qytetarët.
- ✓ O6 (Zvogëlimi i humbjes së dheut cilësor dhe parandalimi i erozionit) me prioritetin e PZHK-së 1.1. (Nxitja e zhvillimit të bujqësisë) për faktin se me nxitjen e zhvillimit të bujqësisë do të ruhen tokat bujqësore, do të ruhet cilësia e tokës dhe to të zvogëlohen mundësitë e shndërrimit të këtyre tokave në zona të urbanizuara apo në zona tjera që do të ndikonin në ndotjen e dheut. Po ashtu mbjellja e tokave me kultura të ndryshme do të do të zvogëlojë humbjen e dheut cilësor dhe do të parandalojë erozionin.
- ✓ O7 (Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi dhe përmirësimi i tokës së degraduar) me prioritetin e PZHK-së 1.1. (Nxitja e zhvillimit të bujqësisë) Mbrojtja e tokës së



vlefshme bujqësore), me 4.2. (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv) dhe me 5.1 (Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës) për faktin se duke e nxitur zhvillimin e bujqësisë do të ndihmohet në mbrojtën tokës së vlefshme bujqësore me cilësi të lartë, pastaj duke krijuar një mjedis të pastër dhe atraktiv do të mbrohet edhe cilësia e tokës dhe do të përmirësohet toka e degraduar, ndërsa që përmes kontrollit të ndërtimeve do të mbrohet toka bujqësore nga ndërtimi.

- ✓ 08 (Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte) me 1.1 (Nxitja e zhvillimit të bujqësisë, 2.2 (Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes), 4.1 (Zvogëlimi i ndikimit në mjedis nga industria e rëndë) dhe 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv), për faktin se të gjitha këto veprime strategjike në mënyrë direkte apo indirekte do të ndihmonin në uljen e kontaminimit të tokës nga burimet e drejtpërdrejta sikurse janë industria, deponitë e mbeturinave, shkarkimet e ujërave urbane dhe format e tjera të shkarkimeve në mjedisin tokësorë.
- ✓ 09 (Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja / integrimi i VSM-së dhe VNM-së, në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve në nivelin lokal) me 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv) dhe 5.1 (Kontrolli i ndërtimeve në të gjitha vendbanimet e komunës), për faktin se duke krijuar një mjedis të pastër dhe atraktiv dhe duke kontrolluar ndërtimet në mënyrë direkte do të ndihmohet në zbatimin e kërkesave që dalin nga VNM dhe VSM dhe do të parandaloheshin efektet negative në mjedis nga zhvillimet e reja.
- ✓ 010 (Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave/grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave) me prioritetin e PZHK-së 1.3 (Ngritja e kualitetit të veprimtarive shërbyese) dhe 3.3 (Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra) për faktin se me ngritjen e kualiteteve të veprimtarive shërbyese do të përmirësohet edhe shërbimi për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në komunë si dhe do të parandalohet krijimi i deponive të reja ilegale të mbeturinave. Po ashtu përmes rritjes së hapësirave të gjelbra publike do të rritet edhe sipërfaqja e mirëmbajtur e gjelbër në zona urbane.
- ✓ 011 (Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu) me prioritetin e PZHK-së, 1.3 (Ngritja e kualitetit të veprimtarive shërbyese) dhe 4.3 (Sigurimi i një mjedisi më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë), për faktin se ngritjen e kualitetit të veprimtarive shërbyese do të rritet edhe kualiteti i shërbimeve që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu, duke ulur rrezikun nga këto fatkeqësi dhe gjithashtu duke krijuar një mjedis më të sigurt nga ndikimet nga fatkeqësitë do të zvogëlohet rreziku nga fatkeqësitë natyrore.
- ✓ 013 (Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave dhe sigurimi i objekteve të mjaftueshme të banimit me prioritetin e PZHK-së, 2.2 (Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes), me prioritetin e PZHK-së 5.2 (Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime) dhe me prioritetin 5.4 (Plotësimi i nevojave për banim nga fatkeqësitë natyrore, familjet e dëshmorëve dhe tjera) për faktin se krijimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit do të përmirësohen kushtet në objektet e banimit, pastaj duke përmirësuar shërbimet në nën qendra do të përmirësohen edhe shërbimet për objektet e banimit si dhe duke plotësuar nevojat për banim në rastet e fatkeqësive natyrore do të rritet edhe numri i objekteve në dispozicion në raste të këtyre fatkeqësive.



- ✓ 014 (Përmirësimi i shërbimeve urbane) me prioritet e PZHK 1.3 (Ngritja e kualitetit të veprimtarive shërbyese), 2.2 (Zhvillimi i infrastrukturës së ujësjellësit, kanalizimit dhe ujitjes), 2.3 (Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës), 5.2 (Fuqizimi i nën-qendrave me shërbime) dhe 5.3 (Përmirësimi i menaxhimit dhe cilësisë së fondit ekzistues të banimit) për faktin se më përmirësimin e këtyre çështjeve do të përmirësohen dhe fuqizohen edhe shërbimet urbane qofshin ato shërbyese apo shërbimet tjera që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e banesave kolektive dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës urbane.
- ✓ 015 (Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore) me prioritet e PZHK 3.1 (Sigurimi i arsimit cilësor të përshtatshëm për të gjithë), 3.3 (Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra), 4.2 (Krijimi i një mjedisi të pastër dhe atraktiv), 4.4 (Krijimi i qasjes së integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore) për faktin se duke rritur cilësinë e arsimit rritet edhe niveli i vetëdijesimit për mjedisin, duke ngritur infrastrukturë të mjaftueshme publike të gjelbër dhe duke krijuar mjedis të pastër do të ndikohet indirekt në vetëdijesimin e popullatës për mirëmbajtjen e tyre dhe përfshirjes së tyre në procesin e vendimmarrjes për përzgjedhjen dhe identifikimin e këtyre hapësirave, si dhe duke përdor qasje të integruar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore do të rritet edhe vetëdija për të mbrojtur këto vlera por edhe do të nxitet pjesëmarrja në vendimmarrje e grupeve të ndryshme shoqërore.

Janë konstatuar edhe përputhje tjera, por që nuk kanë ndonjë domethënie shumë të rëndësishme. Në disa raste janë konstatuar edhe ndikime neutrale apo të padefinuara mirë.

Ndërsa që konfliktet ose ndikimet më të mëdha negative janë konstatuar në mes të:

- ✓ Prioritetit të PZHK-së, 1.2 (Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese/NVM)) me Objektivin e O3 (Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i ndotjes së ajrit, zhurmës, pluhurit dhe gazrave të serrës) për faktin se shumica e bizneseve prodhuese gjatë operimeve të tyre do të përdorin lëndë djegëse që do të ndikojë në rritjen e emisioneve ndotëse në ajër, rritjen e nivelit të zhurmës, pluhurit dhe gazave serë.
- ✓ Edhe prioriteti i PZHK-së, 1.2. (Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)) nuk është në përputhje me 012 të VSM-së (Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore), për faktin se shumica e bizneseve të reja do të manifestohen me ndërtimin e infrastrukturës shtesë që do të ndikojë ndërtimet çfarëdo qofshin ato mundë të ndikojnë dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe promovimin e saj pastaj edhe humbje të biodiversiteti dhe peizazheve, degradim të pyjeve, krijimin e mbeturinave që do të ndikonte negativisht në mundësinë e promovimit të trashëgimisë kulturore.

Ndikime mjedisore dhe mospërputhje e plotë me objektivat e VSM të shkallës me të vogël pritet të ketë edhe tek Prioritet Strategjike që ndërlidhen me ndërtimin e infrastrukturës së banimit, infrastrukturës rrugore apo infrastrukturës tjetër përcjellëse për faktin se përmirësimi i rrjetit rrugor dhe hekurudhore me infrastrukture përcjellëse si dhe infrastruktura tjetër mund të



shkaktojnë humbje të biodiversiteti dhe peizazheve, degradim të pyjeve, rritje të ndotjes së ajrit, zhurmës pluhurit dhe gazave sere si dhe degradim të tokës bujqësore sidomos asaj me cilësi të lartë. Konflikte të tilla janë konstatuar në mes të:

- ✓ Objektivate të VSM 01, 02, 03 dhe 04 me prioritetet strategjike të PZHK-së 1.1 (Nxitja e zhvillimit të bujqësisë), 1.2 (Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese - NVM), 3.3 (Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra) dhe 5.4 (Plotësimi i nevojave për banim nga fatkeqësitë natyrore, familjet e dëshmorëve dhe tjera).
- ✓ Objektivate të VSM 08, 09 dhe 012 me prioritetet strategjike të PZHK-së 1.1 (Nxitja e zhvillimit të bujqësisë), 1.2 (Nxitja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese/NVM), 3.3 (Ngritja e infrastrukturës për objektet e kulturës, sportit, dhe rritja e hapësirave publike dhe të gjelbra) dhe 5.4 (Plotësimi i nevojave për banim nga fatkeqësitë natyrore, familjet e dëshmorëve dhe tjera).

Për ti zbutur këto ndikime negative rekomandohet që:

- ✓ Të reduktohet ndërtimet dhe investimet në infrastrukturë me qëllim të shmangies së një zgjerimi të tej-zgjatur që nuk është i arsyeshëm sa i përket kostos që përfshihet për rregullimin e infrastrukturës komunale për t'ju shërbyer një numri të kufizuar të shtëpive / ndërtesave përgjatë rrugës lokale.
- ✓ Të gjitha këto projekte të nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e efekteve negative në mjedis,
- ✓ Duhet të bëhen vlerësime të ndikimit në mjedis për korridoret e reja të transportit dhe të bizneseve prodhuese në pajtim me direktivën e vlerësimit të ndikimit të mjedisit dhe anekseve të saj;
- ✓ Aktivitetet që ndërlidhen me biznese prodhuese të orientohen në Parkun ekzistues të biznesit apo në qendrën Tregtare në Glogovc, apo në rastet tjera kur është e mundur të përdoret infrastruktura e ndërtimeve ekzistuese duke bërë renovimin e tyre;
- ✓ Të bëhet klasifikimi dhe hartografimi i tokave me cilësi të lartë dhe të përcaktohen kriteret për mbrojtjen e tyre,
- ✓ Të ruhen korridoret e rrjetit ekologjik dhe zonat me biodiversitet të lartë.



6. Evolucionit (zhvillimi) prej gjendjes aktuale mjedisore pa një plan

Ligji për VSM-së kërkon që të ofrohen informata edhe sa i përket vlerësimit të aspekteve përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionit të mundshëm pa zbatimin e planit.

Në parim është vështirë të përshkruhet me saktësi evoluimi i gjendjes mjedisore në të ardhmen sipas “skenarit pa pasur plan” pasi të dhënat për trendet e zhvillimit janë të pakta dhe nuk janë të natyrës kuantitative. Megjithatë, në këtë seksion do të përpiqemi ta përshkruajmë gjendjen në të ardhmen për secilën prej temave të VSM-së duke u bazuar në trendin aktual dhe në supozimet për zhvillimet në të ardhmen. Supozimet mbi këto zhvillime janë si vijon:

- ✓ Trendet demografike do të vazhdojnë me shkallën aktuale të rritjes, e cila do të bëjë presion në burimet natyrore dhe fizike; së këndejmi pritet të ketë mungesa të ujit dhe burimeve të tjera;
- ✓ Vendbanimet do të zgjerohen në mënyrë të paplanifikuar dhe do të krijohen grupe të tyre përreth rrugëve kryesore Drenas – Komoran, Drenas – Skenderaj dhe Komoran-Prishtinë. Ndërtimet jashtë zonës së ndërtimit do të jenë të shpërndara në të gjithë hapësirën komunale.
- ✓ Sipërfaqja e tokat bujqësore do të zvogëlohet; zonat e biznesit do t’i zëvendësojnë kulturat bujqësore, ndërsa cilësia e dheut do të degradohet prej ujërave të zeza dhe menaxhimit jo të duhur të mbeturinave të ngurta, si dhe do të ketë rritje të plehut artificial dhe pesticideve; po ashtu do të ketë edhe më pak pleh organik krahas zvogëlimit të numrit të bagëtive;
- ✓ Edhe pse bujqësia do të vazhdojë të subvencionohet, ajo nuk specializohet në cilësi, bio-produkte dhe nuk synon tregjet lokale. Menaxhimi i tokave pjellore do të vazhdojë të jetë sfidë në vete e sidomos ruajtja e tokave bujqësore në sistemin e komasacionit.
- ✓ Trafiku i ngjeshur si dhe ndërtimi i pakontrolluar do të rritet; zhurma do të ndikojë negativisht në shëndetin publik dhe në botën e egër.
- ✓ Kompleksi "Ferronikeli" do të vazhdojë të jetë aktiviteti kryesor ekonomik për qytetin dhe ndikimet e lidhura me mjedisin do të vazhdojnë të jenë prezente pa ndonjë masë shtesë të kontrollit.
- ✓ Deponitë ilegale të mbeturinave do të përhapen edhe më shumë si rezultat i moszbatimit të duhur të ligjit;
- ✓ Ndryshimi i klimës do të vazhdojë të sjellin përmbajtje, vërshime dhe thatësira.
- ✓ Cilësia e lumenjve do të degradohet për shkak të derdhjes së vazhdueshme të ujit të pa trajtuara nga ekonomitë familjare dhe objektet komerciale/ industriale,
- ✓ Biodiversiteti do të degradohet për shkak të prerjes së paligjshme dhe të pakontrolluar të drunjeve, gjuetisë, peshkimi, zgjerimit të aktiviteteve ekonomike dhe ndërtimore dhe ndotjes që vjen prej tyre;
- ✓ Trashëgimia kulturore nuk do të ruhet sa duhet çka do të rezultojë me humbjen e vlerave të prekshme dhe të paprekshme të kësaj kulture;
- ✓ Cilësia e jetës do të përkeqësohet në mungesë të zonave të mjaftueshme të banimit, sipërfaqeve të gjelbra, peizazheve tërheqëse, hapësirave të hapura, parqeve etj.



Supozimet e mësipërme mbështeten në argumentet e prezantuar si vijon:

- ✓ **Popullsia dhe trendët shoqërore-** Popullsia do të rritet shpejtë me një përqindje të lartë të të rinjve. Në njërën anë, kjo është pozitive dhe mund të krijojë një shoqëri plotë gjallëri; megjithatë duke pasur parasysh shkallën e tanishme të lartë të papunësisë dhe mungesën e popullsisë së arsimuar, atëherë rritja e popullsisë mund të ketë pasoja negative në mirëqenien shoqërore dhe ekonomike të tyre. Me këtë trend pritet që të ketë një presion shtesë në burimet natyrore pasi popullsia e varfër varet kryesisht nga natyra në mungesë të teknologjive bashkëkohore.
- ✓ **Shëndeti publik-** Mungesa e furnizimit me ujë në gjithë territorin e komunës do të ndikojë negativisht në shëndetin e njerëzve e sidomos tek ato vendbanime që përdorin ujin nëntokësor me cilësi të dyshimtë si ujë të pijshëm. Deponitë ilegale të mbeturinave në të cilat mbeturinat komunale, ndërtimore dhe ato industriale të parrezikshme përzihen me mbeturina të rrezikshme (industriale dhe të sektorit të shëndetësisë) do të vazhdojnë të ketë ndikim të dukshëm në shëndetin e njeriut. Transporti dhe zhurma gjatë aktiviteteve intensive ndërtimore do të kenë ndikim negativ në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve në zonat urbane dhe të botën e egër shtazore. Numri i njerëzve që vriten ose lëndohen në sistemin e transportit mund të rritet nëse nuk përmirësohen rrugët dhe siguria e këmbësorëve.
- ✓ **Faktorët klimatik-** Emetimet e CO2 duken se do të rriten si rezultat i rritjes së konsumit të energjisë, prodhimit industrial dhe zvogëlimit të hapësirave pyjore. Po ashtu, shfrytëzimi i automjeteve private në vend të transportit publik do të kontribuojë në rritjen e emetimit të CO2. Temperaturat e larta dhe moti ekstrem do të sjellin thatësi me shumë dhe do të rrisin presionin tek bujqësia që është një ndër veprimtaritë kryesore ekonomike në komunë.
- ✓ **Cilësia e ajrit-** Nivelet e NO2, SO2 dhe PM10 do të rriten për shkak të mungesës së masave shtesë të kontrollit të emetimeve nga industria, transporti dhe përdorimi i lëndëve djegëse fosile për ngrohje nga ekonomitë familjare. Emetimet e pluhurit dhe zhurma do të vazhdojnë të jenë prezente nga aktivitetet e ndërtimore dhe operimet e gurëthyesve.
- ✓ **Uji-** Rritja e mundësisë së vërshimeve (si rezultat i faktorëve klimatikë) do të nënkuptojë më pak burime ujore dhe kjo do të kenë ndikim negativ në shëndetin e popullatës dhe në cilësinë e jetesës. Prodhimi bujqësor do të pësojë, dhe do të mbizotërojë mungesa e ushqimit.
- ✓ **Dheu-** Toka e kontaminuar do të mbizotërojë në mungesë të kthimit të tokave djerrë në toka bujqësore dhe veprimeve për bonifikimin e tokës. Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave nuk do të sjell ndonjë përmirësim të dukshëm nëse praktikët ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave mbeten të njëjta.
- ✓ **Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura-** Nuk do të ketë identifikim të vlerave të reja të biodiversitetit dhe nuk do përmirësohet cilësia e praktikave menaxhuese të zonave të mbrojtura për shkak se vetëdija e popullatës për rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit është relativisht e ulët. Rrjeti natyror ekologjik nuk do të ripërtërihet, çka do të ndikojë negativisht në biodiversitet.
- ✓ **Pyjet-** Zonat pyjore do të reduktohen çka do të ketë efekt negativ në indeksin e biodiversitetit dhe produktivitetin e tyre. Kjo do të ndikojë më tej negativisht në potencialin për gjueti, peshkim dhe zhvillimin të turizmit. Gjithashtu do të ketë ndikim indirekte edhe në rritjen e erozionit dhe pakësimin e reshjeve.



- ✓ **Peizazhi-** Peizazhi do të degradohet si rezultat i rritjes dhe zgjerimit të pakontrolluar të vendbanimeve. Rritja e pandalshme në infrastrukturën e transportit do ta degradojnë më tej peizazhin. Peizazhi natyror dhe bujqësor do të zëvendësohet me hapësira të banuara dhe industriale.
- ✓ **Trashëgimia-** Do të ketë më pak resurse për përkrahjen e nismave të ruajtjes së trashëgimisë, dhe si rrjedhojë lokacionet arkeologjike dhe historike e kulturore nuk do të hyjnë në zonën e mbrojtur të komunës. Zgjerimi i vendbanimeve mund t'i rrezikojë monumentet e vjetra kulturore
- ✓ **Lënda e parë-** Pa riciklimin e mbeturinave, do të kemi rritje të kërkesës për lëndë të parë, ashtu siç do të rritet edhe sasia e materialit që do të dërgohet në deponi të mbeturinave.



7. Vlerësimi mjedisor bazuar në skenarët zhvillimorë dhe alternativat

SKENARI I TRENDIT / SKENARI ZERO: Qytet i metalurgjisë dhe bujqësisë kuantitative

Ky skenar parasheh:

- Ndjekja e ritmit të njëjtë të planifikimit të zhvillimeve duke u bazuar në qeverisjen e deritanishme të hapësirës së ndërtuar.
- Deinsifikim modest të zhvillimeve me disa projekte të rëndësishme të infrastrukturës,
- Ndërtimet do të vazhdojnë të zhvillohen të shpërndara në tërë territorin komunal.
- Zhvillimet do t'i prijnë planifikimit.

Elementet kryesore planifikuese të këtij skenari janë:

- Ndërtimet jashtë zonës së ndërtimit të shpërndara në të gjithë hapësirën komunale duke krijuar presion të madh në infrastrukturën teknike dhe financat publike.
- Aktivitet komercial vazhdojnë të shpërndahen përgjatë korridoreve të rrugëve kryesore. Ndërsa në vendbanime duke ndjek formësimin e rrugëve.
- Edhe pse zhvillimet gradualisht largohen nga hapësirat e mbrojtura natyrore dhe kulturore, ende ka shume pak veprime që ndodhin në dobi të zhvillimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- Kompleksi "Ferronikeli" vazhdon të jetë aktiviteti kryesor ekonomik për qytetin dhe ndikimet e lidhura me mjedisin vazhdojnë të monitorohen dhe mbahen nën kontroll, por nuk merren masa specifike lokale për të ulur më tej ndikimin e tij në mjedis.
- Bujqësia vazhdon të subvencionohet, por nuk specializohet në cilësi, bio-produkte dhe nuk synon tregjet lokale. Qasja përmes kooperativave nuk merret parasysh siç duhet dhe toka pjellore nuk menaxhohet në mënyrë të koordinuar.
- Të gjitha zhvillimet e reja do të ndodhin në formë të shpërndarë (e jo të fokusuar, si p.sh. me përqendrim në qytet apo nën qendra) dhe pjesa më e madhe e vendeve të reja të punës dhe tregtisë së re shpërndahen, duke kontribuar kështu në dobësimin e qendrës së qytetit dhe jetës së qytetit.
- Zona nën komasacion do të mbetë sfide konstante për zgjerimi i qytetit të Glogocit (Drenasit), ndërsa ndërlidhja hapësinore ndërmjet Glogocit (Drenasit) dhe Komoranit zhvillohet natyrshëm duke u fuqizuar nga prezenca e aktiviteteve ekonomike dhe objekte banimi.
- Zhvillimet e shpërndara do të krijojnë shpenzime të mëdha operative për infrastrukturën teknike kur një pjesë më e madhe e ndërtimit të akomodimit privat (shtëpi dhe banesa) zhvillohet në parcela të reja të ndërtimit, rrjedhimisht rriten kërkesat për investime rrugore, rriten nevojat e transportit dhe përdorimi i makinave dhe krijohet një strukturë qyteti që është e kushtueshme për të shërbyer.
- Lëvizshmëria e banoreve vazhdon të varet kryesisht nga transporti privat me përmirësime të pjesshme në transport publik. Mjetet e transportit publik nuk modernizohen dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbime jocilësore duke motivuar banoret për të përdorur makinën private.
- Cilësia e hapësirave publike dhe rrjeti rrugor nuk përmirësohet dhe vazhdon të ketë të njëjtin nivel të standardeve që ka në këtë kohë.



Komentet në vijim janë rezultat i vlerësimit mjedisor për Skenarin e trendit (Skenari zero):

- Ndërtimet jashtë zonës së ndërtimit të shpërndara në të gjithë hapësirën komunale duke krijuar presion të madh në infrastrukturën teknike dhe financat publike, do të kenë ndikime të theksuara edhe në mjedis, dhe me qëllim të minimizimit të këtyre ndikimeve do të duhej të intensifikohet puna e inspektoratit dhe ndërmarrja e masave për zbatimin e ligjit.
- Aktivitet komerciale që do të vazhdojnë të shpërndahen përgjatë korridoreve të rrugëve kryesore, dhe në vendbanime duke ndjek formësimin e rrugëve, do të ndikojnë në zënien e tokës bujqësore dhe ndërrimin e destinimit të tokës, prandaj do të nevojitet angazhime shtesë për inspektime në terren.
- Për të minimizuar trendin e ndikimeve në hapësirat e mbrojtura natyrore dhe kulturore, në dobi të zhvillimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, do të nevojitet hartimi i planeve për menaxhimin e këtyre zonave dhe zbatimin e aktiviteteve parandaluese.
- Për të zvogëluar ndikimin në mjedis nga Kompleksi "Ferronikeli", krahas monitorimit dhe mbajtjes nën kontroll, do të duhej të ndërmerren masa specifike lokale për të ulur më tej ndikimin e tij në mjedis dhe analiza e mundësive për zbatimin e parimeve "ndotësi paguan".
- Edhe pse bujqësia do të vazhdojë të subvencionohet, do të duhej që ndikimi i saj në mjedis të zvogëlohej duke orientuar atë në bujqësi organike dhe duke zbatuar parimet mjedisore.
- Zhvillimet e reja që do të ndodhin në formë të shpërndarë do të kenë ndikime të shpërndara edhe në mjedisin ku do të zhvillohen dhe mbikëqyrja e tyre dhe kërkesat për zbatimin e parimeve mjedisore nuk do të mundë të japin efektin e tyre.
- Zgjerimi i qytetit të Glogocit (Drenasit) dhe ndërlidhja hapësinore me Komoranit që do të vazhdojë të zhvillohet natyrshëm duke u fuqizuar nga prezenca e aktiviteteve ekonomike dhe objekte banimi do të rrezikojë edhe Zonën në komasacion dhe do të ndikojë në ndërrimin e destinimit të tokës dhe humbjen e tokës bujqësore kualitative.
- Zhvillimet e shpërndara që do të krijojnë shpenzime të mëdha operative për infrastrukturën teknike dhe ndërtimet e reja do të ndikojnë në fragmentimin e tokave përmes shtrirjes së tyre në parcela të reja, ndërkohë që rritja e kërkesave për investime rrugore do të rritë ndikimet mjedisore si në emetimin e emisioneve, krijimin e mbeturinave dhe zvogëlimin e sipërfaqeve të gjelbra.
- Transporti i pa organizuar dhe i dominuar nga transporti privat me përmirësime të pjesshme në transport publik por me mundësi të vogla modernizimi do të vazhdojë të rrisë ndikimin e tij në cilësinë e ajrit por edhe do të pamundësojë zbatimin e transportit alternativ.



SKENARI 1 – DRENASI KOPSHT I PRISHTINËS

Ky skenar parasheh:

- Planifikimi dhe zhvillimi i kontrolluar dhe i mbikëqyrur përmes masave dhe aktiviteteve duke u bazuar në përmirësimin e qeverisjes.
- Projekte të rëndësishme të infrastrukturës të planifikuara, mbiqyrura dhe të kontrolluara,
- Ndërtimet e planifikuara dhe në zona të caktuara në territorin komunal.
- Planifikimit i paraprindë zhvillimit.

Elementet kryesore planifikuese të këtij skenari janë:

- Feronikeli vazhdon të jetë aset kryesor ekonomik në Drenas dhe me ndikim në mjedis, ku ndikimi në mjedis vazhdon të monitorohet dhe të mbahet nën kontroll duke aplikuar masa të nevojshme mbrojtëse.
- Zbatimin e masat që zvogëlojnë ndikimin që kanë ndotësit e tokës, ajrit dhe ujit nëntokësor dhe mbitokësor dhe trajtimin e ujërave të zeza në Godanc;
- Agrikultura vazhdon të jetë e subvencionuar por me përqendrim dhe specializim në cilësi, bio-produkte dhe target tregjet lokale.
- Themelimin e pikave grumbulluese për prodhime lokale dhe kooperativat ku mund të shiten e produktet e agrikulturës. Parashihen katër pika grumbulluese (një në mes të Drenasit dhe Komoranit, e dyta në Arllat, e treta në Gllanasellë dhe e fundit në Tërstenik).
- Zona nën komasacion do të mbetë e mbrojtur nga zhvillimet e mëtutjeshme.
- Vendbanimeve parashihen të jenë kompakte me 2 qendra kryesore Komoranin dhe Drenasin, nën-qendrat Abri, Gllanasellë, Tërstenik, Arllat dhe të shmanget shtrirja e pakontrolluar e të gjitha vendbanimeve brenda territorit të komunës.
- Investimet të orientuara në përmirësimin e hapësirave publike e sidomos në Drenas dhe Komoran.
- Kompletimi i rrjetit të rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre duke u bazuar në norma dhe standarde në fuqi.
- Çerdhe në Drenas dhe nën-qendra, trajnimet në të gjitha shkollat me vizion të ri për zhvillim si dhe infrastrukturë sociale e cila kompletohet me ndërtimin e qendrës multi-funksionare në Drenas.
- Mobiliteti apo lëvizshmëria e këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve të motorizuara do të jetë e qëndrueshme me ndikime të ulëta në mjedis.
- Përmirësimi i lidhjes së trenit mes Prishtinës dhe Drenasit si dhe ndërtimit i lidhjes së re hekurudhore në linjën Drenasi-Komoran-Stadiumi nacional- Zonë ekonomike- Aeroport të Prishtinës.
- Stacione shtesë të pompimit të ujit të pijes në Arllat dhe Abri për furnizimin e qytetarët me ujë të pijshëm, me qëllim që të mbulohet i gjithë territori Drenasit me ujë të pijshëm.
- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit malor në Qyqavicë dhe shtegun panoramik rreth Likoshanit.
- Valorizimin e aseteve të kulturës dhe të natyrës duke pasur në konsideratë Zonën e Veçantë të Kleçkës dhe Divjakës dhe trajtimin e saj në harmoni me planin e hartuar.



- Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse rreth stadiumit nacional në Korroticë.
- Zhvillimi i bizneseve parashikohet rreth rrugës kryesore prej parkut të biznesit deri në Drenas.

Komentet në vijim janë rezultat i vlerësimit mjedisor për Skenarin 1 – Drenasi Kopshti i Prishtinës:

- Ndikimi i fabrikës së Feronikelit në mjedis të monitorohet dhe të mbikëqyret duke respektuar kushtet e lejes së integruar mjedisore dhe ligjet tjera në fuqi, dhe po ashtu komuna në rastin e Feronikelit duhet të kërkojë zbatimin e parimeve “ndotësi paguar” dhe “shfrytëzuesi paguar”, përmes implementimit të projekteve të gjelbërimit dhe projekteve tjera për përmirësimin e mjedisit. Nga Fabrika e Feronikeli duhet kërkuar edhe përmirësimin e teknologjisë së prodhimit, ndërrimin e lëndëve djegëse, rehabilitimin e deponive industrial. Po ashtu duhet kërkohebatimin e masave për zvogëlimin e zhurmës, përmes ngritjes së barrierave kundër zhurmës dhe rripit të gjelbër. I rekomandohet komunës që në zonën e veprimit të Feronikelit të kufizohet zgjerimi i vendbanimeve dhe ndërtimi i objekteve të reja të banimit.
- Zbatimin e masat që zvogëlojnë ndikimin që kanë ndotësit e tokës, ajrit dhe ujit nëntokësor dhe mbitokësor duhet të bëhet përmes aplikimit të kërkesave që dalin nga Ligji i VNM-së, Ligji i VSM-së dhe ligjet tjera mjedisore.
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza duhet të bëhet pasi që të bëhet studimi paraprak i fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare dhe po ashtu komuna duhet të mendojë edhe për krijimin e një mekanizimi për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e operatorit. Duhet të mendohet po ashtu që për lokalitete tjera që nuk janë të përfshira në procesin e trajtimit të ujërave të zeza të ndërtohen impiante të vogla ekologjike (laguna artificiale) duke ndjekur shembujt e suksesshëm që tashmë janë zbatuar në Kosovë.
- Në të gjitha rastet e projekteve të reja agrikulturore që janë pjesë e subvencioneve të zbatohen VNM dhe po ashtu ti jepet përparësi projekteve që janë të fokusuara në bujqësi organike dhe në zhvillimin e produkte lokale të zonës. Të merren masa edhe për kontrollin e përdorimit të pesticideve dhe kemikateve si dhe të aplikohen certifikata dhe stimulime të formave të tjera për t'i kompensuar prodhuesit bujqësorë të cilët vendosin t'i aplikojnë praktikatat e të mira agro-ekologjike.
- Mbrojtja e tokave bujqësore që janë nën komasacion nga zhvillimet e mëtutjeshme, do të ndihmojë në ruajtjen e tokës kualitative bujqësore dhe do të pengojë defragmentimin e parcelave.
- Planifikimi i vendbanimeve në zona kompakte do të shmang shtrirjen e pakontrolluar të vendbanimeve jo formave brenda territorit të komunës, por megjithëkëtë për këto zona duhet të bëhen Plan rregullues dhe Harta zonale dhe të zbatohen kërkesat e VSM.
- Investimet e orientuara në përmirësimin e hapësirave publike në Glogoc dhe Komoran do të duhej të marrin parasysh sidomos zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Kompletimi i rrjetit të rrugëve si dhe rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit hekurudhor do të shoqërohet me ndikime në mjedis. Andaj në këto raste objektive mjedisore duhet të realizohen përmes procesit të VSM-së dhe/ose VNM-së. Në mënyrë të veçantë duhet të merren për bazë ndikimi në zonat e mbrojtura dhe në rrjetin ekologjik.



- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe sociale duhet të shoqërohet edhe me aspekte të investimit në vetëdijesim dhe edukim mjedisor.
- Sa i përket mobiliteti apo lëvizshmërisë së këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve të motorizuara ato duhet të jenë të fokusua në favorizimin e transportit publik dhe transportit të qëndrueshëm që do të mundësonte uljen e emisioneve ndotëse në ajër.
- Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë do të ketë ndikim pozitiv në shëndetin publik por njëkohësisht duhet të shoqërohet edhe me masa vetëdijesimi për kursimin e ujit dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve ujore.
- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit malor në Qyqavicë dhe shtegun panoramik rreth Likoshanit do të ndihmojë ekonominë lokale, por megjithëkëtë rekomandohet që të orientohet drejt eko-turizmi si një veprimtari e re dhe ndërmarrësit e interesuar duhet të trajnohen me qëllim që t'i dizajnojnë dhe reklamojnë produktet e tyre. Hapësirat e planifikuara turistike duhet të dizajnohen me kujdes dhe të shoqërohet me masa përkatëse që ndihmojnë ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit.
- Valorizimin e aseteve të kulturës dhe të natyrës duke pasur në konsideratë Zonën e Veçantë të Kleçkës dhe Divjakës dhe trajtimi i saj në harmoni me planin e hartuar do të ndihmojë në zbatimin e objektivave strategjike të planit që janë në harmoni me parimet e mbrojtës së mjedisit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore.
- Zhvillimi i infrastrukturës përcjellëse rreth stadiumit nacional në Korroticë, duhet të behet në harmoni me Planet Komunale dhe duhet të marrë për bazë aspekte mjedisore përmes zbatimit të parimeve të VNM dhe parimeve tjera të zbatueshme.
- Zhvillimi i bizneseve rreth rrugës kryesore prej parkut të biznesit deri në Glogoc, duhet të marrë për bazë parandalimin e ndërrimi të destinimit të tokës bujqësore të cilësisë së lartë, intensifikimit të erozionit, qëndrueshmërisë së tokës, si dhe të analizojë shkaktaret e mundshëm të ndonjë dëmi të padëshiruar mjedisor, shoqëror apo të shëndetit publik.

Konkluzion:

- Duke marrë për bazë vlerësimin e ndikimeve mjedisore të prezantuara më lartë për aktivitetet dy skenarët zhvillomë, mundë të kolaudohet që ndikimet mjedisore nga Skenarin 1 – Drenasi Kopshti i Prishtinës, do të jenë dukshëm më të vogla dhe më lehtë të kontrolluara në krahasim me ndikimet mjedisore nga Skenari 0 (Skenari i Trendit), ku ndikimet mjedisore do të jenë më të mëdha dhe me vështirë të kontrolluara.



8. Ndikimet e mundshme mjedisore si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PZHK-së

PZHK-ja do të sjell efekte pozitive për mirëqenien e qytetarëve të komunës së Glogocit (Drenasit) pasi promovon iniciativa të ndryshme në ofrimin e kushteve të përballueshme të strehimit, e rrit cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale, mundëson dhe nxit bizneset prodhuese, stimulon aplikimin e praktikave të mira bujqësore, tregtimin dhe reklamimin e produkteve lokale, zhvillimin e turizmit natyror, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore etj. Disa masa të përcaktuara në PZHK, megjithatë, do të kenë ndikim negativ në mjedis nëse nuk zbatohen dhe nuk përcaktohen masat zbutëse.

Ky kapitull është i rëndësishëm edhe për faktin sepse bënë identifikimin e projekteve përkatësisht aktiviteteve të PZHK-së, që në të ardhmen gjatë fazës së implementimit të planit do të jenë subjekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë disa vlerësime për ndikimet mjedisore të aktiviteteve të propozuara për implementim.

Tabela 27: Ndikimet më të mundshme mjedisore si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të planit

VENDBANIMET	
1. KONTROLLI NDËRTIMEVE NË TË GJITHA VENDBANIMET E KOMUNËS	
Aktivitet etet	Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Përmirësimi i performansës së Drejtorisë së Inspeksionit	Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse fuqizimi i inspektoratit përmes rritjes së numrit të inspektorëve dhe përmirësimit të kushteve të punës do të ndihmojë në identifikimin e veprimeve ilegale dhe në parandalimin e veprimeve negative mjedisore.
• A1 Shtimi i numrit të inspektoreve në DI	
• A2 Përmirësimi i kushteve dhe mjeteve të punës së inspektoratit	
1.2. Parandalimi i ndërtimeve pa leje	Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse aplikimi i gjobave për ndërtime pa leje dhe hartimin e rregulloreve përkatëse do të kontrolloj dhe parandalojë ndërtimet ilegale, duke kontribuar në mënyrë indirekte në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.
• A1 Fuqizimi i aplikimit të gjobave për ndërtimet e objekteve pa leje sipas legjislacionit ne fuqi	
• A2 Hartimi i rregullores bazuar në ligjin e ndërtimit, duke përfshirë kufizimin e kohës së përfundimit të ndërtimit	
2. FUQIZIMI I NËN-QENDRAVE ME SHËRBIME	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
2.1. Ofrimi i shërbimeve 6 dite në javë (administratë, kulturë etj.) në të gjitha nën-qendrat, aktive nga viti 2022	Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse fuqizimi i shërbimeve administrative do të ndikojë pozitivisht edhe në përmirësimin e shërbimeve që ndërlihen me çështje mjedisore dhe kulturore.
• A1: Rritja e numrit të punëtorëve për funksionalizimin e këtyre qendrave	
• A2: Ndërtimi i qendrave për Zyrat e vendit, kulture, etj. aty ku mungojnë	



2.2. Rregullimi infrastrukturës në 3 VBJ , brenda 5 viteve		Ndikim i përzier mjedisor. Ndikim pozitiv që ndërlidhen me përmirësimin e shërbimeve të sanitacionit për banorët e këtyre lokaliteteve por edhe ndikim negativ që mund të vijë nga aktivitetet nga rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse.
• A1: Rregullimi i rrugëve lokale në VBJ me ndriçim dhe trotuare		
• A2: Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në VBJ		
2.3. Rregullimi i çështjeve pronësore		Nuk do të ketë ndonjë ndikim direkt pozitiv apo negativ, ndërsa pritet ndikime indirekte pozitive mjedisore në aspektin administrativ.
A1. Rregullimi i dokumentacionit për pronën (tokën)		
BANIMI		
1. PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT DHE CILËSISË SË FONDIT EKZISTUES TË BANIMIT		
Aktivitetet		Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Ndërtimi i kapaciteteve profesionale për menaxhim në fushën e banimit, së paku 5 profesionist komunal të trajnuar		Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse fuqizimi i sektorit të banimit do të ndikojë pozitivisht edhe në përmirësimin e shërbimeve që ndërlidhen me çështje mjedisore dhe sociale e sidomos në rregullimin e çështjeve të banimit dhe shërbimeve që ndërlidhen me këto fusha.
• A1:Themelimi i sektorit për banim me min. 2 zyrtarë në fushën e banimit		
• A2:Trajnimi i 5 zyrtarëve për çështje banesore		
• A3: Hartimi i programit të banimit të përgjithshëm		
• A4: Krijimi i Shoqatave të Pronarëve dhe fuqizimi i administrimit për të gjitha ndërtesat në bashkëpronësi për 8 vite		Nuk pritet ndonjë ndikim pozitiv apo negativ nga ky aktivitet.
1.2. Evidentimi dhe futja ne shfrytëzim e 80% të kapaciteteve të pashfrytëzuara të banimit deri në 2025		
• A1: Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për „ndërtesat e pabanuara“ në tërë territorin e Drenasit		
• A2; Themelimi i bashkëpunimit me MF për vendosjen e tatimit të rritur për njësitë banesore të pabanuara		Pritet ndikime pozitive mjedisore në dy drejtime: në uljen e emisioneve në ajër nga kursimi i energjisë që do të prodhohej nga burimet fosile si dhe në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e efikasitetit të energjisë në mbrojtjen e mjedisit.
1.3. Rritja e efikasitetit energjetik 50% në objektet e banimit në të gjithë komunën, kompletimi deri në vitin 2030		
• A1: Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet qe krijohen me aplikimin e masave efikase ne objektet e banimit		
• A2: Nxitja dhe mbështetja teknike e ekonomive familjare për renovimin e objekteve		
2. PLOTËSIMI I NEVOJAVE PËR BANIM NGA FATKEQËSITË NATYRORE, FAMILJET E DËSHMORËVE DHE TJERA		
Aktivitetet		Ndikimi mjedisor/komentet



2.1. Sigurimi i banimit adekuat për 50% të familjeve në nevojë deri në vitin 2022	Ndikim i vogël negativ në mjedis që pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e banesave të reja kolektive dhe lagjeve të reja të banimit.
A1: Subvencionimi i qerasë së banimit për familjet në nevojë	Pritet edhe ndikim pozitiv sa përket aspektit social sepse do të zgjidhe problemet e banimit për disa kategori të shtresave shoqërore. Në rastin e planifikimit të lagjes së dëshmoreve duhet të zbatohen kërkesat e VSM apo VNM varësisht nga objektivat e projektit.
A2: Shfrytëzimi i banesave nga fondi i objekteve banesore të ndërtuara me koncesion publiko-privat	
A3: Ndërtimi i banesave për familjet në nevojë	
A4: Planifikimi i lagjes së dëshmoreve në Sankoc dhe rregullimi i çështjeve pronësore në lagjen paraprahe jo të suksesshme në Poklek	
2.2. Rritja e fondit të banimit të përballueshëm për 50% deri në vitin 2022	Ndikim i vogël negativ në mjedis që pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e objekteve të banimit me PPP, por pritet edhe ndikim pozitiv sa përket aspektit social sepse do të zgjidhe problemet e banimit për disa kategori të shtresave shoqërore.
A1: Marrëveshje me ndërmarrje biznesore –për ndërtimin e objekteve të banimit me PPP	
A2: Krijimi dhe menaxhimi i fondit për banim të përballueshëm	
INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	
1. SIGURIMI I ARSIMIT CILËSOR TË PËRSHTATSHËM PËR TË GJITHË	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Kompletimi i infrastrukturës edukative/trajnuese dhe plotësimi shkollave me pajisje të TI, hapësira sportive (deri në vitin 2025)	Ndikim i përzier në mjedis. Negativ për faktin se ndërtimet manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore sidomos në zënien e tokave, krijimin e mbeturinave apo edhe rritjen e presionit në mjedis përmes formave tjera të emetimeve.
A1: Plotësimi me pajisje të teknologjisë informative dhe kabineteve laboratorike i të gjitha shkollave	Ndikim pozitiv sepse ngritja e infrastrukturës shkollore dhe trajnuese do të ofrojë edhe mundësi për ngritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit.
A2: Plotësimi me hapësira sportive i të gjitha shkollave	
A3: Ndërtimi i shkollave, çerdheve dhe kopshteve plotësuese	
A4: Ndërtimi i qendrës trajnuese dhe ofrimi i trajnimeve	
A5: Ofrimi i trajnimeve dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit	
2. OFRIMI I SHËRBIMEVE CILËSORE TË SHËNDETËSISË ME ZHVILLIM TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
2.1. Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi përmes ofrimit të infrastrukturës së objekteve shëndetësore deri në 2022	Ndikim i përzier në mjedis. Ndikim negativ për faktin se investimet në përmirësimin e infrastrukturës manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore.
A1: Furnizimi me ultrazë, karrige stomatologjike dhe RTG e dhëmbit	



- A2: Ofrimi trajnimeve të avancuara dhe hartimi i rregulloreve për stafin shëndetësor - A3: Ngritja e cilësisë fizike në objektet shëndetësore (Parkingje, rrethoja, hapësira të gjelbra etj.) si dhe furnizimi me barëra - A4: Krijimi i qasjes për personat me nevoja të veçanta tek të gjitha objektet publike (plotësim) - A%: Ndërtimi i QKMF-së se re në Drenas	Ndikim pozitiv sepse ngritja e infrastrukturës shëndetësore do të ndikojë në përmirësimin e shëndetit publik që është një element i rëndësishëm që ndërlidhet me kushtet e mjedisit.
2.2. Rregullimi i infrastrukturës për mirëqenia sociale	Ndikim i vogël negativ në mjedis që pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e objekteve të banimit për banim social, por pritet edhe ndikim pozitiv sa i përket aspektit social sepse do të zgjidhe problemet e banimit për kategoritë sociale.
- A1: Sigurimi i akomodimit për banim social (çdo vit kalendarik nga 5 familje) - A2: Caktimi i lokacioneve dhe ndërtimi i hapësirave përcjellëse për shërbime të varrimit - A3: Ndërtimi i shtëpisë së pleqve dhe strehimores në Glogoc (Drenas) - Ndërtimi i shtëpisë së Pleqve në Qyqavicë	
3. NGRITJA E INFRASTRUKTURËS PËR OBJEKTET E KULTURËS, SPORTIT, DHE RRIJTJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE TË GJELBRA	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
3.1. Ofrimi i qendrave kulturore multifunksionale ne 5 nën qendrat e komunës (deri ne 2025)	Ndikim i vogël negativ në mjedis që pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e qendrave multi funksionale, por pritet edhe ndikim pozitiv sa i përket aspektit kulturor .
A1: Ndërtimi i qendrave multi-funksionale (Shtëpi e kulturës: Muzeu, Arkivi, Biblioteka, Teatri, Salla e Filmit, Galeria e Arteve) ne Glogoc, Komoran dhe Tërstenik	
3.2. Shtimi i hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra, duke përfshirë shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë	Ndikim pozitiv në mjedis sepse shtimi i hapësirave të gjelbra publike dhe mbjellja e fidanëve do të përmirësoj kualitetin e mjedisit në territorin e komunës. Megjithatë duhet pasur kujdes në zgjedhjen e fidanëve që janë më të përshtatshme për lokalitetin dhe duhet evituar llojet invazive.
- A1: Përmirësimi i hapësirave publike tek: Pishat në Kamenice (Gllobar), Liqeni i Vasilevës, shëtitoret në Komoran, parku rekreativ në Berishë - A2: Ndërtimi shiritit të gjelbër në Lagjen e Feronikelit	Në këtë aktivitet është përfshirë edhe Parku Rekreativ në Berishë, një projekt qe do te realizohet ne bashkëpunim me Komunë e Malishevës. Ky projekt do ti ndihmojë zhvillimit të turizmit malor, por duket pasur kujdes në ruajtjen e zonës së Mbrojtur të Gurit të Gradinës e cila njehe rit është edhe zonë arkeologjike.
A3: Projektimi dhe ndërtimi i shëtitores në qendër të Drenasit	
3.3. Fuqizimi i sportit dhe rekreacionit përmes ofrimit të hapësirave sportive (të mbyllura dhe të hapura) deri ne vitin 2030	Ndikim i vogël negativ në mjedis që pritet nga aktivitetet që do të zhvillohen për ndërtimin e infrastrukturës sportive. Këto ndërtime do të



A1: Ndërtimi i palestrave sportive (Komoran dhe Tërstenik) dhe pishinës gjysme-olimpike në Komoran	manifestohen me ndikime të ndryshme mjedisore sidomos në zënien e tokave, krijimin e mbeturinave, zhurmës, pluhurit apo edhe formave tjera të presionit në mjedis.
A2: Ndërtimi i Stadiumit Kombëtar	
INFRASTRUKTURA TEKNIKE	
1. RITJIA E KAPACITETEVE PËR FURNIZIM TË QËNDRUESHËM ME ENERGJI DUKE PËRDORUR EDHE BURIMET E RIPËRTRITSHME	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Ndërrimi i rrjetit shpërndarës (0.4 KW) nga përçuesit ajror në atë kabllorë, në të gjitha vendbanimet e komunës në 5 vitet e ardhshme	Pritet ndikim i vogël negativ në rastet e implementimit të aktiviteteve për rregullimin e infrastrukturës për rrjetin shpërndarës elektrik, për shkak se gjatë ndërtimit të rrjetit mund të ketë ndërhyrje në peizazh apo edhe në tokë. Këto aktivitete mund të jenë edhe subjekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis varësisht nga shtrirja e tyre dhe zonat nëpër të cilat do të kalojë rrjeti.
A1: Rregullimi i linjës ajrore 0,4 kV, komplet me shtylla dhe ndërrimi i përçuesit në të gjitha fshatrat e komunës së Glogocit (Drenasit)	
A2: Zgjerimi i ndriçimit publik në Komoran dhe në qendrat e komunitetit Tërstenik, Abri dhe Poklek i Ri	
A3: Rregullimi i linjës 10(20)kV, nga ai i largpërçuesit (në fshatrat dhe nën-qendra) dhe vendosja e ndarësve në pikat degëzuese të largpërçuesve 10/20 kV	
1.2. Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtitshme deri në 5%, në 8 vitet e ardhshme	Te dy aktivitetet do të kenë ndikim pozitive mjedisore sepse do të ndikojnë në uljen e emetimeve në ajër përmes reduktimit të prodhimit të energjisë që do të vinin nga përdorimi i lendeve fosile. Këtu është përmendur edhe ko-gjenerimi nga termocentralet. Sipas të dhënave ekziston rrjeti i gypave nga Termocentralet e KEK deri tek Fabrika e Feronikelit, që mund të shfrytëzohet për kogjenerim, mirëpo paraprakisht duhet të bëhet studimi për gjendjen e këtyre gypave.
A1: Vendosja e turbinave të erës në malet e Golesh	
Sigurimi i sistemit të ngrohjes qendrore	
A1: Ndërtimi i infrastrukturës për ngrohje qendrore me ko-gjenerim nga termocentralet e KEK. .	
2: ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT (FEKAL DHE ATMOSFERIK) SI DHE UJITJES	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
2.1. Rritja e kapaciteteve të ujit në 50 l/s (33% e ekonomive familjare) në 10 vitet e ardhshme	Do të ketë ndikime pozitive sidomos në aspektin e përmirësimit të shëndetit publik përmes përmirësimit të sasisë dhe cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë banorët e komunës. Aktiviteti do të ndihmojë edhe në reduktimin e humbjeve të ujit përmes përmirësimit të rrjetit të furnizimit me ujë.
A1: Ndërtimi i rezervuarit të ujit me kapacitete të shtuara duke përfshirë të gjitha filtrat për përpunim të ujit	
A2: Ndërrimi i rrjetit të azbestit në qendër të qytetit me gjatësi ~ 5000 m	
A3: Rehabilitimi i sistemit të furnizimit (rrjeti shpërndarës me azbest në qendër të qytetit- 2	



vite, rezervuari- 4 vite, sistemi pompues – 4 vite)	Priten ndikime të vogla negative mjedisore në rastet që ndërlihen me ndërtimin e rrjetave të ujësjellësit që mundë të shoqërohen me dëmtim të sipërfaqeve të gjelbra, erozion, dëmtim të sipërfaqeve bujqësore etj.
A4: Kycja e të gjitha familjeve në rrjetin e ujësjellësit (Ndërtimi i rrjetave të ujësjellësit për 10 fshatra)	
2.2. Hulumtimi i burimeve alternative nëntokësore dhe funksionalizimi i burimeve ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc)	Ndikim i përzier. Pritet që të ketë ndikime pozitive për shkak të rritjes së kapaciteteve për furnizim me ujë të pijes dhe për ujitje, megjithëkëtë mundë të ketë edhe ndikime negative për shkak të ndikimit në prishjen e balancit ujorë të zonës dhe dëmtimit të resurseve natyrore. Rekomandohet që akumulacioni të jetë i tipit multifunksional që përveç për pije dhe ujitje të përdoret edhe për aspekte tjera socio-ekonomike, dhe po ashtu studimi i fizibilitetit të jetë i bazuar në parimet e menaxhimit të integruar të resurseve ujore dhe natyrore. Prandaj ky aktivitet gjatë fazës së implementimit paraprakisht duhet ti nënshtrohet procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe procedurave për marrjen e lejes ujore, pëlqimit mjedisor dhe lejes mjedisore.
Hartimi i studimit të fizibilitetit (duke përfshirë hulumtimin e sasisë së ujit) për ndërtimin e pendës si dhe ndërtimi i pendës në Vërbovc	
Rehabilitimi i burimeve ujore ekzistuese (Krajkovë, Koreticë e Epërme dhe Vërbovc)	
2.3. Trajtimi i ujërave të zeza për 70% të territorit në 5 vitet e ardhshme	Pritet ndikim pozitiv mjedisor sepse do të ndikojë në përmirësimin cilësisë së ujërave sipërfaqësore përmes trajtimit të ujërave të ndotura urbane. Edhe ky aktivitet gjatë fazës së implementimit paraprakisht duhet ti nënshtrohet procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe procedurave për marrjen e lejes ujore, pëlqimit mjedisor dhe lejes mjedisore. Rekomandohet që të përdoren impiante të vogla të tipit të lagunave artificiale ekologjike dhe të bazohen në praktikën e mira që tashmë janë zbatuar në Kosovë.
Ndërtimi i impianteve të pastrimit të ujërave të zeza me kapacitete të vogla për ato pjesë ku rrjedhat e ujit nuk janë në drejtim të lumit Drenica	
2.4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në të gjitha lagjet në të cilat konfigurimi i terrenit e lejon	Ndikim i përzier. Pritet që të ketë ndikime pozitive për sa i përket sanitacionit dhe shëndetit publik sepse do të rritet qasja në sistemin e kanalizimit, mirëpo njëkohësisht do të ketë edhe ndikim negativ sepse do të rritet sasia e shkarkimeve të ujërave urbane në ujëra sipërfaqësore. Priten ndikime të vogla negative mjedisore në rastet që ndërlihen me ndërtimin e rrjetave të kanalizimit që mundë të shoqërohen me dëmtim të sipërfaqeve të gjelbra, erozion, dëmtim të sipërfaqeve bujqësore etj.
Ndërtimi dhe funksionalizimi i rrjetave të kanalizimit nëpër fshatra dhe zona urbane si dhe rregullimi i shkarkimeve të ujërave të zeza duke përfshirë ndërtimin e hidrostationeve për rritjen e shtypjes	
Ndarja e kanalizimit atmosferik nga ai fekal	
Ndërrimi i pompave furnizuese në stacionin e pompave në Bivolak	



2.5. Futja nën menaxhim të tërë sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit funksional	Aktivitetet do të ketë ndikime pozitive sa i përket sanitacionit dhe shëndetit publik, por duhet pasur kujdes gjatë zhvillimit të infrastrukturës sepse munde të ketë ndikime në mjedis në rastet e ndërtimit të kanalizimeve të reja duhet të mendohet edhe për format e trajtimit të ujërave të zeza.
Mbulimi i sipërfaqeve të punueshme në sistem të ujësjellësit.	
3: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
3.1. Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë operuese publike në 3 vitet e ardhshme	Ndikim pozitiv domethënës sepse do të ndikojë në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e komunës që është një nga problemet kryesore mjedisore.
Përmirësimi i kapaciteteve të kompanisë publike për mbledhjen e mbeturinave si dhe rregullimi i infrastrukturës në pikën transfer, rruga, rregullimi i platosë dhe mbulimi për vendosjen e mbeturinave të reciklueshme	Në rastin e rehabilitimit të deponisë së skories nga Fabrika e Feronikelit duhet të bashkëpunohet me MMPH, që ky aktivitet të realizohet sipas kërkesave të Lejes së Integruar Mjedisore.
Kyçja e të gjitha ekonomive familjare në sistemin e menaxhimit të mbeturinave	Po ashtu duhet të kërkohet që në këtë rast të zbatohet edhe parimi “ndotësi pagan”.
Monitorimi dhe rehabilitimi i lokacioneve në të cilat janë eliminuar deponitë ilegale (72 lokacione)	
Rehabilitimi i të gjitha deponive duke përfshirë edhe deponinë e skories nga fabrika e Feronikelit	
4. SIGURIMI I TRANSPORTIT TË INTEGRUAR PËR KOMUNËN E DRENASIT	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
4.1. Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në transport publik urban dhe periferik brenda vitit	Priten ndikime të vogla negative në mjedis tek aktivitetet që ndërlidhen me rregullimin e infrastrukturës së transportit meqenëse mundë të ketë ndërhyrje në mjedisin natyror, megjithëkëtë pritet ndikime pozitive kur flasim për përmirësimin e transportit publik i cili do të ndikojë në uljen e përdorimit të veturave dhe në uljen e emetimeve nga sektori i transportit.
Identifikimi i vendeve të cilat nuk janë të përfshira në transport dhe dhënia e lejeve të operimit për transport të udhëtarëve	
Përmirësimi i infrastrukturës motorike në të gjitha fshatrat dhe vendet urbane ku është e nevojshme dhe ofrimi i infrastrukturës jo motorike (mbikalimet, nënkallimet, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta etj)	
Ndërtimi i infrastrukturës për linjën e tramvajit prej Drenasit, Komoran, Parku i biznesit, stadiumi nacional, Sllatinë.	Tek disa aktivitete të planifikuara duhet të zbatohen parimet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ndërsa në rastin e hartimit të Planit të Mobilitetit duhet të merret në konsideratë që ky plan mundë të jetë subjekt i trajtimit sipas kërkesave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
Hartimi i planit të mobilitetit	
Projektimi dhe ndërtimi i qendrës së mobilitetit në Drenas (stacion i autobusëve, trenit dhe tramvajit si dhe parkingjeve)	



4.2. Rritja e sigurisë në trafikun rrugor dhe hekurudhor, 10% ulje të aksidenteve në komunikacion brenda vitit	Nuk pritet ndonjë ndikim negativ me efekt domethënës në mjedis, ndërsa që priten ndikime pozitive sa i përket ruajtjes së shëndetit publik nga aksidentet në komunikacion.
- Ndërtimi i nënkalimeve në hekurudhë dhe kampanjat për vetëdijesimin e nxënësve - Vendosja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në rrugë lokale dhe në nënkalimet në hekurudhë.	Këto aktivitete duhet të zbatohen në bashkëpunim të plotë me Hekurudhat e Kosovës.
4.3. Minimizimi i ndikimeve negative nga transporti i ngarkesave të Feronikelit brenda 3 viteve	Riorganizimi i transportit të automjeteve të rënda do të reduktojë zhurmën dhe lirim të emetimeve në ajër në zonën urbane ndërsa aktiviteti për mbjelljen e drunjëve pritet të ketë ndikim pozitiv në mjedisin urban por duhet të bëhet përzgjedhja e kujdesshme e drunjëve që janë të përshtatshëm për zonën.
Caktimi i rrugëve për kalimin e mjeteve transportuese mbi pesha 7.5 si dhe mbjellja e drunjëve	
ZHVILLIMI EKONOMIK	
1: NXITJA E ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore	
- Vlerësimi i gjendjes ekzistuese së tokës bujqësore për shfrytëzim - Fushatë vetëdijesimi dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore - Implementimi i projekteve për mbrojtje nga erozioni - Drenazhimi i tokave bujqësore (10% e tokës bujqësore në vit kalendarik) - Ndalimi i ndërtimeve në tokën bujqësore (sidomos nën komasacion)	Ndikim pozitivisht në mjedis. Projektet për mbrojtje nga erozioni dhe ato për ndalimin e ndërtimeve do të ndihmojnë në ruajtjen e tokës me cilësi të lartë. Rekomandohet të sigurohet bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë. Duhet të merret për bazë mundësitë e zhvillimit të bujqësisë organike dhe përdorimi i qëndrueshëm i produkteve kimike në bujqësi.
1.2. Krijimi i kuadrit profesional në fushën e bujqësisë	
- Hapja e drejtimit të bujqësisë në kuadër të shkollës profesionale (përfshirë edhe hapësirat për punë praktike) - Stimulimi i drejtimit bujqësisë përmes bursave për student - Vendosja e bashkëpunimit me kompanitë private për pranimin e nxënësve në praktikë profesionale - Trajnimi i mësimdhënësve për këshillim dhe orientim në karrierë për të rinjtë	Priten ndikime pozitive sidomos në ngritjen e edukimit dhe vetëdijesimit për bujqësi organike, përdorim të qëndrueshëm të kemikateve, prodhimin e produkteve lokale dhe stimulimin e zhvillimit të bujqësisë së qëndrueshme.
1.3. Rritja e fondit blegtoral për 30% për 8 vite	
Hartimi i programit 5 vjeçar për rritjen e numrit të blegtorëve përmes stimulimeve si	Priten ndikime negative në mjedis për shkak të rritjes së fondit të blegtorisë që do të shoqërohet



p.sh. dhënia në shfrytëzim e sipërfaqeve për kulllosa; vaksinimi i bagëtive; edukim dhe trajnim i fermerëve, etj.	edhe me rritje të presionit në mjedis sidomos në emetimin e metanit.
- Zhvillimi i skemave të subvencioneve dhe grante për përkrahjen e sektorit të blegtorisë të qumështit dhe produkteve blegtorale - Pasurimi i fondit blegtoral me raca të reja - Stimulimi i kultivimit të racës autoktone BUSHA - Nxitja e organizimit të blegtorëve në kooperativa apo shoqata	Për të parandaluar ndikimet negative në mjedis disa nga projektet e planifikuara për implementim duhet ti nënshtrohen procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ndërsa hartimi i programit për rritjen e blegtorisë varësisht nga objektivat dhe përmasat mundë të jetë subjekt i Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
1.4. Rritja e sipërfaqeve të Pemishteve, Perimeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, 50% për 8 vite	Priten ndikime negative në mjedis për shkak të rritjes së intensitetit të prodhimit të frutave dhe zgjerimit të sipërfaqeve me pemishte që shoqërohet me rritje të përdorimit të produkteve kimike që do të rrisin edhe ndikimin negativ në mjedis. Po ashtu edhe pikat grumbulluese do të kenë ndikim në mjedis për shkak të përdorimit të substancave ftohëse që janë burimi i emetimeve të gazrave serrë dhe gazrave që dëmtojnë shtresën e ozonit.
- Hartimi i një programi për rritjen e prodhimit të frutave/perimeve/bimëve mjekësore dhe aromatike - Ngritja e sipërfaqeve të reja për prodhimin e frutave/perimeve/bimëve mjekësore dhe aromatike (6% të fondit ekzistues në vite kalendarik) - Funksionalizimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë të sistemit Ibër-Lepenc dhe zgjerimi i rrjetit - Rritja e subvencioneve dhe granteve për ngritjen e Pemishteve dhe perimeve me varietete të vonshme - Edukimi i vazhdueshëm i fermerëve përmes Qendrës informuese këshilluese - Formimi i pikave të grumbullimit në Tërstenik dhe Komoran	Për të parandaluar ndikimet negative në mjedis disa nga projektet e planifikuara për implementim duhet ti nënshtrohen procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ndërsa hartimi i programit për rritjen e prodhimit të frutave varësisht nga objektivat dhe përmasat mundë të jetë subjekt i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Rekomandohet që projektet bujqësore të orientohen drejtë bujqësisë organike dhe prodhimit të produkteve lokale që kanë ndikim më të vogël në mjedis.
2: NXITJA E BIZNESEVE PRODHUESE DHE PËRPUNUESE (NVM)	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
2.1. Rritja e bizneseve prodhuese dhe përpunuese për 8% në çdo vit (NVM)	Priten ndikime negative në mjedis për shkak të rritjes së numrit të Ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese, që do të shoqërohet me rritje të emetimeve në mjedis varësisht nga tipi dhe lloji i ndërmarrjes.
- Hartimi i Udhërrëfyesit për promovimin e bizneseve (përfshirë materialet promovuese, krijimin e platformës 'online' për informim të bizneseve, etj.) - Krijimi i 2 tregjeve ditore për promovimin e produkteve vendore	Për të parandaluar ndikimet negative në mjedis disa nga projektet e planifikuara për implementim



• Krijimi sektorit përgjegjës për promovim të investimeve	duhet ti nënshtrohen procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Rekomandohet që projektet të orientohen drejtë zbatimit të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe njëkohësisht trajnimet e planifikuara për biznese të përfshijnë edhe trajnimet për zhvillimin e qëndrueshëm.
• Krijimi dhe funksionalizimi i bashkëpunimit ndër-komunal për plasim të produkteve dhe prodhim	
• Formimi i pikave për tharjen dhe përpunimin e frutave/perimeve/ bimëve mjekësore dhe aromatike	
• Trajnimi i ndërmarrësve në ngritjen e aftësive teknike dhe organizative	
• Hapja e Qendrës Inovacionit (mekanizëm për stimulimin të bizneseve dhe produkteve vendore)	
• Krijimi i fondit të veçantë për përkrahjen e bizneseve prodhuese dhe përpunuese (NVM)	
3: NGRITJA E KUALITETIT TE VEPRIMTARIVE SHËRBYESE	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
3.1. Aftësimi i fuqisë punëtore në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese	Nuk pritët ndonjë ndikim negativ në mjedisit nga ky aktivitet, mirëpo rekomandohet që në kuadër të trajnimeve dhe aktiviteteve të planifikuara të përfshihen edhe aspektet e turizmit natyrorë, turizmit rural apo ekotuzimit që do të ndikonte pozitivisht në ruajtjen e dhe promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore.
• Trajnimi profesional i 40 individëve në sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese	
• Partneriteti me sektorin e hotelerisë, gastronomisë dhe zanateve shërbyese me qëllim të trajnimit të vazhdueshëm në këtë sektor	
4: NXITJA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT RURAL	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
4.1. Zhvillimi i kapaciteteve pritëse/akomoduese në fshatra, së paku 10 pika akomodimi në 5 vitet e para të zbatimit të planit	Ky aktivitet pritët të ketë ndikime pozitive në mjedis sepse do të ndikoj pozitivisht në ruajtjen e dhe promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore. Rekomandohet që në rastin e krijimit të bujtinave të përdoren objekte ekzistuese dhe tradicionale që do të minimizonte ndikimin në mjedis.
• Vendosja e sinjalizimit informues për vizitorë (tabela informuese, tabela për shtigje, monumente të trashëgimisë, etj.)	
• Krijimi i bujtinave në fshatrat Dobroshec, Verboc, Vasileve, Vuqak, Poklek dhe pika tjera atraktive	
• Organizimi dhe promovimi i ngjarjeve kulturore në komunë	
4.2. Përgatitja e pakove turistike (së paku 3 pako për 5 vite)	Ky aktivitet pritët të ketë ndikime pozitive në mjedis sepse do të ndikoj pozitivisht në ruajtjen e



Subvencionimi dhe bashkëpunimi me operatore turistikë dhe OJQ në ndërtim të pakove turistike	dhe promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore. Rekomandohet të promovohen paketa turistike në bazuara në turizmin natyrorë, turizmin rural apo ekotuzimin.
Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve promovuese vendore dhe regionale	
MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	
1. ZVOGËLIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS NGA INDUSTRIA E RËNDË	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
1.1. Krijimi i mekanizmave të monitorimit të vazhdueshëm të kualitetit të ajrit për gjithë territorin e komunës (mekanizmat matës të jenë aktivë më së largu nga fillimi i vitit 2021	Do të ndikojë pozitivisht për informimin e qytetarëve për cilësinë e ajrit. Megjithëkëtë komuna duhet të bëjë planifikimin e duhur për ngritjen e kapaciteteve vetanake për monitorimin e cilësisë së ajrit, blerjen e pajisjeve dhe mirëmbajtjen e tyre. Ky aktivitet duhet të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante qendrore.
Vendosja e matësve për matjen e cilësisë së ajrit në Gllobar, Dobroshec, si dhe ne afërsi te Ferronikelit	
Vendosja e TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme në qytet	
Monitorimi i vazhdueshëm nga institucionet përgjegjëse	
1.2. Monitorimi i rregullt i sasisë së ujit dhe shfrytëzimit të resurseve natyrore deri në vitin 2025	Do të ndikojë pozitivisht për informimin e qytetarëve për sasinë e ujërave sipërfaqësore. Megjithëkëtë ky aktivitet nuk është në kuadër të kompetencave të komunës prandaj për implementimin e tij duhet bashkëpunim i ngushtë me Institutin Hidrometeorologjik.
Monitorimi i lumit Drenica, në Lagjen Cërvadiku, në zonën kadastrale të Pokleku dhe Çikatovë të Vjetër (vendosja e matësve të nivelit të ujit)	
2. KRIJIMI I NJË MJEDISI TË PASTËR DHE ATRAKTIV	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
2.1. Përmirësimi i kualitetit të ujërave të rrjedhshëm, për 40% deri në vitin 2022	Pritet ndikim pozitiv domethënës në mjedis sidomos në mbrojtjen e resurseve ujore sepse do të reduktojë shkarkimet ndotëse në ujëra sipërfaqësore. Rekomandohet që paraprakisht të bëhet studimi i fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare dhe po ashtu komuna duhet të planifikojë edhe krijimin e një mekanizmi për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e operatorit. Ky aktivitet po ashtu duhet ti nënshtrohet procesit të VNM-së dhe pajisjes me leje ujore.
Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në Dobroshec.	
2.2. Mbyllja dhe rigjenerimi i të gjitha deponive ilegale deri në vitin 2021	Ndikim pozitiv në mjedis sepse do të reduktojë numrin e deponive ilegale të mbeturinave. Megjithëkëtë komuna duhet të krijojë mekanizma
Mbyllja urgjente e deponive në Vuçak, Gllagoc, Komoran, Sankoc	



Mbjellja e bimëve specifike që e pastrojnë dhe përmirësojnë kualitetin e tokës në vendet e ish-deponive ilegale	për kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së mbeturinave në territorin e saj. Në aktivitetin e mbjelljes së fidaneve duhet të behet përzgjedhja e kujdesshme e fidaneve dhe të bashkëpunohet me Agjencinë e Pyjeve.
3.SIGURIMI I NJË MJEDISI MË TË SIGURT NGA NDIKIMET NGA FATKEQËSITË	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
3.1. Zvogëlimi i ndikimeve nga vërshimet e lumit Drenica, deri në vitin 2027	Ndikim pozitiv në mjedis, por duhet patur kujdes në ruajtjen e regjimit ujqor të lumit Drenica.
Rregullim i shtratit të lumit Drenica përmes barrierave preventive të qëndrueshme dhe miqësore me ambientin.	
3.2. Zvogëlimi i ndikimeve nga zjarri deri në vitin 2025	Ndikim pozitiv në mjedis sepse do të ndihmojë në ruajtjen e resurseve natyrore. Rekomandohet bashkëpunim me Agjencinë e Energjencave dhe harmonizimi i aktiviteteve me Strategjinë Nacionale për fatkeqësi natyrore.
Implementimi i masave për parandalimin e zjarreve në malet e Qyqavicës, Vasilevës, Polanës, Pallanikut dhe Kosmaqit.	
Vendosja e hidrantëve në secilin vendbanim, në përputhshmëri me standardet në fuqi.	
Hartimi i planeve të menaxhimit të rreziqeve dhe reagimit emergjent për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera (FNFT).	
4: KRIJIMI I QASJES SË INTEGRUAR NË MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE	
Aktivitetet	Ndikimi mjedisor/komentet
4.1. Konservimi dhe mbrojtja e vlerave të TK dhe TN (asetet që kanë status të mbrojtur dhe ato të propozuara) në funksion të zhvillimit të turizmit, deri në vitin 2024	Nuk pritët ndonjë ndikim negativ në mjedis. Aktivitetet do të ndihmojnë në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkitekturore (kulla, shtëpi, kompleks banimi) në komunën e Drenasit	
Konservimi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë arkeologjike (kala, fortifikatë, tuma) në komunën e Drenasit	
4.2. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve përmes programeve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, deri në vitin 2023	Nuk pritët ndonjë ndikim negativ në mjedis. Aktivitetet do të ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të komunës.
Organizmi dhe implementimi i fushatave vetëdijësuese për trashëgiminë kulturore në nivel komunal	



9. Rekomandimet dhe masat për zbutjen e efekteve negative në mjedis nga zbatimi i PZHK-së

Në bazë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në këtë kapitull janë përcaktuar disa rekomandime dhe masa zbutëse si reagim ndaj rreziqeve mjedisore që dalin prej objektivave strategjike apo aktiviteteve të caktuara të dhëna në PZHK.

Kurdo që masat e propozuara lidhen me ndërtimin e objekteve/ndërtesave, patjetër se do të ketë ndikim në mjedis dhe si rrjedhojë duhet të gjinden masa zbutëse.

Një rekomandim i përgjithshëm i raportit të VSM-së është që realizohet pjesëmarrja e publikut sa më shumë që të mundet në vendimmarrje përmes procedurave të VSM-së dhe/ose VNM-së.

Sipas analizës së veprimeve strategjike dhe aktiviteteve të përcaktuara në kuadër të tyre pjesa më e madhe e aktiviteteve do të sjellë efekte pozitive në mjedis dhe në përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të popullatës së Glogocit (Drenasit), megjithëkëtë duhet të merren për bazë edhe këto rekomandime dhe masa zbutëse.

Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

- ✓ Të mbrohet toka bujqësore e cilësisë së lartë nga ndikimet e dëmshme që dalin prej aplikimit të plehrave artificiale dhe pesticidet përmes kujdesit në aplikimin e përdorimit të pesticideve në mjedis;
- ✓ Aplikimi i bujqësisë së qëndrueshme përmes subvencioneve dhe granteve të drejtpërdrejta për blerjen e pajisjeve moderne për punimin e tokës, edukimi, trajnimin dhe certifikimin (posaçërisht sa i përket bujqësisë organike);
- ✓ Mbyllja e deponive të jashtëligjshme të mbeturinave dhe rehabilitimi i tyre duhet të bazohet në planet paraprake, sikurse që duhet merren masa edhe për monitorimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të gjendjes;
- ✓ Mbrojtja kundër vërshimeve është një disiplinë komplekse që duhet t'i përfshijë hidrologët, hidro-teknikët dhe biologët. Ekspertët e mjedisit duhet t'i përcaktojnë masat e përshtatshme (biologjike) për ta përmirësuar habitatin e tanishëm të dobët përgjatë brigjeve të lumenjve;
- ✓ Masat kundër erozionit duhet të jenë më efikase sesa vetëm rregullimi i shtretërve të lumenjve që bëhet aktualisht;
- ✓ Rehabilitimi i zonave të dëmtuara të tokës dhe peizazhit nga gurëthyesit duhet të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve që janë paraparë në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe në pëlqimin mjedisor ose lejen mjedisore përkatëse nga operatorët ekonomik. Ky aktivitet duhet të realizohet në bashkëpunim me organet kompetente të MMPH. Duhet pasur kujdes në zgjedhjen e drunjëve dhe pemëve që do të përdoren për rikultivim dhe duhet të përjashtohen llojet invazive dhe tu jepet prioritet llojeve të zonës dhe llojeve që adaptohen dhe praktikohen në rastet e rikultivimit të këtyre zonave. Edhe në rastet e lejeve të reja për gurëthyes të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore duhet të identifikohen duke zbatuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe duke zbatuar Planin e Rehabilitimit të paraparë sipas dispozitave të lejes përkatëse.



- ✓ Të forcohet rrjetin e zonave të mbrojtura dhe rrjetit ekologjik në territorin e komunës dhe mbrojnë biodiversitetin përmes shpalljes së zonave të mbrojtura dhe monitorimit të gjendjes së tyre;
- ✓ Zbatimi i ligjit mund të përmirësohet vetëm nëse inspektorati i mjedisit i kryen detyrat e veta në përputhje me planin e përcaktuar paraprak vjetor. Duhet të aplikohen dy metoda të inspektimit: vizita të rregullta të cilat lajmërohen dhe inspektime të atypëratyshme në objektet ku janë vërejtur parregullsi gjatë vizitave të lajmëruara.
- ✓ Ndikimi i fabrikës së Feronikelit në mjedis të monitorohet dhe të mbikëqyret duke respektuar kushtet e lejes së integruar mjedisore dhe ligjet tjera në fuqi, dhe po ashtu komuna në rastin e Feronikelit duhet të kërkojë zbatimin e parimeve “ndotësi paguar” dhe “shfrytëzuesi paguar”, përmes implementimit të projekteve të gjelbërimit dhe projekteve tjera për përmirësimin e mjedisit. Nga Fabrika e Feronikeli përmes organeve qendrore duhet kërkuar edhe përmirësimin e teknologjisë së prodhimit, ndërrimin e lëndëve djegëse, rehabilitimin e deponive industriale përmes rikultivimit dhe meliorimit. Për të minimizuar ndikimin e deponisë së skories në mjedis dhe në shëndetin publik duhet që ajo të monitorohet dhe të mbikëqyret sipas kushteve të lejes së integruara mjedisore duke përfshirë monitorimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore përreth, mbulimin e rregullt të saj me dhe, vendosjen e barrierave për të mos lejuar depërtimin e ujërave rrjedhëse nga deponia e skories në ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, kufizimin e lartësisë së skories, vendosjen e shenjave informuese dhe paralajmëruese si dhe t bëhet mbulimi i skories gjatë transportit nga fabrika deri në deponi. Po ashtu nga Fabrika e Feronikelit duhet të kërkohej zbatimi i masave për zvogëlimin e zhurmës, përmes ngritjes së barrierave kundër zhurmës dhe krijimit të rripit të gjelbër nga pemët dhe drunjët.

Zhvillimi ekonomik

- ✓ Krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e shkallës së punësimit: themelimin e qendrave të biznesit, zhvillimin e programeve për mësim gjatë gjithë jetës dhe kurseve të përshtatura për audiencën e caktuar;
- ✓ Turizmi intenziv mund të shkaktojë më shumë mbeturina dhe ujëra të zeza, si dhe tollovi trafiku (me efekte negative për cilësinë e ajrit). Zhvillimi i turizmit duhet të promovohet, por brenda kufijve të qëndrueshmërisë dhe duhet të orientohet në turizmin rural dhe atë ekologjik,
- ✓ Promovimin e produkteve lokal dhe ngritjen e tregut të gjelbër;
- ✓ Kultivimin e bashkëpunimit midis komunës dhe sektorit të biznesit: vendosjen e formave të përshtatshme institucionale dhe rregulloreve për ta ndihmuar këtë bashkëpunimi në frymën e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
- ✓ Forcimin e zonave ekzistuese dhe formësimin / organizimin e zonave të reja biznesore.
- ✓ Stimulimi i bujqësisë organike përmes subvencioneve dhe granteve.



Demografia dhe çështjet sociale

- ✓ Të mbrohet shëndeti publik përmes ofrimit të furnizimit me ujë cilësorë për të gjithë qytetarët, gypat e azbestit do të duhet të zëvendësoheshin kurse shfrytëzimi i ujit duhet të kufizohet duke i promovuar masat ruajtjes dhe riciklimit të ujit.
- ✓ Të mbrohet trashëgiminë kulturore, historike, arkeologjike dhe fetare përmes identifikimit, restaurimit, ruajtjes dhe promovimit të këtyre objekteve.

Zhvillimi i infrastrukturës

- ✓ Transporti publik do të duhej të zhvillohet, dhe për këtë arsye duhet të vendoset një strukturë krejtësisht e re infrastrukturore. Nga pikëpamja mjedisore, shfrytëzimi i transportit publik është e mirë pasi e redukton emetimin e dëmshëm në ajër të GHG-së, porse planifikimi i tij kërkon përpjekje shtesë më vete krahas PZHK-së që e ofron bazën e këtyre përpjekjeve. Zhvillimi i transportit duhet të bazohet në pikëpamjen e mundësive të kombinimit të transportit publik përmes rrugëve, hekurudhës, taksive, biçikletave, dhe mbase të shfrytëzimit të mundshëm të automjeteve elektrike në një afat më të gjatë kohorë. Nga pikëpamja e inter-modalitetit të transportit, duhet të kërkohet modeli i transportit të kombinuar për distancat më të shkurtra nga vendbanimi deri në vendin e punës, si dhe kombinim të transportit për kohë të lirë dhe për shërbime publike, etj. Sa më efikas që të jetë transporti publik aq më pak do të ketë emetim të CO₂, ndërsa qytetarët do ta zgjedhin transportin publik para se t'i shfrytëzojnë veturat e tyre private.
- ✓ Zgjerimi i vendbanimeve për të akomoduar zona të reja banimi sjell efekte negative në mjedis. Propozohet që të kërkohet një hulumtim gjeo-mekanik para se të realizohet ndonjë veprimtari ndërtimore në atë zonë. Nëse është e mundur ky zgjerim duhet të reduktohet me qëllim të shmangies së një zgjerimi të tej-zgjatur që nuk është i arsyeshëm sa i përket kostos që përfshihet për rregullimin e infrastrukturës komunale për t'ju shërbyer një numri të kufizuar të shtëpive / ndërtesave përgjatë rrugës lokale. I rekomandohet komunës që në zonën e veprimit të Fabrikës së Feronikelit të kufizohet zgjerimi i vendbanimeve dhe ndërtimi i objekteve të reja të banimit, më qëllim që të parandalohet rritja e numrit të popullatës që do të ndikohen nga aktiviteti i këtij operatori industrial. Në mënyrë të veçante duhet të kufizohet ndërtimi i objekteve shkollore dhe çerdheve në këtë zonë.
- ✓ Me ngritjen e zonave të reja industriale do të shfrytëzohen burimet natyrore të cilat do ta rrisin emetimet në mjedis, do të ndikojnë në humbjen e tokës bujqësore e cilësisë së lartë, do të krijohen mbeturina të materialeve ndërtimore disa prej të cilave kanë veçori të rrezikshme me mundësi të ndotjes së ujit dhe dheut, do të shtohet edhe sasia e ujërave të ndotura prandaj rekomandohet që të gjitha këto projekte të nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të identifikohen mundësitë për minimizimin e fakteve negative në mjedis.
- ✓ Përmirësimi i shërbimeve për trajtimin e ujërave të zeza do të rrisë cilësinë e ujërave të lumenjve dhe do të zvogëlojë ndotjen. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza është paraparë në PZHK, por do të përfshijë vetëm një pjesë të territorit të komunës. Andaj duhet të gjenden metoda më inovative (dhe më pak të kushtueshme) për trajtimin e ujërave të zeza. Propozohet



që për zonat tjera që nuk janë përfshirë në sistemin e trajtimit të ujërave të zeza të ndërtohen moçalishte artificiale.

- ✓ Përmirësimi i ndriçimit publik shihet si një parakusht i rëndësishëm për përmirësimin e sigurisë. Rekomandohen llambat prej natriumi në vend të llambave prej merkuri që përdoren gjerësisht për shkak të kostos së ulët investuese; llambat prej natriumi janë më të shtrenjta, por kanë potencial më të madh të kursimit të rrymës.
- ✓ Të përmirësohet sigurimi i energjisë dhe të zvogëlohen emetimet e CO2 duke aplikuar energji të ripërtërishme dhe duke bërë përmirësimin e efikasitetit energjetik përmes aplikimit të teknologjive moderne që shfrytëzohen për prodhimin e energjisë përmes biomasës; energjisë solare, energjisë së kombinuar dhe përmes stimulimeve për sektorin privat që të investojnë në objekte e pajisje të tilla;



10. Plani i Monitorimit

Me qëllim të monitorimit të zbatimit të objektivave të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë, dhe sigurimit të vazhdimësisë së ndërlidhjes ndërmjet PZHK dhe VSM propozohet që të zbatohet një plan i monitorimit i cili do të përmbante: qasjen e monitorimit (treguesit e monitorimit), shpeshtësinë për monitorimin e treguesve si dhe autoritetet përgjegjëse nga ku do të siguroheshin të dhëna nga monitorimi. Në tabelën 28 është propozuar një plan i monitorimit i cili do të mundë të plotësohej edhe me tregues tjerë varësisht nga nevojat dhe ndryshimi i objektivave të VSM-së gjatë procesit të konsultimit.

Tabela 28: Plani i monitorimit për objektivat e VSM

Objektivi i VSM	Qasja e monitorimit (Treguesit e monitorimit)	Shpeshtësia e propozuar e monitorimit	Autoriteti përgjegjës ku do të sigurohen të dhënat
O1: Zgjerimi i zonave të mbrojtura dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit;	Numri i zonave të reja të mbrojtura të natyrës dhe sipërfaqja e tyre. Numri i zonave të identifikuar potenciale për tu marrë në mbrojtje.	12 muaj	Komuna/DPUMM Instituti për Mbrojtjen e Natyrës
O2: Rimëkëmbje dhe mbrojtje e pyjeve nga degradimi;	Sipërfaqja e tokës së degraduar të pyllëzuar apo ripyllëzuar. Sipërfaqet e restauruara/rehabilituara të pyjeve.	12 muaj	Komuna/DBZHE Agjencioni i Pyjeve
O3: Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i ndotjes së ajrit dhe zhurmës;	Masat (vendimet) e komunës për zvogëlimin e ndotjes së ajrit; Numri i ankesat publike ndaj ndotjes së ajrit dhe zhurmave. Kufizimi (masat) për ndërtime të reja në zonat me ndotje të lartë dhe në zonat e ekspozuara nga zhurma.	12 muaj	Komuna/DPUMM Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
O4: Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe rritja e kapaciteteve të ujit të pijshëm përmes rritjes së kapaciteteve akumuluese dhe qasjes në rrjetin e ujësjellësit;	Numri i vendbanimeve të reja (dhe përqindja e ekonomive familjare) të lidhura me sistemet e ujësjellësit Konsumi i ujit dhe cilësia e tij Sasia e ujit për kokë banori Kohëzgjatja e reduktimeve të ujit	12 muaj	Komuna/DSHPE Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik
O5: Rritja e qasjes në shërbimin e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale;	Numri i vendbanimeve (dhe përqindja e ekonomive familjare) të lidhura me sistemet e kanalizimit me proceset e përshtatshme të trajtimit	12 muaj	Komuna/DSHPE



	Numri i objekteve për trajtimin e ujërave		
06:Zvogëlimi i humbjes së dheut cilësor dhe parandalimi i erozioni;	Përqindja e sipërfaqes së tokës me rrezik të lartë dhe shumë të lartë të erozionit të tokës	12 muaj	Komuna/ DBZHE
07: Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi dhe përmirësimi i tokës së degraduar;	Përqindja e sipërfaqes së zonave të reja urbane në zonat e planifikuara urbane Sipërfaqja e tokës së humbur nga ndërtimet e reja.	6 muaj	Komuna/ DBZHE MBPZhR
08: Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte (deponitë ilegale të mbeturinave urbane, ujërave të zeza, plehurat kimike, etj);	Numri i deponive të mbeturinave pastruara Sipërfaqet e tokës të rehabilituar nga deponitë ilegale dhe nga aktivitetet tjera	12 muaj	Komuna/DPUMM MMPH
09: Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja (integrimi i VSM-së dhe VNM-së, në kuadër të planeve, programeve dhe projekteve në nivelin lokal);	Numri i lejeve mjedisore komunale Numri i raporteve të VNM dhe VSM	6 muaj	Komuna/DPUMM
010: Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi i mbeturinave, eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe zgjerimi i mundësive të riciklimit të mbeturinave)	Numri i deponive ilegale të eliminuara dhe të rehabilituar Numri i vendbanimeve (i ekonomive familjare) të reja të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave Sasia e mbeturinave të ricikluara dhe ripërdorura	12 muaj	Komuna/DPUMM MMPH KRM
011: Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu (zjarret, vërshimet, tërmetet, aksidentet industriale, rreziqet e trafikut)	Numri i zjarreve dhe fatkeqësive tjera natyrore Sipërfaqet e përmbytura nga vërshimet Numri i intervenimeve nga njësitet e zjarrfikësve dhe atyre të kërkimit shpëtimit	6 muaj	Komuna/DSHPE Agjencioni i emergjencave
012:Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore të marra në mbrojtje.	12 muaj	Komuna/DKRS MKRS



	Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore të restauruara. Numri i vizitorëve dhe turistëve.		
O13: Përmirësimi i efikasitetit të energjisë së ndërtesave dhe sigurimi i objekteve të mjaftueshme të banimit.	Numri i objekteve të reja me standarde mjedisore. Numri i panelave solarë. Nr. i lejeve për energji të erës.	12 muaj	Komuna/DPUMM
O14: Përmirësimi i shërbimeve urbane (mirëmbajtja e parqeve urbane dhe sipërfaqeve të gjelbra, kujdesi shëndetësor, objektet arsimore, objektet sportive dhe kulturore)	Karakteristikat e zonave të reja të gjelbra (prania e objekteve dhe niveli i mirëmbajtjes) Numri (sipërfaqja) i parqeve të reja dhe zonave të gjelbra në zonat urbane	12 muaj	Komuna/DPUMM dhe DSHP
O15: Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore	Numri i publikimeve dhe broshurave Numri i OJQ-ve mjedisore Numri i debateve dhe konsultimeve	12 muaj	Komuna/DPUMM OJQ mjedisore lokale



11. Përmbledhje jo teknike e VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i PZHK të Komunës së Glogocit (Drenasit) synon rritjen e mundësive mjedisore dhe minimizimin e ndikimeve dhe rreziqeve që lidhen me zbatimin e planit. Qëllimi përfundimtar i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe kontribuimi në promovimin e qëndrueshmërisë.

Në Kosovë VSM-ja është e rregulluar me Ligjin nr. 03/230, i cili përcakton kushtet, formën dhe procedurat për aplikimin e VSM-së.

Fazat kyçe të raportit të VSM-së, dhe rezultatet e tyre, janë si në vijim:

- ✓ Identifikimi i legjislacionit të Kosovës që përcakton objektivat dhe politikat e mbrojtjes së mjedisit që janë potencialisht relevante për PZHK;
 - Është prezantuar një përmbledhje e ligjeve mjedisore, qëllimi dhe fushe veprimtaria e këtyre ligjeve dhe relevanca e tyre me PZHK.
- ✓ Identifikimi i veprimeve strategjike (politikave, planeve ose programeve) në nivele të ndryshme të vendimeve që janë potencialisht të rëndësishme për të ndikuar në PZHK;
 - Është prezantuar një përmbledhje e strategjive dhe planeve të nivelit nacional dhe lokal, qëllimi dhe objektivat strategjike të tyre si dhe relevanca e tyre me PZHK,
- ✓ Studimi bazë i çështjeve mjedisore dhe socio-ekonomike:
 - Përfshinë një përmbledhje të gjendjes ekzistuese të elementeve kyçe mjedisore dhe socio ekonomike bazuar në të dhënat e ofruara nga komuna dhe nga raportet dhe dokumentet relevante për territorin e komunës së Glogocit (Drenasit).
- ✓ Identifikimi i mundësive kyçe mjedisore:
 - Është dhënë një përmbledhje e mundësive kyçe mjedisore të identifikuara që mund të përdoren në funksion të zhvillimit të komunës së Glogocit dhe si elemente të rëndësishme që duhet të merren për bazë nga PZHK.
- ✓ Identifikimi i problemeve kyçe mjedisore:
 - Përfshinë një përmbledhje të problemeve kyçe mjedisore të identifikuara bazuar në analizën e gjendjes mjedisore dhe socio ekonomike, probleme këto që kërkojnë zgjidhje dhe që duhet të merren për bazë edhe në procesin e hartimit dhe zbatimit të PZHK.
- ✓ Propozimi i objektivave të VSM-së:
 - Përmban një listë prej 15 objektivave të VSM, që kanë si qëllim përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe njëherit kërkohet që këto objektiva mjedisore të merren në konsideratë gjatë hartimit dhe zbatimit të PZHK.
- ✓ Përmbledhje e përmbajtjes, sfidave zhvillimore dhe prioriteteve strategjike të PZHK-së;
 - Prezanton një përmbledhje të shkurtër të përmbajtës së PZHK, dhe njëkohësisht edhe një përmbledhje të sfidave zhvillimore dhe prioriteteve strategjike sipas sektorëve zhvillimorë.
- ✓ Vlerësimi i pajtueshmërisë së qëllimeve të PZHK-së me VSM
 - Kjo analizë synon kryerjen e vlerësimit mjedisor të qëllimeve dhe objektivave të Planit, në mënyrë që të provoj pajtueshmërinë e tyre me objektivat e VSM-së. Rezultatet



kryesore të kësaj analize përfshijnë rekomandime për ruajtjen e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimet dhe infrastruktura, ruajtjen e rrjetit ekologjik dhe pyjeve.

- ✓ Evolucionit prej gjendjes aktuale mjedisore pa një plan
 - Përfshinë vlerësimin të aspekteve përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionit të mundshëm pa zbatimin e planit bazuar në trendin aktual zhvillimorë,
- ✓ Vlerësimi mjedisor bazuar në skenarët zhvillimorë dhe alternativat
 - Rezultat i së cilës janë vlerësimi i skenarëve zhvillimorë dhe rekomandimet dhe alternativat në lidhje me zbutjen e ndikimeve nga skenarët e propozuar.
- ✓ Ndikimet e mundshme mjedisore si rezultat i zbatimit të aktiviteteve të PZHK-së
 - Ku janë dhënë disa vlerësime mjedisore të aktiviteteve të propozuara për implementim.
- ✓ Rekomandimet dhe masat për zbutjen e efekteve negative në mjedis nga zbatimi i PZHK-së
 - Janë dhënë rekomandime të përgjithshme dhe specifike si dhe janë propozuar masa zbutëse konkrete për zbutjen e ndikimeve në mjedisi nga implementimi i PZHK-së,
- ✓ Propozimi i planit të monitorimit,
 - Janë identifikuar qasjet dhe indikatorët e monitorimit për të zbuluar ndikimet aktuale të PZHK-së, kundrejt objektivave të VSM-së.
- ✓ Referencat dhe burimet e informacionit
 - Prezantimi i burimeve, dokumenteve, raporteve dhe të dhënave që janë përdorur për hartimin e këtij raporti.



12. Referencat dhe burimet e informacionit

1. Anketa e Fuqisë Punëtore 2017, ASK
2. Aprovimi i Listës së përkohshme të trashëgimisë Kulturore MKRS
3. Atlasi Hidroekonomik i Kosovës , 1986
4. Dokumenti për Politika dhe Strategjinë e zhvillimit të sektorit të Pylltarisë 2010 – 2020
5. Doracaku i thjeshtësuar i burimeve për mbështetjen e aplikimit të protokollit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë (OECD), Janar 2012
6. Draft Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë 2019-2021 për Komunën e Glogocit (Drenasit).
7. Drafti i Hartës Zonale të Kosovës 2020-2028+
8. Drenica Lumi Im, Ekodi, Janar 2010
9. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)
10. Gjendja e Mjedisit në zonën e Operimit të NewCo Feronikeli, AMMK 2015
11. Gjeologjia e Kosovës, prof. Dr. V. Pruthit.
12. Pedologjia, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, H.Gashi, Sh.Spaho, M.Dushi. 2002
13. Identifikimi i produktit turistik në rajonin e Prishtinës, MTI 2017
14. Master Plani për Kanalizim & Ujëra të Zeza për Pellgun e Lumit Morava Perëndimore /Raporti i Inventarit të Aseteve për Glogoc, 2011.
15. Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër - Lepenc” Sh.A.
16. Plani Hapësinor i “Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së Kleçkë dhe Divjakë”
17. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+
18. Plani Hapësinorë - Zona me Interes të veçantë “Fusha e Mihjes së Re”
19. Plani i Veprimit për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë 2013-2020
20. Plani Investues për Ujësjellës dhe Kanalizim në Glogoc – Komuna e Glogocit (Drenasit) , 2010
21. Plani për Menaxhimin e Mbeturinave, Komuna e Glogocit (Drenasit) 2015-2020
22. Plani Zhvillimor i Komunës së Glogocit (Drenasit) (Drenasit) - 2009
23. Plani Zhvillimor Komunal – Glogoc 2008-2020+
24. Propozim profesional për shpalljen e Liqeneve të Vasileves Peizazh i Mbrojtur, AMMK-IKMN/2014
25. Raportet vjetor për cilësinë e ujit të pijshëm në Kosovë, për vitet 2016 dhe 2017, IKSHP
26. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2017, AMMK
27. Raporti i performances komunale, Drenas 2017
28. Raporti për gjendjen e ujerave 2015, AMMK
29. Regjistrimi i Popullsisë 2011, ASK
30. Resurset natyrore. Universiteti i Prishtinës, fakulteti i shkencave matematike – natyrore, Bulliqi, Sh. 2004. Departamenti i Gjeografisë, Prishtinë.
31. Rezultatet preliminare të Regjistrimit të vitit 2011
32. Statuti i Komunës së Glogocit (Drenasit)
33. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020
34. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2013-2022



35. Strategjia e Kosovës për Mjedisin 2013-2022
36. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022
37. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
38. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012-2025
39. Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2018-2022
40. Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010-2020
41. Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019- 2021
42. Strategjia për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Glogocit (Drenasit) / 2015-2019
43. Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i Veprimit
44. Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2033
45. Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027
46. Studimi i Fisibilitetit për Kualitetin e Ujit të Pijshëm në Kosovë; HYDROPLAN GmbH; 2009
47. Studimi i Ndotjes së Tokës Bujqësore (SNTB) në Kosovë, Identifikimi i burimeve të ndotjes dhe propozimet për masat e përmirësimit, MMPH/GIZ 2015
48. UNDP/IHMK, "Monitorimi i PM10 në ajër dhe përcaktimi i metaleve të rënda në PM10 në zonën e Drenasit, Tetor 2015 – Mars 2016".
49. Vendimi i Kuvendit Komunal të Glogocit (Drenasit) Nr.12-941-43981 i datës 30.07.2018
50. Vlerësim, Popullsia e Kosovës, ASK 2019